

Date 10 / 11 / 2016

VENDIM
"EUROSIG" SHA
Nr. 15, dt. 10/11 /2016

PËR

PËRSHTATJEN E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INSIG" SHA,
NE DY SHOQËRI PRITËSE TË THEMELUARA RISHTAZI,
INSIG SHA DHE INSIG JETË SHA

Sot në Tiranë, më 10 / 11 / 2016, në orën 12:00, në selinë e shoqërisë INSIG SHA, me adresë Njesia Bashkiake nr.7, Rruga e Kavajës, nr.116, u paraqit përfaqësuesi ligjor i "Eurosig" sha, z. Xhevdet Kopani, bazuar në Ligjin nr. 52 datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", si edhe në ligjin Nr. 9901/2008 "Mbi tregtarët dhe shoqëritë tregtare", shoqëria "Eurosig" sha zotëruese 100% e aksioneve;

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të ndarjes së shoqërisë INSIG SHA, në dy shoqëri pritëse të themeluara rishtazi, INSIG SHA (kompani sigurimi jo-jetë) dhe INSIG JETË SHA.
2. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë INSIG SHA, z. Erald Hysa për përgatitjen e projekt marrëveshjes për ndarjen e shoqërisë "INSIG" SHA, në dy shoqëri pritëse të themeluara rishtazi INSIG SHA (kompani sigurimi jo-jete) dhe INSIG JETË SHA, si edhe për përgatitjen e Raportit të Ndarjes.
3. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë "INSIG" SHA, vetë ose nëpërmjet të tretëve të autorizuar prej tij për ndjekjen e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit/Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

AKSIONARËT:

"EUROSIG" SHA
100%

XHEVDET KOPANI
ADMINISTRATORI



PROJEKT MARREVESHJE NDARJE

E SHOQERISE INSIG SHA.

NE

INSIG SHA.

DHE

INSIG JETE SHA

MEQENESE:

- Shoqeria shqiptare e sigurimit Insig sha., ka patur per shkak te ligjit 2 licensa per ushtrimin e veprimtarise siguroese ne sigurimin e Jetes dhe Sigurimin e Jo-Jetes.
- Ne date 01.06.2016 eshte miratuar privatizimi I Insig sha., dhe per kete shkak, ne funksion te ligjit 52/2014 duhet te behet ndarja e shoqerise Insig sha., ne dy shoqeri pritesa te themeluara rishtazi Insig Jo Jeta sha., dhe Insig Jeta sha.
- Ne date jane miratuar ne AMF statutet e shoqerive pritesa te themeluara rishtazi Insig Sha.,(kompanie sigurimi jo-jete) dhe Insig Jete Sha.
- Ne perputhje me parashikimet e Nenit 216-225 dhe 227 te Ligjit 9901/2008 "Mbi tregtaret dhe shoqerite tregtare" ("Ligji Tregtar"), administratoret e shoqerive pritesa te themeluara rishtazi sipas emerimit te tyre nga asambleja e aksionareve te shoqerise, se bashku kane hartuar nje raport te hollesishcm mbi ndarjen e propozuar.

Atehere, ne perputhje me parashikimet e neneve 216 dhe vijues te Ligjit Tregtar administratoret e parashikuar te Insig Jo-Jete sha., dhe Insig Jeta sha., kane hartuar kete projekt marreveshje e cila do t'i paraqitet per miratim asamblese se aksionareve te shoqerive (me poshte ' **Projekt Marreveshja e Ndarjes**').

1. NDARJA

1.1 Shoqeria Qe Do Te Ndahet

- a. Insig Sh.a. eshte nje shoqeri shqiptare sigurimi. e regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ("**QKR**") me NIPT (NUIS) J62006012D, me seli ne Rr. Kavajes, 116, Tirane, Shqiperi.
- b. Insig Sh.a. operon si nje shoqeri sigurimi ne perputhje me Vendimin e Keshillit Mbikqyrjes se Sigurimeve nr. 4 date 08.06.2000.



1.2 Shoqerite Pritese

Insig sha., sipas statutit te miratuar nge Bordi i AMF me vendimin nr. 127 date 24.08.2016, (me poshte referuar si shoqeria Pritese Insig sha.)

dhe

Insig Jete sha., sipas statutit te miratuar nga Bordi i AMF me vendimin nr. 126 date 24.08.2016 (me poshte referuar si Insig Jete sha.

1.3 Gjendja Financiare E Shoqerise Qe Do Te Ndahet

Ne perputhje me parashikimet e Nenit 216 te Ligjit Tregtar, Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raportet Vjetore te ecurise te Insig sha., per vitet financiare 2013, 2014 dhe 2015 i bashkengjiten kesaj Projekt Marreveshjeje Ndarje si Shtojca 4.

1.4 Emertimi Dhe Vazhdimesia E Personalitetit Juridik Te Shoqerive pritese te themeluara rishtazi

Ne daten e Hyrjes ne Fuqi te Ndarjes, si perkufizohet me poshte, Insig sha., do te ndahet ne dy shoqerite Pritese Insig sha., dhe shoqerine Pritese Insig Jete sha.

Nderkohe vete kompania qe ndahet do te kaloje ne crregjistrim pa likujdim sipas parashikimeve te nenit 227/c te Ligjit Tregtar.

Ndarja e Shoqerive qe do te prodhoje pasojat e percaktuara ne nenin 227 te Ligjit Tregtar, dhe rrjedhimisht, duke filluar nga dhe pas dates se Hyrjes ne Fuqi, Shoqerite Pritese do te zoterojne te gjitha pasurite, te drejtat, privilegjet dhe kompetencat dhe do t'i nenshtrohet te njejtave detyrimeve dhe pergjegjesive si Shoqeria qe Ndahet. Te gjitha policat dhe detyrimet e Shoqerise qe Ndahet do te merren persiper nga Shoqeria Pritese brenda kufijve te licenses se tyre dhe me te njejtat kushte sikur keto polica te zbatoheshin akoma nga Shoqeria qe ndahet.

1.5 Data E Hyrjes Ne Fuqi Te Ndarjes

- a. Ne perputhje me parashikimet ligjore te zbatueshme. Ndarja midis Shoqerive sipas kesaj Projekt



The image shows a handwritten signature in black ink over a circular official stamp. The stamp contains the text: 'REPUBLIKA E SHQIPIRES', 'INSTITUTI I SIGURIMIT DHE TREGTARISE', 'INTEG', 'TIRANE', and 'SECRETARIA'. The signature is written across the stamp and extends to the right.

Marreveshjeje Ndarje do te hyje ne fuqi me plotesimin e te gjithe hapave te meposhtem:

- i. Depozitimimin e kesaj Projekt Marreveshjeje Ndarje dhe te gjithe dokumenteve shoqeruese prane QKR-se ne perputhje me Nenin 216 e vijues te Ligjit Tregtar.
 - ii. Miratimin e kesaj Projekt Marreveshjeje Ndarje nga Asambleja e Aksionareve te Shoqerise qe do te ndahet.
 - iii. Marrjen e miratimit per Ndarjen nga ana e Autoritetit te Mbikeqyrjes Financiare ne perputhje me Ligjin 52/2014 "Per veprimtarine e sigurimit dhe risigurimit".
 - iv. Regjistrimin e Ndarjes prane QKR-se ne perputhje me Nenin 220,227 te Ligjit Tregtar.
- b. Nga sa me siper, data e Hyrjes ne Fuqi e Ndarjes do te konsiderohet data e regjistrimit ne QKR ne perputhje me parashikimet e Nenit 220,227 te Ligjit Tregtar.
- c. Duke filluar nga dhe pas Dates se Hyrjes ne Fuqi, ne perputhje me parashikimet e Nenit 220,227 te Ligjit Tregtar:
- i. Te gjitha asetet dhe detyrimet e Shoqerise qe ndahet do ti transferohen Shoqerive pritese te themeluara rishtazi sipas projektit te eksperteve, dhe ky transferim do te hyje ne fuqi si kundrejt Shoqerise qe ndahet ashtu edhe kundrejt te gjitha paleve te treta.
 - ii. Aksionaret e Shoqerise qe do te Ndahet do te behen aksionare te Shoqerive pritese te themeluara rishtazi sipas pjesemarrjes se percaktuar me poshte.
 - iii. Shoqeria qe Ndahet do te konsiderohet si e prishur dhe do te crregjistrohet pa likujdim nga QKR.

1.6 Te Dhenat Tregtare Te Shoqerive pritese te themeluara rishtazi

- a. Statutet e Shoqerive pritese te themeluara rishtazi jane statutet e miratuara sipas vendimeve te Bordit te AMF nr. 126 dhe nr. 127 date 24.08.2016.
- b. Statute e Shoqerive pritese te themeluara rishtazi do te hyje ne fuqi ne Daten e Hyrjes ne Fuqi.
- c. Administratoret e Pergjithshem te shoqerive pritese te themeluara rishtazi do te jene si me poshte:
Shoqeria Pritese Insig sha. - Z. Erald Hysa, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me date 10.11.1980, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 025484041,
Shoqeria Pritese Insig Jete sha. – Znj. Elvana Mino, shtetase shqiptare, lindur ne Tirane me date 16.07.1967, mbajtese e ID me nr. 024473069
- d. Anetaret e Keshillit Mbikeqyres te Shoqerive pritese te themeluara rishtazi te miratuara sipas



vendimit te AMF nr. 155 dhe nr. 156 date 29.09.2016, do te jene personat e meposhtem:

1- Zoti Vasil Pilo - Kryetar

2- Zoti Rexhep Mejdani - Anetar

3- Zoti Thanas Xhillari - Anetar

- e. Do te themelohet nje Komitet i Brendshem Kontrolli i Shoqerive pritese te themeluara rishtazi anetaret e te cilit do te emerohen nga Keshilli Mbikqyres ne mbledhjen e pare pas emerimit.

2 Pasoja Te Tjera Te Ndarjes

2.1 Pasojat E Ndarjes Mbi Aksionet E Shoqerise Qe Ndahet

- a. Qe nga Data e Hyrjes ne Fuqi si pasoje e realizimit te Ndarjes dhe pa qene nevoja per veprime te tjera, aksionet e Shoqerive qe Ndahet do pushojne se ekzistuari pa kunderpagese.
- b. Qe nga Data e Hyrjes ne Fuqi si pasoje e realizimit te Ndarjes dhe pa qene nevoja per veprime te tjera, aksionet e Shoqerise qe do te Ndahet do te kembehjen automatikisht me aksione te Shoqerive pritese te themeluara rishtazi ne njeften perqindje:
- c. Qe nga Data e Hyrjes ne Fuqi, kapitali aksionar i Shoqerive pritese te themeluara rishtazi do te te jete:

Shoqeria Pritese Insig sha.

Aksionari	Nr. i aksioneve te zoteruara	% ne kapital	Vlera e aksioneve te zoteruara ne lek
Eurosig sha.	1.083,83	100	650.000.000

Shoqeria Pritese Insig Jete sha.

Aksionari	Nr. i aksionevc te zoteruara	% ne kapital	Vlera e aksioneve te zoteruara ne lek
-----------	------------------------------	--------------	---------------------------------------

The image shows a handwritten signature in black ink over a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPERISE' at the top, 'INSIG JETE' in the center, and 'TIRANE' at the bottom. The signature is written across the stamp.

Eurosig sha.	616,66	100	370.000.000,00
--------------	--------	-----	----------------

- d. Aksionari i Shoqerise qe ndahet pranon transferimin e aseteve te Shoqerive pritese te themeluara rishtazi tek Shoqeria ne kembim te aksioneve te Shoqeritese te percaktuar me lart.
- e. Te drejtat lidhur me cilesine e aksionarit te Shoqerise Perthithese dhe aksionet e Shoqerise Perthithese do te jene ato qe jane percaktuar ne Statute e Shoqerive pritese te themeluara rishtazi te miratuara nga ana e AMF dhe qe bashkengjiten kesaj Projekt Marreveshjeje Ndarje.
- f. Aksionaret e Shoqerise qe Ndahet do te kene te drejta pjesemarrjeje ne fitimet e pashperndara te Shoqerise qe Ndahet per periudhat perpara Dates se Hyrjes ne Fuqi. Aksionaret e Shoqerive pritese te themeluara rishtazi do te kene te drejta pjesemarrjeje ne fitimet e pashperndara (nese ka) te Shoqerise qe Ndahet per periudhat perpara Dates se Hyrjes ne Fuqi ne perputhje me pjesemarrjen e tyre ne kapital perpara Dates se Hyrjes ne Fuqi.

2.2 Pasojat E Ndarjes Mbi Punonjesit E Shoqerise Qe Do Te Ndahet

Nuk parashikohet qe te kete shkurtime te asnje punonjesi per shkak te ndarjes keshtu qe ndarja nuk do te kete efekt mbi punonjesit. Kontratat e punes do te rilidhen me te njejtat kushte nga shoqerite Pritese.

Duke qene se brenda Shoqerise do te Ndahet ka patur nje department qe merrej kryesisht dhe vetem me produktet e jetes, eshte parashikuar qe ky department do te kaloje I gjithi ne kompanine Pritese Insig Jete sha. Po ashtu nje pjese e stafit mbeshtetes do te kaloj prane shoqerise Insig Jete sha., qe konsiston ne specialist nga Dep. I Finances, Dep. IT, Dep. Riskut dhe aktuaristikes, Dep. Juridik, Dep. Auditit etj.

2.3 Pasojat E Ndarjes Mbi Kreditoret E Shoqerive Qe Ndahen

- a. Si me siper duke filluar nga Data e Hyrjes ne Fuqi, te gjitha detyrimet e Shoqerise qe ndahet do t'i kalojne Shoqerive pritese te themeluara rishtazi. Per shkak te ligjit, detyrimet qe lidhet me demet e jetes do ti kalojne shoqerise Pritese Insig Jete sha., ndersa detyrimet qe lidhen me demet e jo-jetes do ti kalojne shoqerise Pritese Insig sha.
- b. Pa cenuar sa me siper, Shoqeria qe do te Ndahet dhe perfaqesuesit e saj marrin persiper dhe garantojne se ata do t'i leshojne cdo kreditori eventual qe paraqet nje pretendim kundrejt Shoqerise qe do te Ndahet brenda afateve te percaktuara nga Neni 221 i Ligjit Tregtar (cdo dhe



te gjitha garancite e parashikuara ne kete nen).

2.4 Privilegje Te Caktuara Per Administratoret, Keshillin Mbikqyres Ose Ekspertet Kontabel

Administratoret dhe Anetaret e Keshillit Mbikqyres si edhe ekspertet kontabel te Shoqerive qe do te Bashkohen nuk do te perftojne privilegje te vecanta si rrjedhoje e Ndarjes.

3. Deklarata dhe Garanci

Shoqeria qe ndahet deklaron dhe garanton se:

- a. Kompetencat dhe zbatueshmeria. Perfaqesuesit e Shoqerise qe ndahet kane kompetencat dhe autoritetin e duhur per te nenshkruar kete Projekt Marreveshje Ndarje. Po ashtu Shoqerite Pritese do themelohen dhe ekzistojne ne perputhje me legjislacionin e Republikes se Shqiperise.
- b. Jo-cenueshmeria. Nenshkrimi dhe leshimi i cdo dokumenti dhe zbatimi i cdo detyrimi sipas kesaj Projekt Marreveshje Ndarje nuk do te rezultojne ne shkeljen e ndonje prej (i) parashikimeve te Statuteve te Shoqerive pritese te themeluara rishtazi ose (ii) urdhri apo vendimi te nje gjykata apo autoriteti i cili ka fuqi detyruese per Shoqerine qe Ndahen.
- c. Autorizime dhe Lejime. Kjo Projekt Marreveshje Ndarje dhe transaksionet qe parashikohen ne te do te hyjne ne luqi pas miratimit nga Asamblese se Aksionareve te Shoqerise qe ndahet, miratimit nga AMF dhe regjistrimit te Ndarjes prane QKR se bashku me dokumentacionin e kerkuar.

4. Te Ndryshme

- a. Njoftimi i klienteve te shoqerise qe ndahet: Kjo marreveshje do te publikohet ne faqen web te shoqerise. Secili prej klienteve do te njoftohet me sms dhe/ose email per ndarjen. Asnje prej klienteve nuk do te kete nevojte te ndryshoje kopjet e kontratave qe ka ne fuqi me kompanine qe do te ndahet. Shoqerite Pritese do te konsiderojne te vlefshme secilen prej ketyre kontratave dhe do te ekzekutojne gjithte detyrimet qe rrjedhin prej tyre sipas kushteve kontraktore.
- b. Garanci te tiera. Shoqeria qe do te ndahet do te kryeje ato akte dhe do te leshoje ato dokumente qe do te jene te nevojshme per te plotesuar dhe per te bere te vlefshme parashikimet e kesaj Projekt Marreveshjeje Ndarje.
- c. Lista e Shtojcave. Me poshte jane Shtojcat qe i bashkengjiten dhe qe jane pjese perberese e



The image shows a handwritten signature in black ink over a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPERISE' at the top, 'MINISTRI E FINANCAVE DHE TREGTISE' around the perimeter, and 'TIRANE' at the bottom. In the center of the stamp, there is a logo consisting of the letters 'MFG'.

Projekt Marreveshjes se Ndarjes:

Shtojca 1 - "Raporti i Detajuar i Ndarjes"

Shtojca 2 - "Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raportct Vjetore te Pasurise se Insig per vitet
financiare 2013, 2014 dhe 2015"

Shtojca 3 - "Statutet e Shoqerive pritese te themeluara rishtazi"

Shtojca 4 - "Raporti i Eksperteve mbi Ndarjen"

- d. Kopjet. Kjo Projekt Marreveshje Ndarje do te nenshkruhet ne 6 kopje dhe secila prej tyre do te konsiderohet nje kopje origjinale dhe te gjitha se bashku do te perbejne nje instrument te vetem.
- e. Giuhet. Kjo Projekt Marreveshje Ndarje nenshkruhet ne gjuhen ne gjuhen Shqipe.

Shoqeria ne proces ndarje

Insig sha.

Erald Hysa

Drejtor I Pergjithshem



Miratuar pa verejtje

Administratoret e Shoqerive pritese te themeluara rishtazi

Insig sha.

Erald Hysa



Insig Jete sha.

Elvana Mino



NR 3175/PROT
02.12.2016

**Raporti i Administratorit i Shoqerise qe ndahet
Insig Sha**

ne perputhje me nenin 216-225 dhe nenin 227 te ligjit 9901/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"

Administratori i shoqerise qe ndahet Insig sha., miraton raportin e ndarjes si me poshte vijon:

INFORMACION I PERGJITHSHEM

1. Hyrje

Ky raport sipas nenit 216 paragrafi 2 i ligjit 9901/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" ("Ligji per Shoqerite Tregtare") u pergatit nga Administratori i shoqerise qe do te ndahet Insig sha., me NIPT J62006012D (ne vijim referuar si shoqeria qe ndahet Insig sha.)

Shoqeria qe ndahet Insig sha., deri ne date 30.05.2016 ka qene me kapital 100% shteteror dhe per shkak te ligjit ka zoteruar dy licensa, licensen e ushtrimit te aktivitetit te Jetes dhe licensen e ushtrimit te aktivitetit te Jo-Jetes.

Ne date 01.06.2016 eshte bere privatizimi i shoqerise qe ndahet Insig sha., dhe aksionar 100% i aksioneve te saj eshte bere kompania e sigurimit Eurosig sha.

Ligji 52/2014 ka te parashikuar se kompanite e sigurimit te jetes dhe jo-jetes duhen te jene kompani me vete, ne permbushje te ketij kriteri ligjor duhet te kryhet ndarja e shoqerise Insig sha., ne dy kompani sigurimi Shoqeria e Jo-Jetes Insig sha., dhe Insig Jete sha.

Ne date 24.08.2016 jane miratuar ne AMF statutet e dy shoqerive pritesa te themeluara rishtazi sipas vendimeve 126 dhe 127 te Bordit.

Ne date 17.10.2016 Administratori i Shoqerise qe ndahet Insig sha., ka pergatitur dhe miratuar nje projektmarreveshje Ndarje ne perputhje me nenin 216 e vijues te Ligjit per Shoqerite Tregtare (ne vijim referuar si "Projektmarreveshja e Ndarjes").



Ne perputhje me kerkesat e nenit 216 e vijues te Ligjit per Shoqerite Tregtare, ky raport ka te perfshire edhe nevojen e kuptuesheme ligjore dhe ekonomike te Projektmarreshjes se Ndarjes, strukturen aksionare te shoqerive pritese te themeluara rishtazi, detajet per caktimin e Ekspertit te Pavarur, si dhe informacion ne lidhje me pasojat e Ndarjes per punonjesit e shoqerive pritese te themeluara rishtazi.

Objektivat e Ndarjes

Objektivat e ndarjes jane:

- Konsolidimi i Shoqerive pritese te themeluara rishtazi duke maksimizuar fokusimin ne shitjen dhe administrimin e produkteve te sigurimit sipas licensave perkatese si dhe duke duke siguruar nje fokusim me te efektshem mbi veprimtarine e shoqerise dhe rritjen organike te seciles prej tyre;
- Rritja e profesionalizmit ne gjithe hallkat e aktivitetit te shoqerise pasi secila prej kompanive Pritese do te kete persona te profesionalizuar ne aktivitetin konkret sipas licenses se shoqerise.
- Nje organizim me te mire dhe administrim me te efektshem te proceseve te biznesit si pasoje e thjeshtezimit te ndjeshem te planifikimit strategjik, vendimmarrjes dhe zbatimit;
- Ndarje efikase e aftesive paguesve duke rritur transparencen ndaj klienteve.
- Perputhshmeri me kerkesat e ligjit per Sigurimet dhe Risgurimet ne gjithe komponentet e saj.
- Mundesi me te mira per marketim te personifikuar sipas fushes se veprimtarise.

3. Informacion i pergjithshem per shoqerine qe Ndahet Insig sha., dhe Shoqerite Pritese

3.1 Shoqeria qe ndahet Insig sha.

- a. *Forma ligjore:* shoqeri aksionare.
- b. *Adresa e selise kryesore:* pallatet Rr. Kavajes, Nr. 116, Tirane, Shqiperi.
- c. *Objekti i regjistruar i veprimtarise se biznesit:* zhvillon aktivitet si shoqeri sigurimi e jete dhe jo-jetes sipas autorizimit dhe lejes se dates 08.06.2000.
- d. *Klasat e sigurimit te cilat perfshihen ne licencen e sigurimit te jetes dhe jo-jetes jane:*
Grupet 1 dhe 2 "Sigurimi I aksidenteve dhe shendetit"
Grupet 1 (paragrafi 4), 3, 7, dhe 10 "Sigurime motorike"






Grupet 1 (paragrafi 4), 4, 6, 7 dhe 12 "Sigurimi i marines dhe transportit"

Grupet 1 (paragrafi I 4) 5,7, dhe 11 "Sigurimi I avioneve"

Grupet nr. 8 dhe 9 "Sigurimi nga zjarri dhe demtime te tjera ne prone"

Grupet nr.10, 11, 12 dhe 13 "Sigurimi i pergjegjesive"

Grupet nr. 14 dhe 15 "Sigurimi I kreditit dhe I garancise"

Grupet 19, 20, 21, 22 "Sigurimi jetes"

f. Kapitali dhe aksionet: ALL 1.020.000.000 (nje miliard e njezet million lek), *i ndare ne 1.700 (njemije e shtateqind) aksione te zakonshme, te regjistruara me te drejte vote me vlere nominale prej ALL 600.000 (gjashteqindmije) secili.*

3.2 Shoqeria Pritese e Jo-Jetes, Insig Sha.:

Shoqeria Pritese Insig sha., do te ushtroje veprimtari ne sigurimin e jo-jetes me keto karakteristika:

- a. *Forma ligjore:* shoqeri aksionare.
- b. *Adresa e selise kryesore:* pallatet Rr. Kavajes, Nr. 116, Tirane, Shqiperi.
- c. *Objekti i regjistruar i veprimtarise se biznesit:* zhvillon aktivitet si shoqeri sigurimi e jo- jetes. Pritet saktisimi i licenses se re nga ana e AMF sipas statutit te miratuar prej Bordit te AMF.
Klasat e sigurimit te cilat perfshihen ne licencen e sigurimit te jo-jetes per te cilat do te dale dhe licensa e re jane "Te gjitha klasat e sigurimit te jo-jetes" ku perfshihen:
Grupet 1 dhe 2 "Sigurimi I aksidenteve dhe shendetit"
Grupet 1 (paragrafi 4), 3, 7, dhe 10 "Sigurime motorike"
Grupet 1 (paragrafi 4), 4, 6, 7 dhe 12 "Sigurimi i marines dhe transportit"
Grupet 1 (paragrafi I 4) 5,7, dhe 11 "Sigurimi I avioneve"
Grupet nr. 8 dhe 9 "Sigurimi nga zjarri dhe demtime te tjera ne prone"
Grupet nr.10, 11, 12 dhe 13 "Sigurimi i pergjegjesive"
Grupet nr. 14 dhe 15 "Sigurimi I kreditit dhe I garancise"
- d. Kapitali dhe aksionet: ALL 650.000.000 (gjashteqind e pesedhjetë million), i ndare ne 1.083,33(njemije e tetedhjetë e tre presje tridhjetë e tre) aksione te zakonshme, te regjistruara me te drejte vote me vlere nominale prej ALL 600.000 (gjashteqind mije) secili.

Aksionaret ne daten e Raportit jane:

<u>Aksionari</u>	<u>Numri i aksioneve</u>	<u>Te drejta direkte financiare/kontroli %</u>
Eurosig sha	1.083,33	100%

- h. *Sisiemi i administrimi me dy nivele:* Shoqeria administrohet dhe perfaqesohet nga Administratori i Pergjithshem i cili kryen funksionet e tij nen mbikeqyrjen e nje Keshilli Mbikeqyres.
- i. *Keshilli Mbikeqyres:* Keshilli Mbikeqyres do te perbehet nga 3 persona dhe anetaret e Keshillit Mbikeqyres te miratuar nga AMF jane
- Vaso Pilo, kryetar**
Rexhep Mejdani, anetar
Thanas Xhillari anetar
- j. *Bordi i Drejtoreve.* Bordi i Drejtoreve perbehet nga Administratori i vetem. Administratori i shoqerise i miratuar eshte Z. Erald Hysa.

3.3 Shoqerite Pritese:

Shoqeria Pritese e Jetes, Insig Jete Sha.:

Shoqeria Pritese Insig sha., do te ushtroje veprimtari ne sigurimin e jo-jetes me keto karakteristika:

- a. *Forma ligjore:* shoqeri aksionare.
- b. *Adresa e selise kryesore:* pallatet Rr. Kavajes, Nr. 116, Tirane, Shqiperi.
- c. *Objekti i regjistruar i veprimtarise se biznesit:* zhvillon aktivitet si shoqeri sigurimi e jo- jetes. Pritet saktisimi i licenses se re nga ana e AMF sipas statutit te miratuar prej Bordit te AMF.
- Klasat e sigurimit te cilat perfshihen ne licencen e sigurimit te jo-jetes per te do te dale dhe licensa e re jane:*

Grupet 19, 20, 21, 22, 23 "Sigurimi jetes"

e. Aksionaret ne daten e Raportit jane:

Aksionari	Numri i aksioneve	Te drejta direkte financiare/kontrolli %
Eurosig sha	616,66	100%

h. Kapitali dhe aksionet: ALL 370.000.000 (treqind e shtatedhjetë milion), i ndare ne 616,66 aksione te zakonshme, te regjistruara me te drejte vote me vlere nominale prej ALL 600.000secili

i. *Sistemi i administrimi me dy nivele:* Shoqeria administrohet dhe perfaqesohet nga Administratori i Pergjithshem i cili kryen funksionet e tij nen mbikeqyrjen e nje Keshilli Mbikeqyres.

j. *Keshilli Mbikeqyres:* Keshilli Mbikqyres do te perbehet nga 3 persona dhe anetaret e Keshillit Mbikeqyres te miratuar nga AMF jane

Vaso Pilo, Kryetar

Rexhep Mejdani, Anetar

Thanas Xhillari, Anetar

g. *Bordi i Drejtoreve.* Bordi i Drejtoreve perbehet nga Administratori i vetem. Administratori i shoqerise i miratuar eshte **Znj. Elvana Mino (Cara).**

3.2 Forma e transformimit

Forma e zgjedhur e transformimit eshte Ndarja sic perkufizohet ne Nenin 227 i Ligjit per Shoqerite Tregtare. Si pasoje e Ndarjes, kompanite Pritese do te trashegojne te gjitha pasurite, te drejatat, privilegjet dhe kompetencat sipas projektit financiar te ndarjes qe I bashkelidhet ketj dokumenti si dhe do te jene subjekt i te gjitha detyrave, detyrimeve dhe pergjegjesive sipas licensave te veprimtarise se secilit. Te gjitha policat dhe detyrimet e kompanise qe ndahet do te merren persiper nga kompanite Pritese sipas fushes se veprimtarise se tyre me te njejtat kushte njesoj sikur policat te vazhdonin te zbatoheshin nga kompania qe ndahet Insig sha.

Forma e zgjedhur e transformimit ligjor i korrespondon:

a. Arsyet ligjore dhe ekonomike te transformimit.



The image shows two handwritten signatures in black ink. Between and to the right of the signatures is a circular official stamp. The stamp contains the text: 'REPUBLIKA E SHQIPERISE', 'INSTITUTI I REGJISTRIMIT DHE IDENTIFIKIMIT TE SHOQERISES', 'TIRANE', and 'SECRETARIA'. In the center of the stamp is a logo consisting of the letters 'INR' inside a square.

- b. pasojave ligjore te pritura nga transformimi.
- c. kerkesave te Shoqerive pritese te themeluara rishtazi te lidhura me kosto ekonomike te permiresuara dhe rendiment te larte ne zbatimin ec konsolidimit te dy bizneseve.

Ne zbatimin e transformimit, Shoqerite qe Bashkohen do te marrin parasysh kerkesat ligjore dhe rregullatore specifikike qe zbatohen per shoqerite e sigurimit.

PJESA II -JUSTIFIKIMI LIGJOR

4. Permbajtja dhe forma e Projektmarveshjes se Ndarjes

Projektmarveshja e Ndarjes eshte hartuar nga kompania qe ndahet me miratim edhe te perfaqesuesve te projektuar te kompanive Pritese.

Aksionaret e Kompanise qe ndahet do te jene dhe aksionar te kompanive Pritese me te njejten % pjesmarrjeje, pra 100%.

Shoqerite Pritese nuk do t'i japin asnje privilegj Ekspertit te Pavarur, Administratorit dhe/ose Keshillit Mbikeqyrres te Shoqerive pritese te themeluara rishtazi.

5. Lejet rregullatore

Hyrja ne fuqi e ndarjes

- a. Depozitimit te Projektmarveshjes se Ndarjes dhe te gjithe dokumentacionit shoqerues prane QKR ne perputhje me Nenin 216 e vijues te Ligjit per Shoqerite Tregtare.
- b. Miratimit te Projektmarveshjes se Ndarjes nga Asambleja e Aksionareve e Shoqerise qe ndahet.
- c. Marrjes se miratimit per Ndarjen nga Autoriteti i Mbikeqyrjes Financiare ne perputhje me Ligjin 52/2014 date 22.05.2014 "Per veprimtarine e sigurimit dhe risigurimiC.
- d. Regjistrimit te Ndarjes prane QKR ne perputhje Ligjin per Shoqerite Tregtare.

6. Efektet Ndarjes

Ndarja do te hyje ne fuqi ne daten e regjistrimit te saj prane QKR ne perputhje me Ligjin per Shoqerite



The image shows two handwritten signatures in black ink. Between the signatures is a circular official stamp. The stamp contains the text: "REPUBLIKA E SHQERISE", "INSTITUTI I SIGURIMIT", "INIG", "TIRANE", and "ALBANIJA".

Tregtare.

Pasqyrat kontabel dhe financiare do te ndahen dhe paraqiten te ndara sikur shoqerite te kishin qene gjithmone me vete ne daten qe Ndarja regjistrohet prane QKR.

7. Statuset e shoqerive pritesese te themeluara rishtazi pas Ndarjes

Me regjistrimin e Ndarjes prane QKR shoqeria qe ndahet do te kaloje ne faze crregjistrimi pa likujdim.

Qe nga data e hyrjes ne fuqi te Ndarjes, statusi ligjor dhe karakteristikat shoqerore te shoqerive pritesese te themeluara rishtazi do te jene ato te pershkruara ne piken 3 me lart.

Statutet e miratuara te shoqerive pritesese te themeluara rishtazi do te hyjne ne fuqi pas depozitimit ne QKR se bashku me Marrveshjen e Ndarjes te miratuar.

8. Efektet e Ndarjes mbi Punonjesit E Shoqerive pritesese te themeluara rishtazi

Nuk parashikohet qe te kete shkurtime te asnje punonjesi per shkak te ndarjes keshtu qe ndarja nuk do te kete efekt mbi punonjesit. Kontratat e punes do te rilidhen me te njejtat kushte nga shoqerite Pritese.

Duke qene se brenda Shoqerise do te Ndahet ka patur nje department qe merrej kryesisht dhe vetem me produktet e jetes, eshte parashikuar qe ky department do te kaloje I gjithi ne kompanine Pritese Insig Jete sha. Po ashtu nje pjese e stafit mbeshtetes do te kaloj prane shoqerise Insig Jete sha., qe konsiston ne specialist nga Dep. I Finances, Dep. IT, Dep. Riskut dhe aktuaristikes, Dep. Juridik, Dep. Auditit.

9. Garancite per mbrojtjen e te drejtave te personave te siguruar. Detyrimi i Shoqerive pritesese te themeluara rishtazi ndaj personave te siguruar

Te gjitha parakushtet qe garantojne mbrojtjen e te drejtave dhe interesave te personave te siguruar jane krijuar dhe Shoqerite Pritese do te ndermarrin te gjitha veprimet e nevojshme per te permbushur detyrimin per mbrojtjen e te drejtave dhe interesave te personave te siguruar.

Per te ndermarre angazhimin e mesiperem, Shoqerite Pritese kane marre ne konsiderate se

- a. Shoqerite Pritese do te zevendesojne Shoqerine qe Ndahet si pale ne te gjitha kontratat e sigurimit te lidhura nga kjo e fundit.
- b. Miratimi I statutit te seciles prej kompanive priteve nga AMF garanton se Shoqerite Pritese



zoterojne licensat perkatese per kryerjen e veprimtarise se sigurimit te jo-jetes per Inisg sha., dhe te jetes per Inisg Jeta sha.

- c. Qe nga data e regjistrimit te Ndarjes prane QKR, Shoqerite Pritese do te kene fondet dhe marzhin e likuiditetit te tyre ne perputhje me kerkesat e Ligjit Shqiptar per Sigurimin dhe me dispozitat e tjera te zbatueshme te legjislacionit ne fuqi.
- d. Ne daten e regjistrimit te Ndarjet prane QKR, rezervat e sigurimit te krijuara nga Shoqeria qe ndahet sipas llojit perkates te sigurimit do te transferohen ne rezervat e te njejtin lloj ne Shoqerite Pritese er te njejtin lloj sigurimi.
- e. Te drejtat dhe detyrimet e personave te siguruar me kontratat e sigurimit te lidhura me Shoqerine qe ndahet do te mbeten te pandryshuara pas Ndarjes pavaresisht nga kalimi i kontratave te sigurimit te Shoqerite Pritese sipas fushes se tyre te veprimtarise.
- f. Ne perputhje me Ligjin e Sigurimit dhe Risigurimit, Shoqerite Pritese marrin persiper te informojne mbajtesit e policave ne lidhje me kryerjen e Ndarjes brenda 10 diteve nga regjistrimi i Ndarjes prane Regjistrin Tregtar nepermjet:

Publikimit ne te pakten dy gazeta kombetare ditore per te pakten 5 dite rresht;

Publikimit ne faqen web te Shoqerise qe ndahet dhe ne faqet e Shoqerive pritese te themeluara rishtazi

- g. Te gjitha pretendimet e sjella nga Shoqeria qe Ndahet kunder paleve te treta dhe anasjelltas, si dhe te gjitha proceset gjyqesore, administrative dhe te arbitrazhit dhe cdo proces tjetër qe eshte ne zhvillim ne daten e regjistrimit te Ndarjes prane QKR do te vazhdohen dhe perfundohen nga Shoqerite Pritese ne perputhje me fushen e tyre te veprimtarise. Keto te fundit do te lidhen dhe do te kene te drejte te perfitojne nga te gjitha veprimet te cilat jane ndermarre nga Shoqeria qe Ndahet ne proceset e mesiperme perpara Dates se Ndarjes.
- a. Administratoret dhe Organet Mbikeqyrese te Shoqerive pritese te themeluara rishtazi kane eksperience te gjere ne fushen e sigurimeve. Shoqerite Pritese kane zotesi teknike dhe personel te shkelqyer si dhe rregullore te brendshme ne perputhje me kerkesat ligjore ne fuqi.
- b. Faqja web e Shoqerise qe Ndahet do vazhdoje te funksionojë per nje periudhe jo me te shkurter se gjashte muaj nga Data e Ndarjes. Faqja web do te publikoje informacion ne lidhje me Ndarjen dhe nje *hyperlink* per ne faqen web te seciles prej Shoqerive pritese te themeluara rishtazi.

10. Mbrojtja e kreditoreve

Ne perputhje me Nenin 221 te Ligjit per Shoqerite Tregtare, qe nga data e regjistrimit te Ndarjes prane



The image shows two handwritten signatures in black ink. Between the signatures is a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPERISE' at the top, 'MINISTRI E TREGTARISE DHE FINANCES' around the inner edge, and 'TIRANE' at the bottom. In the center of the stamp, the letters 'ING' are printed in a large, bold font.

QKR, Shoqerite Pritese marrin persiper te administrojne ne menyre te vazhduar biznesin e sigurimit te shoqerise qe ndahet ne perputhje me fushat e tyre te veprimtarise sipas licensave perkatese.

11. Detaje per Ekspertin e Pavarur

Bordi I Drejtoreve I shoqerise ne takimin e mbajtur me 11.10.2016 caktuan Shpresa Breçanin si Eksperte e Pavarur per Ndarjen.

Eksperti i pavarur i caktuar kreu punimet ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregtare si dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar te zbatueshem.

Ekspertit iu vu ne dispozicion i gjithe informacioni, dokumentacioni dhe te dhenat e nevojshme. qe do ta lejonin te pergatise raportin e Ekspertit te Pavarur.

PJESA III - JUSTIFIKIMI EKONOMIK

12. Norma e kembimit te aksioneve

Si pasoje e Ndarjes, aksioneri i shoqerise qe ndahet, Eurosig sha., do te jete 100% ne secilen prej Shoqerive pritese te themeluara rishtazi. Te gjitha asetet e paluajteshme te shoqerise qe ndahet do te kalojne tek Shoqeria Pritese Insig sha.

Kapitali themeltar I Shoqerive pritese te themeluara rishtazi do te jete si vijon:

Shoqeria Pritese Insig sha.

Aksionari	Nr. i aksioneve te zoteruara	% ne kapital	Vlera e aksioneve te zoteruara ne lek
Eurosig sha.	1.083,33	100	650.00.000

Shoqeria Pritese Insig Jete sha.



The image shows two handwritten signatures in black ink. Between the signatures is a circular official stamp. The stamp contains the text: 'REPUBLIKA E SHQERISE' at the top, 'INSTITUTET I SIGURIMISE' in the center, and 'TIRANE' at the bottom. In the middle of the stamp, there is a logo consisting of the letters 'INSIG' in a stylized font.

Aksionari	Nr. i aksioneve te zoteruara	% ne kapital	Vlera e aksioneve te zoteruara ne lek
Eurosig sha.	616,66	100	370.000.000,00

14.1. Arsyet per nisjen e procedurave te Ndarjes

Arsyet per nisjen e procedurave te ndarjes kane zanafillen ne kerkesen e ligjit 52/2014 ku eshte e parashikuar se shoqerite e sigurimit te jetes dhe jo-jetes funksionojne si kompani me vete. Nisur nga fakti qe shoqeria Insig sha., gjate kohes qe ka qene me kapital shteteror, per shkak te ligjit ka funksionuar me dy licensa, pas privatizimit te saj doli e nevojshme ndarja e shoqerive me vete. Pavaresisht prej kesaj Shoqerite Pritese kane pergatitur plan biznese ambicioze per rritjen e efikasitetit dhe pozicionimin sa me te mire ne treg duke ruajtuar identitetin dhe trashegimine e kompanise se pare te sigurimeve ne vendimin tone. Ne besojme se Ndarja do te sjelle thjeshtezimin e struktures, organizim me te mire te veprimtarise dhe do te lehtësoje si veprimtarine e perditshme ashtu dhe planifikimin strategjik duke pasur objektiv paresor interesin e klienteve dhe te aksionareve.

Ristrukturimi i departamenteve te marrjes ne sigurim, marketingut, auditit te brendshem, burimeve njerezore, ligjore, shperndarjes, shitjes dhe departamenteve te tjera si dhe administrimi me i mirene pergjithsesi, do te sjelle kapacitete financiare dhe burime njerezore shtese duke qene se keta te fundit do te kene mundesine te fokusohen duke punuar dhe administruar nje strukture me kompakte dhe ekonomikisht me efikase. Si pasoje, pritet nje shperndarje pune me e mire ndermjet departamenteve, uljen e rrezeqeve te tregut dhe do te siguroje nje mbrojtje me te mire te klienteve.

Pra si efekt afatgjate i Ndarjes mendojme se do te jete permiresimi i rendimentit te rezultateve financiare te shoqerive pritese te themeluara rishtazi dhe nje qartesi e aktivitetit te tyre. Sipas pritshmerive te Administratoreve te Shoqerive pritese te themeluara rishtazi, riorganizimi i struktures qe do te kryhet me Ndarjen do te sjelle thjeshtezimin e proceseve dhe shkurtrimin e kohes se reagimit ndaj tregut. Administrimi i fokusuar ne veprimtari me shume fitimprures do te sjelle mundesi shume me te medha per te rritur konkurrencen e shoqerise pritese, gje qe do te reflektoje ne menyre te drejtperdrejte ne qendrueshmeri ne treg.

The image shows a handwritten signature on the left and a circular official stamp on the right. The stamp contains the text: 'REPUBLIKA E SHQIPERISE', 'INSTITUTI I SIGURIMIT', 'INSIG', 'TIRANE', and 'SECRETARIA'.

Me respekt

Administratori I Shoqerise qe ndahet

Insig sha.

Erald Hysa



Miratuar pa verejtje

Administratoret e Shoqerive pritesë të themeluara rishtazi

Insig sha.

Erald Hysa



Insig Jete sha.

Elvana Mino



**RAPORT MBI VERIFIKIMIN E PROCEDURAVE PER
NDARJEN E SHOQERISE INSIG SH.A. SHQIPERI
NE INSIG SH.A. DHE INSIG JETE SH.A**

Tirane, 25 Nentor 2016

PERMBAJTJA

Raport i Eksperteve Kontabel te Regjistruar (EKR)

Informacione te Pergjithshme

- I. Referenca Ligjore*
- II. Realizimi i misionit per verifikimin e procedurave te ndarjes se shoqerise INSIG sh.a. ne shoqerite pritesse INSIG sh.a. dhe INSIG JETE sh.a.*
- III. Vleresimi i Kapitalit te dy shoqerive te reja pritesse INSIG sh.a. dhe INSIG JETE sh.a.*

Dokumente mbeshtetese:

- Pasqyrat Financiare individuale te shoqerise INSIG sha per periudhat 2013, 2014 dhe 2015
- Raporti Aktuarial per shoqerine INSIG sha
- Plan Biznesi per shoqerine INSIG sha
- Raporti Aktuarial per shoqerine INSIG JETE sha
- Plan Biznesi per shoqerine INSIG JETE sha
- Procesverbalet e inventareve fizik te dates 30/09/2016
- Rregjistri i aktiveve afatgjata materiale
- Lista e Klienteve dhe Kreditoreve

**RAPORT I EKSPERTEVE KONTABEL TE REGJISTRUAR MBI VERIFIKIMIN E PROCEDURAVE PER
NDARJEN E SHOQERISE INSIG SH.A. SHQIPERI
NE
INSIG SH.A. DHE INSIG JETE SH.A.**

PER: Asamblene e Aksionereve te shoqerise INSIG sh.a
Drejtorit te Pergjithshem te INSIG sh.a.

Te nderuar Zoterinj!

Duke Ju falenderuar per dhenie e besimit ne misionin tone te pavarur kemi nderin t`u raportoje ne lidhje me dhenien e sigurise se pavarur mbi procesin e ndarjes se shoqerise INSIG sh.a. ne shoqerite INSIG sh.a dhe INSIG JETE sh.a.(shoqerite pritese)

Ky mision eshte kryer ne pajtim me SNA-te (Standardet Nderkombetare te Auditimit) te publikuara nga IAASB (Bordi i Standardeve Nderkombetare te Auditimit dhe Sigurise) te IFAC (Federates Nderkombetare te Kontabilisteve).

Raporti yne nuk synon te jete gjithepershires, por te theksoje dhe te sjelle ne vemendjen tuaj çeshtje kryesore te caktuara sipas qellimit te punes te rene dakort.

Raporti eshte konfidencial per Ju, sikunder eshte rene dakort, dhe eshte subjekt i limitimeve ne perdorim, specifikuar ne Kontrate. Palet e treta, perveç atyre te permendura ne Kontrate, mund ta zoterojne materialin kundrejt firmosjes se Letres se Pademshmerise. Ne nuk mbajme asnje pergjegjesi kundrejt çdo pale ne lidhje me permbajtjen e Raportit.

Si rezultat i kufizimeve, kohes ne dispozicion, informacionit dhe/apo aksesit, ne mund te mos kemi identifikuar te gjitha faktet apo informacionin e nevojshem per Sherbimin apo ato qe Ju mund ti konsideroni si te rendesishme.

Ne keto rrethana, ne mund te mos jemi plotesisht ne dijeni te fakteve apo informacionit qe Ju konsideroni te rendesishem. Rrjedhimisht, ne nuk mbajme asnje pergjegjesi mbi besueshmerine, saktesine, plotesine apo keqinterpretimin e informacionit apo çeshtje qe nuk mbulohen ne Raport apo qe rrjedhin si pasoje e natyres se limituar te punes sone.

Përgatitja e deklarimeve financiare, juridike është përgjegjësi e drejtimit të INSIG sh.a. për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre informacioneve te domosdoshme per dhenien e sigurise se procesit te ndarjes se shoqerise INSIG sh.a të përshtatshme me rrethanat.

Përgjegjësia e Eksperteve Kontabel të Regjistruar (EKR) është të formojme një opinion të pavarur mbi këte proces, bazuar në verifikimet tona.

Nga ana jone realizimi i ketij misioni per verifikimin e ndarjes se shoqerise INSIG sh.a. Shqiperi, ne shoqerite INSIG sh.a. dhe INSIG JETE sh.a.(shoqeri pritesa) paraqitet si me poshte:

- i. Përgatitja e Raportit mbi verifikimin e procedurave per ndarjen e shoqerise INSIG sh.a. ne INSIG sh.a. dhe INSIG JETE sh.a. me date 30 Shtator 2016, sipas vleres kontabel te Pasqyrave Financiare individuale te INSIG sha, ne daten 30.09.2016.
- ii. Ndarjen e aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit nga INSIG sha ne 2 (dy) shoqeri aksionere si me poshte:
 - Shoqeria "INSIG " sha
 - Shoqeria "INSIG JETE" sha,
- iii. Sistemimin perfundimtar te vleresimit te aktiveve, detyrimeve dhe Kapitalit te INSIG sh.a ne daten e hyrjes ne fuqi te Ndarjes ne shoqerite aksionere:
 - Shoqeria "INSIG" sha
 - Shoqeria "INSIG JETE" sha

Per realizimin e ketij misioni ne e perqendruam punen tone per verifikimin e procedurave te ndjekura per ndarjen e Aktiveve, Detyrimeve dhe Kapitalit te INSIG sha dhe per krijimin e kapitalit te 2(dy) shoqerive nga kjo ndarje, INSIG sh.a. dhe INSIG JETE sh.a. duke u perqendruar ne:

- ✓ Verifikimin mbi bazën e dokumentave juridikë, te inventareve kontabël dhe te evidencave te tjera te domosdoshme që mbështesin shumat dhe informacionet e dhëna në Pasqyrat Financiare individuale te dates 30.09.2016 te ndara ne INSIG sh.a dhe INSIG JETE sh.a.
- ✓ Verifikimi i inventareve fizike te Aktiveve Afatgjate Materiale (AAM) dhe te Aktiveve ne Magazine (AM) qe mbështesin shumat dhe informacionet e dhëna në Pasqyrat Financiare individuale te dates 30.09.2016 te ndara ne INSIG sh.a dhe INSIG JETE sh.a.
- ✓ Vendodhjen e AAM-ve (Aktiveve Afatgjate Materiale) dhe te AM-ve (Aktiveve ne Magazine).
- ✓ Ndarja e ketyre Aktiveve nga INSIG sha ne shoqeri aksionere si me poshte:
 - Shoqeria "INSIG" sha
 - Shoqeria "INSIG JETE"sha,
- ✓ Vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të Pasqyrave Financiare te dates 30.09.2016 te ndara ne INSIG sh.a dhe INSIG JETE sh.a. si dhe percaktimin e kapitalit per keto shoqeri.
- ✓ Vlerësimin mbi nivelin e kerkuar te aftesise paguese, verifikimin e provigjioneve teknike, vleren dhe llojin e investimit te pafinancuar nga primi i rrezikut, vleren e aktiveve qe mbulojne provigjionet teknike, normen e likujdimit si dhe rreziqet e mara per cdo klase sigurimi e te tjera kerkesa te parashikuara ne ligj, te shoqeruara me opinionin e aktuarit te kontratuar.
- ✓ Verifikimin e fondit te garancise.

Pas verifikimit të të gjithë procesit dhe dokumentacionit të përshkruar më sipër, mbi bazën e të cilëve është percaktuar vlera e kapitalit të INSIG sh.a dhe INSIG JETE sh.a. si dhe është organizuar ndarja e tyre në 2(dy) shoqëri aksionere pritesë rezulton si më poshtë:

- Shoqëria "INSIG" sh.a ka kapitalin themeltar aksioner **650.000.000** leke
- Shoqëria "INSIG JETE" sh.a ka kapitalin themeltar aksioner **370.000.000** leke
- Shoqëria "INSIG" sh.a priset pa likuidim

OPINION

Sipas Opinionit tone:

-Metoda e përdorur për llogaritjen e raportit të kembimit të aksioneve është Metoda e Vlerës Kontabel Neto. Kjo metode është e ndryshme nga Vlera e Tregut aktual, metode e cila mund aplikohet në vazhdimësi pas këtij procesi, në zbatim të politikave kontabel të ndryshme, qoftë në rivlerësimin e aktiveve apo të të tjera cmuarjeve kontabel.

-Në kushtet kur shoqëritë përfituese zotërohen 100% secila nga i njëjti aksioner i shoqërisë që ndahet, përdorimi i metodave të tjera në raport me metodën e përdorur nuk sjell asnjë impakt mbi përlogaritjet mbi raportin e kembimit të aksioneve.

-Raporti i kembimit të aksioneve është i drejtë dhe i arsyeshëm.

-Vlerësimi i kapitalit baze, të bërë nga Drejtimi, për secilën shoqëri pritesë nga Ndarja e shoqërisë "INSIG" sh.a Shqipëri është llogaritur në përputhje me metodologjinë e percaktuar në Ligjin Nr.52/2014 "Për Veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit" dhe rregulloren e AMF-se.

Pas verifikimit të procedurave të ndarjes së kapitalit të INSIG sh.a dhe Krijimi i Kapitalit Aksioneri të 2(dy) shoqerive pritesë:

REKOMANDOJME :

- ✓ Ne baze të këtij Raportit të Posaçem, aplikimin dhe kryerjen e veprimeve në Qendren Kombëtare të Biznesit, sipas vlerës së paraqitur në raport.
- ✓ Vazhdimin e vijueshmërisë së Pasqyrave Financiare individuale të INSIG sh.a dhe ndarja e tyre në 2(dy) sh.a të krijuara deri në finalizimin e procesit të ndarjes.
- ✓ Sistemimin perfundimtar të aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit të INSIG sh.a në datën e hyrjes në fuqi të Ndarjes
- ✓ Njoftimet për ndarjen e INSIG sh.a në dy shoqeri INSIG sh.a dhe INSIG JETE sh.a. në Drejtoritë Rajonale Tatimore dhe në të gjitha institucionet përkatëse rregullatore.
- ✓ Lidhur me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme të ndiqen procedurat e aplikimit në institucionet përkatëse, me hyrjen në fuqi të Ndarjes.
- ✓ Lidhur me likuiditetet egzistuese dhe "Ilogarine e fondit të garancisë" të shoqerisë INSIG sh.a. pas hyrjes në fuqi të ndarjes të ndiqen procedurat në institucionet financiare përkatëse.
- ✓ Të zbatohen procedurat e Kodit të Punes, të miratuara me Ligjin nr.7961, datë 12/07/1995, i ndryshuar dhe Kontratat aktuale të punesimit, nëse Ndarja do të sjellë pasoja për punonjësit.

Ky Raport Hartohet në 4(kater)kopje nga të cilat 3 (tre) dorezohen pranë INSIG sh.a.

GRUPI I EKSPERTEVE KONTABEL TË REGJISTRUAR

nH EuroConsult sh.p.k.

Eksperte Kontabel e Regjistruar

Shpresa BRECANI

Lic. Nr. 143

Administrator

Nexhmije CELA

Lic. Nr.84

*RAPORT I POSAÇEM MBI VERIFIKIMIN E PROCEDURAVE TE NDARJES SE SHOQERISE
INSIG SH.A. SHQIPERI
NE INSIG SH.A. DHE INSIG JETE SH.A*

INFORMACIONE TE PERGJITHSHME

INSIG Sh.a. ("Shoqëria") është themeluar në 1991 si një shoqeri sigurimi 100% në pronësi të Qeverisë së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave.

Aktiviteti kryesor i biznesit të saj përfshin sigurimin e shërbimeve të sigurimit për mjetet motorike, pronë, jetë, marinë dhe lloje të tjera sigurimi. Pasqyrat Financiare individuale të konsoliduara të Shoqërisë përfshijnë Shoqërinë dhe filalet e saj.

Më 1 Mars 2000 Shoqëria ka hapur një degë në Kosovë. Kjo degë ofron kryesisht sigurime të mjeteve motorrike dhe sigurim te palëve të treta në të gjithë territorin e Kosovës.

Gjatë vitit 2004, Shoqëria filloi të operojë edhe në territorin e Republikës së Maqedonisë nëpërmjet INSIG Maqedonia. INSIG Macedonia është 100% në pronësi të INSIG Sh.a.

Më 19 Mars 2015 Kuvendi i Shqipërisë miratoi ndryshimin e pronësisë së kompanisë mëmë nga Ministria e Financës tek Ministria e Ekonomisë dhe gjithashtu anulloi rregulloren paraprake për privatizimin e "INSIG" sh.a.

Më 25 Janar 2016, tenderi për privatizimin e 100% të aksioneve në "INSIG" sh.a. është shpallur publikisht dhe ofertat përkatëse janë pranuar më 10 Mars 2016.

Më 23 Mars 2016 në bazë të Vendimit nr 218 të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë "Per miratimin e procedures se tenderimit per shitjen e paketes se aksioneve (100 %), te zoteruara nga shteti ne shoqerine INSIG Sh.a." eshte shpallur fitues shoqeria "EUROSIG" SH.A.", per blerjen 100% te aksioneve te shoqerise INSIG sh.a. Gjithashtu edhe pajisjen me Autorizimin Nr. 4935 te Ministrise se Financave per kryerjen e pageses se vleres se plote te paketes shteterore te aksioneve prej 100% te "INSIG" sh.a.

Më 1 Qershor 2016 u nënshkrua marrëveshja e blerjes dhe u morën aprovimet e nevojshme rregullatore dhe më 2 qershor 2016 transferimi i aksioneve u regjistrua në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ("QKR").

Shoqëria shqiptare e sigurimit INSIG sh.a., ka patur për shkak të ligjit 2 licenca për ushtrimin e veprimtarisë siguroese në sigurimin e Jetes dhe Sigurimin e Jo-Jetes.

Në datë 01.06.2016 është miratuar privatizimi i Insig sha., dhe për këtë shkak, në funksion të Ligjit nr.52/2014, në nenin 6, pika 2 *“Shoqëria e sigurimit, që ushtron veprimtari sigurimi për klasat e sigurimit të jetës, nuk ushtron në të njëjtën kohë veprimtari sigurimi për klasat e sigurimit të jojetës dhe anasjelltas”* dhe neni 261, pika 2 *“Shoqëria e sigurimit INSIG, sh. a., e cila ushtron veprimtari sigurimi, në përputhje me pikën 1, të këtij neni, është e detyruar: a) të mbajë librat tregtarë/kontabël dhe të hartojë pasqyra financiare të ndara për veprimtarinë në klasat e jetës dhe klasat e jojetës; b) të llogarisë kapitalin e shoqërisë, në përputhje me nenin 75, të këtij ligji, të ndarë për klasat e jetës dhe klasat e jojetës.”* si dhe pikës 3 të tij *“Pas privatizimit, shoqëria INSIG, sh. a., është e detyruar të përshtatë veprimtarinë e saj, në përputhje me pikën 2, të nenit 6, të këtij ligji”* duhet të bëjë ndarja e shoqërisë INSIG sh.a., në dy shoqëri Pritese Insig sh.a., dhe Insig Jete sh.a.

INSIG Sh.a. është një shoqëri shqiptare sigurimi e regjistruar pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit (“QKR”) me NIPT (NUIS) J62006012D, me seli në Rr. Kavajes, 116, Tiranë, Shqipëri.

Klasat e sigurimit të cilat përfshihen në licencën e sigurimit të jetes dhe jo-jetes janë:

2.2 Interesa dhe shpenzime të tjera të investimeve	0
3. Fitim / Humbje nga shitja e investimeve (1.1+1.2+1.3+1.4+1.5)	0
1.1 Aksione	0
1.2 Letra borxhi	0
1.3 Kredi të dhëna kundrejt hipotekave	0
1.4 Pasuri e paluajtshme	0
1.5 Të tjera	0
XII Të ardhura të llogaritura nga investimet të transferuara në llogarinë teknike (-)	0
XIII Të ardhura të tjera	5,030,772
XIV Fitime / humbje të tjera nga investimet (+/-)	-5,664,206
XV Të ardhura të jashtëzakonshme	0
XVI Shpenzime të jashtëzakonshme	0
XVII Fitime / Humbje para tatimit (IX+X+XI-XII+XIII+XIV+XV-XVI)	96,756,476
XVIII Tatimi mbi fitimin	
XIX Fitime / Humbje neto për periudhën (XVII-XVIII)	96,756,476

- ✓ Kapitali Aksioner i shoqerise "INSIG"sha eshte 650.000.000 LEKE
(Gjashteqindepesdhjetemilion)
- ✓ Me vlere nominale 600,000 leke/aksion,
- ✓ Numri i aksioneve 1,083.3334 cope
- ✓ Aksioner i vetem eshte EUROSIG sh.a.

Theksojme se :

1.Veprimet e sistemimit perfundimtare te ketij procesi do te vazhdojne pas miratimit te ndarjes nga QKB-ja.

2.Vazhdimi i vijueshmerise se Pasqyrave Financiare individuale te INSIG sha dhe ndarja e tyre perfundimtare ne 2(dy) sha te krijuara deri ne finalizimin e procesit te ndarjes.

B. INSIG JETE sh.a

Informacione te Pergjithshme

INSIG JETE sha., do te operoje sipas statutit te miratuar nge Bordi i AMF me vendimin nr. 126 date 24.08.2016 si dhe ne zbatim te Ligji Nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Si shoqeri pritesse INSIG JETE sh.a nga ndarja e shoqerise (qe do te prodhoje pasojat e percaktuara ne nenin 227 te Ligjit Tregtar, dhe rrjedhimisht, duke filluar nga dhe pas dates se Hyrjes ne Fuqi) do te zoterojne te gjitha pasurite, te drejtat, privilegjet dhe kompetencat dhe do t'i nenshtrohet te njejtave detyrimeve dhe pergjegjesive si Shoqeria qe Ndahet (INSIG sh.a).

Te gjitha policat dhe detyrimet e Shoqerise qe Ndahet do te merren persiper nga Shoqeria Pritese brenda kufijve te licenses se tyre dhe me te njejtat kushte sikur keto polica dhe te drejta te zbatoheshin akoma nga Shoqeria qe ndahet.

Administratori i Pergjithshem i shoqerise INSIG JETE do te jete Znj. Elvana Mino, shtetase shqiptare, lindur ne Tirane me date 16.07.1967, mbajttese e ID me nr. 024473069

Anetaret e Keshillit Mbikeqyres te Shoqerive Pritese te miratuara sipas vendimit te AMF do te jene personat e meposhtem:

- 1- Zoti Vasil Pilo - Kryetar
- 2- Zoti Rexhep Mejdani - Anetar
- 3- Zoti Thanas Xhillari - Anetar

Nuk parashikohet qe te kete shkurtime te asnje punonjesi per shkak te ndarjes keshtu qe ndarja nuk do te kete efekt mbi punonjesit. Kontratat e punes do te rilidhen me te njejtat kushte nga shoqerite Pritese. Duke qene se brenda Shoqerise qe do te Ndahet ka patur nje department qe merrej kryesisht dhe vetem me produktet e jetes, eshte parashikuar qe ky department do te kaloje i gjithi ne kompanine Pritese Insig Jete sha. Po ashtu nje pjese e stafit mbeshtetes do te kaloj prane shoqerise Insig Jete sha., qe konsiston ne specialist nga Dep. I Finances, Dep. IT, Dep. Riskut dhe aktuaristikes, Dep. Juridik, Dep. Auditit etj.

Klasat e sigurimit te cilat perfshihen ne licencen e sigurimit te jo-jetes jane:

Grupet 19, 20, 21, 22 "Sigurimi jetes"

Baza ligjore:

Ligji Nr.52/2014 "Per Veprimtarine e Sigurimit dhe Risigurimit",

Ligji Nr.9901, date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare",

Ligjin Nr. 9228 dt. 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar

Ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit",

Ligji Nr.9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne republiken e Shqiperise", i ndryshuar

Ligj Nr.92/2014, datë 24.7.2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar

Standardet Nderkombetare te Auditimit

KRIJIMI I KAPITALIT AKSIONER PER SHOQERINE "INSIG JETE" SH.A.

Per realizimin e ketij misioni ne e perqendruam punen tone per verifikimin e procedurave te ndjekura per ndarjen e aktiveve, detyrimeve dhe Kapitalit te INSIG sha dhe krijimin e Kapitalit Aksioner te shoqerise "INSIG JETE" sha si me poshte :

- Verifikimi mbi bazën e dokumentave juridikë, te inventareve kontabël dhe te evidencave te tjera te domosdoshme që mbështesin shumat dhe informacionet e dhëna në Pasqyrat Financiare te dates 30.09.2016 te INSIG JETE te cilat jane pjese e Pasqyrave Financiare individuale te INSIG sha.
- Verifikimi i inventareve fizike te Aktiveve Afatgjate Materiale (AAM) dhe te Aktiveve ne Magazine(AM) qe mbështesin shumat dhe informacionet e dhëna në Pasqyrat Financiare te dates 30.09.2016 te INSIG JETE sh.a. te cilat jane pjese e Pasqyrave Financiare individuale te INSIG sha.
- Vendodhjen e AAM-ve(Aktiveve Afatgjate Materiale) dhe te AM-ve (Aktiveve ne Magazine).
- Vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të Pasqyrave Financiare te dates 30.09.2016 te INSIG JETE sh.a. per percaktimin e kapitalit themeltar aksioner.
- Ndarja e ketyre Aktiveve te ndara nga INSIG sha ne shoqeri aksionere si me poshte:
 - Shoqeria "INSIG JETE" sha

Verifikimi i të gjithë procesit dhe i dokumentacionit të përshkruar më sipër, mbi bazën e të cilëve eshte percaktuar vlera e kapitalit te INSIG JETE sha. duke bere nje pershkrim te shkurter te pozicioneve te llogarive ne Aktivit, Detyrimeve dhe Kapitalit te Pasqyra financiare me 30.09.2016.

Pozicionet e llogarive te aktivitet, detyrimit dhe kapitalit do te ndyshojne me perfshirjen e sistemimeve perfundimtare me hyrjen ne fuqi te Ndarjes.

I. AKTIVE AFATGJATE MATERIALE (AAM)

Aktivet e INSIG JETE sha aktualisht jane me titull pronesia si prone e INSIG sha. Me perfundimin e procesit te ndarjes do kalojne ne pronesi te INSIG JETE sha.

Aktivet Afatgjate Materiele (AAM) te INSIG JETE sha perbehen si me poshte:

1. Toka dhe ndertesa 0 leke
2. AAM te tjera 5.416.506 leke

VLERA E MBETUR ME 30.09.2016 E AKTIVEVE AFATGJATE MATERIALE (AAM-ve)
GJITHSEJ = **5.416.506 LEKE**

II. AKTIVE AFATGJATE JOMATERIALE(AAJM)

Ne Aktive Afatgjate jo-materiale(AAJM) jane perfshire vlera e softwear(programe elektronike) vlera e mbetur gjithsej **2.840.276 leke**.

III.INVESTIME FINANCIARE

Investime të tjera në filiale dhe shoqëri me interesa pjesëmarrëse 0 leke

IV.INVESTIME TE TJERA FINANCIARE

- Letra më vlera te Qeverise 548.943.549 leke
- Depozita ne banke 0 leke

V. ASETE TE RISIGURIMIT

Pjesa e risiguruesve në provizionet teknike

- Per provizione te primit te pafituar 3.823.819 leke
- Per provizione te demeve 0 leke

VI. TE ARKETUESHME TREGETARE

Te arketueshme nga veprimtaria direkte e sigurimit 13.116.107 leke

- Policmbajtes 13.228.732 leke
- Ndermjetes - 112.624 leke

Te arketueshme nga veprimtaria e risigurimit 0 leke

Te tjera te arketueshme tregetare 0 leke.

VII.PARAPAGIME DHE TE ARDHURA TE LLOGARITURA

- *Shpenzime te marrjes ne sigurim te shtyra 6.035.746 leke*
- *Interesa dhe qera te llogaritura 7.075.070 leke*

VIII.MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTE TE MJETEVE MONETARE

- *Banka 3.609.719 leke*
- *Arka 0 leke*

IX.AKTIVE AFATSHKURTER MATERIALE (Inventari)(AM)

Ne Aktivet afatshkurter materiale jane perfshire gjendja e materialeve ne magazine ne daten 30.09.2016 ne vleren 0 leke

AKTIVE AFATSHKURTER MATERIALE (Inventari)= 0 Leke

X.KAPITALET E VETA

Ne llogarine e kapitaleve te veta eshte perfshire llog.

- Kapitali aksioner 370.000.000 leke
- "Rezerva te kapitalit 71.706.777 leke
- Rezerva ligjore 0 leke
- Rezerva rivleresimi 0 leke
- Fitim dhe humbje e mbartur 0 leke

- Fitim per periudhen ushtrimore(01.01.2016-30.09.2016) 27.356.938 leke.

KAPITALET E VETA ne total jane ne vleren **469.063.715 leke**

Per llogaritjen e kapitalit te shoqerise se sigurimit, referuar nenit 75 te Ligjit Nr.52/2014 "Per Veprimtarine e Sigurimit dhe Risigurimit", jane marre parasysh elementet e kapitalit baze, elementet e kapitalit shtese si dhe elementet e zbritshem ne llogaritjen e kapitalit.

Kapitali baze, perbehet nga aksionet e zakonshme te emetuar 370.000.000 leke, rezervat e kapitalit 71.706.777 leke dhe fitimi i pashperndare 27.356.938 leke.

Kapitali shtese eshte zero.

Elementet e zbritshme te kapitalit perbehet nga 845.486 leke.

Kapitali i shoqerise nuk mund te jete me i ulet se niveli i kerkuar i aftesise paguese, i cili percaktohet si vlera me e larte midis fondit te garancise dhe 150% te kufirit minimal te aftesise paguese.

Llogaritja se kufirit minimal te aftesise paguese.

Ne mbeshtje te parashikimeve dhe llogaritjeve te kufirit minimal te aftesise paguese per biznesin INSIG JETE per periudhen 12 mujore rezulton qe ky kufi eshte nen limitin e fondit te garancise.

Fondi i garancise per shoqerine INSIG JETE nuk mund te jete nen kufirin e percaktuar ne nenin 81, pika 3 b) e Ligjit nr Ligji Nr.52/2014 "Per Veprimtarine e Sigurimit dhe Risigurimit", nen vleren 370.000.0000 leke.

Rrjedhimisht Kapitali prej 370.000.000 leke eshte ne perputhje me kerkesat e Ligjit Nr.52/2014 "Per Veprimtarine e Sigurimit dhe Risigurimit".

XI. PROVIZIONET TEKNIKE

Ne llogarine e Provizioneve Teknike është përfshirë llog.

- Provizione të primit të pafiturar 48.319.258 leke
- Provizione të demeve 72.004.705 leke

PROVIZIONET TEKNIKE në total janë në vlerën **120.323.963 leke**

XII. PROVIZIONET PER RREZIQE DHE DETYRIME TE TJERA

Ne llogarine e Provizioneve për Rreziqe dhe detyrime të tjera është përfshirë llog.

- Provizione të tjera 0 leke

XIII. LLOGARI TE PAGUESHME TREGETARE perbehen nga 1.473.113 leke

I. Llogari të pagueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria direkte e sigurimit (1+2) 262.961 leke

1. Policëmbajtës 262.961 leke
2. Ndërmjetës 0 leke

II. Llogari të pagueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria e risigurimit 1.210.152 leke

1. Nga risigurime të blera nga shoqëria 1.210.152 leke

III Të tjera llogari të pagueshme tregtare (1+2+3) 0 leke

1. Detyrimet tatimore 0 leke
2. Te pagueshme ndaj punonjësve 0 leke
3. Te tjera llogari të pagueshme tregtare 0 leke.

DETYRIM TATIMOR I SHTYRE pasqyrohet në vlerën **0 leke**

Vleresimi i Aktuarial per shoqerine INSIG JETE sh.a. per periudhen 2017-2018-2019

Në vlerësimin e nivelit të provigjoneve teknike, bazë për vlerësimin ishin Baza Teknike për dizenjimin e produkteve dhe rregulloret për krijimin e provigjoneve matematike si dhe provigjonet për dëmet.

Shoqeria aktualisht operon në llogaritjen e nivelit të provigjoneve matematike.

Duke qenë se portofoli është relativisht i konsiderueshëm (zë pothuaj 60%-65% të nivelit të përgjithshëm të të ardhurave të biznesit jetë) si dhe shumat e sigurimit specifikisht në rimarrje të kredisë kalojnë limitet e mbajtjes së shoqërisë, është gjykuar i drejtë programi i risigurimit të produktit për të cilin është llogaritur gjithashtu provigjoni i primit të risigurimit, në përputhje me limitet e sipercituara të percaktuara në marrëveshjen në vazhdim mes shoqërisë dhe risiguresit.

Vleresimi i provigjoneve ka konsideruar një frekuencë demografike referuar mesatares të tregut të dëmeve të raportuara të periudhave si dhe nivelin e dëmeve të parashikuara për pagese nga shoqëria, nisur analiza nga vlerat aktuale të dëmeve që shoqëria aktualisht mbart.

Në vlerën e kostove të shtyra të marrjes në sigurim, llogaritja e tyre është mbështetur në supozimin që shoqëria të konsiderojë në këtë zë vetëm shpenzimet e marrjes në sigurim, pjesa komisione brokera/agentë, duke qenë se ky zë mbulon relativisht një pjesë të konsiderueshme të kësaj kategorie shpenzimesh.

Konkluzion:

Sipas konkluzionit të referuar Pasqyrave Financiare individuale të datës 30.09.2016 të INSIG sh.a dhe Krijimi i Kapitalit Aksioner të shoqëria INSIG JETE sh.a vlerësojmë se procedura e kryer nga shoqëria për ndarjen dhe krijimin e shoqërisë INSIG JETE sh.a është në përputhje me të gjithat dispozitat ligjore në fuqi.

Me poshtë po paraqesim Pasqyrat Financiare me 30.09.2016 pas ndarjes së INSIG sh.a Shqipëri dhe krijimit të INSIG JETE sh.a

AKTIVI	Pas ndarjes
	30.09.2016
	INSIG JETE
A. Kapitali nenshkruar i pa paguar	
B. Aktive jo-materiale (I+II+III)	2,840,276
I. Emri i mire	0
II. Aktive të tjera jo-materiale	2,840,276
III. Amortizimi i aktiveve te patrupezuara (ze i zbritshem)	0
C. Investime në toka, ndërtesa dhe investime financiare (I+II+III)	548,943,549
I. Toka dhe ndërtesa	
II. Investime në filiale dhe shoqëri me interesa pjesëmarrëse (1+2+3+4+5)	0
1. Aksione dhe interesa pjesëmarrëse në filiale	0
2. Letra borxhi te emetuara nga, dhe hua dhene filialeve	0
3. Aksione dhe interesa pjesëmarrëse në shoqëri me interesa pjesëmarrëse	0
4. Letra borxhi emetuar nga, dhe hua dhënë shoqërive me interesa pjesëmarrëse	0
5. Investime të tjera në filiale dhe shoqëri me interesa pjesëmarrëse	0
III. Investime të tjera financiare (1+2+3+4+5+6+7)	548,943,549
1. Te mbajtura deri ne maturim	548,943,549
1.1 Letra borxhi dhe letra të tjera me vlerë me të ardhura fikse (1.1.1 + 1.1.2)	548,943,549
1.1.1 Letra me vlerë të Qeverisë	548,943,549
1.1.2 Të tjera	0
2. Të vlefshme për shitje	0
2.1 Aksione, letra borxhi me të ardhura të ndryshueshme, fonde investimesh dhe pjesëmarrje në fonde të tjera	0
2.1.1 Të listuara	0
2.1.2 Të palistuara	0
2.2 Letra borxhi dhe letra të tjera me vlerë me të ardhura fikse	0
2.2.1 Letra borxhi të Qeverisë	0
2.2.2 Të tjera	0
3. Me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (3.1+3.2+3.3+3.4)	0
3.1 Aksione, letra borxhi me të ardhura të ndryshueshme, fonde investimesh dhe pjesëmarrje në të tjera fonde	0
3.2 Letra borxhi dhe letra të tjera me vlerë me të ardhura fikse	0
3.3 Derivative	0
3.4 Të tjera	0

4. Depozita në bankë	
5. Hua hipotekore	0
6. Hua të tjera	0
7. Investime të tjera financiare	0
D. Depozita në shoqëri ceduese	0
E. Investime për llogari të policëmbajtësve të sigurimit të jetës që mbajnë riskun e investimit	0
F. Pjesa e risiguruesve në provigjonet teknike (I+II+III+IV+V+VI) (11)	3,823,819
I. Provigjone të primit të pafituar	3,823,819
II. Provigjone matematike	0
III. Provigjone të dëmeve	0
IV. Provigjone për bonuse dhe rabate	0
V. Provigjone të barazimit	0
VI. Provigjone të tjera teknike	0
G. Pjesa e risiguruesve në provigjonet teknike për llogari të policëmbajtësve të sigurimit të jetës që mbajnë riskun e investimit	0
H. Pjesa e risiguruesve në provigjone për risqe dhe detyrime të tjera (I+II)	0
I. Provigjone për pensione	0
II. Provigjone të tjera	0
I. Llogari të arkëtueshme tregtare (I+II+III)	13,116,107
I. Llogari të arkëtueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria direkte e sigurimit (1+2+3+4)	13,116,107
1. Policëmbajtës	13,228,732
2. Ndërmjetës	-112,624
3. Filiale	0
4. Të tjera	0
II. Llogari të arkëtueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria e risigurimit (1+2)	0
1. Nga risigurime të shitura nga shoqëria	0
2. Nga risigurime të blera nga shoqëria	0
III. Të tjera llogari të arkëtueshme tregtare (1+2+3)	0
1. Llogari të arkëtueshme tregtare nga financimet (1.1+1.2)	0
1.1 Të arkëtueshme nga palë të lidhura të ndryshme nga filiale ose shoqëri me interesa pjesëmarrëse	0
1.2 Të tjera të arkëtueshme nga financimet	0
2. Llogari të arkëtueshme tregtare nga shteti	
3. Të tjera llogari të arkëtueshme tregtare	

J. Aktivi tatimor i shtyrë	0
K. Parapagime dhe te ardhura te llogaritura (I+II+III)	13,110,815
I. Shpenzime të marrjes në sigurim të shtyra	6,035,746
II. Interesa dhe qira të llogaritura	7,075,070
III. Të tjera parapagime dhe të ardhura të llogaritura	0
L. Aktive të tjera (I+II+III+IV)	9,026,225
I. Aktive afatgjata materiale, të ndryshme nga toka dhe ndërtesa	5,416,506
II. Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare (1+2)	3,609,719
1. Llogari rrjedhëse dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në bankë	3,609,719
2. Mjete monetare në arkë	
III. Inventari	
IV. Aktive të tjera	
M. Totali i Aktivit (A+B+C+D+E+F+G+H+I+J+K+L)	590,860,791
N. Zëra jashtë bilancit	0
TOTAL (M+N)	590,860,791

DETYRIME DHE KAPITALI	Pas ndarjes
	30.09.2016
	INSIG JETE
A. Kapitalet e veta (I+II+III+IV+V+VI+VII)	469,063,715
I. Kapitali aksionar	370,000,000
II. Rezerva të kapitalit	71,706,777
III. Rezerva nga fitimet	
IV. Rezerva rivlerësimi	
V. Aksionet e veta (zë i zbritshëm)	0
VI. Fitime / humbje të mbartura (+/-)	0
VII. Fitime/Humbje neto për periudhën	27,356,938
B. Detyrime të varura	0
C. Provigjone teknike (I+II+III+IV+V+VI)	120,323,963
I. Provigjone të primit të pafituar	48,319,258
II. Provigjone matematike	0
III. Provigjone të dëmeve	72,004,705
IV. Provigjone për bonuse dhe rabate	0
V. Provigjone barazimi dhe katastrofe	0
VI. Provigjone të tjera teknike	0
D. Provigjone teknike për llogari të policëmbajtësve të sigurimit të jetës që mbajnë riskun e investimit	0
E. Provigjone për rreziqe dhe detyrime të tjera (1+2)	0
1. Provigjone për pensione	0
2. Provigjone të tjera	0
F. Depozita që i detyrohen risiguruesve	0
G. Llogari të pagueshme tregtare (I+II+III+IV+V)	1,473,113
I. Llogari të pagueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria direkte e sigurimit (1+2+3+4)	262,961
1. Policëmbajtës	262,961
2. Ndërmjetës	
3. Filiale	0
4. Të tjera	0
II. Llogari të pagueshme tregtare që rrjedhin nga veprimtaria e risigurimit (1+2)	1,210,152
1. Nga risigurime të shitura nga shoqëria	0
2. Nga risigurime të blera nga shoqëria	1,210,152
III. Letra me vlerë (Debenture) të kolaterizuara me instrumenta financiare me të ardhura fikse (1+2)	0
1. Hua te konvertueshme	0
2. Hua te tjera	0

IV. Shuma që u detyrohen institucioneve të kreditit	0
V. Të tjera llogari të pagueshme tregtare (1+2+3+4)	0
1. Llogari të pagueshme tregtare nga financimi (1.1+1.2)	0
1.1 Të pagueshme nga palë të lidhura të ndryshme nga filiale ose shoqëri me interesa pjesëmarrëse	0
1.2 Të tjera të pagueshme	0
2. Llogari të pagueshme tregtare ndaj shtetit (Taksa dhe të ngjashme)	
3. Llogari të pagueshme tregtare që u detyrohen punonjësve	0
4. Të tjera llogari të pagueshme tregtare	
H. Detyrim tatimor i shtyrë	0
I. Shpenzime të llogaritura dhe të ardhura të marra në avancë (1+2)	0
1. Shpenzime të llogaritura	0
2. Të ardhura të marra në avance	0
J. Totali i Pasivit (A+B+C+D+E+F+G+H+I)	590,860,791
K. Zëra jashtë bilancit	0
TOTAL (J+K)	590,860,791

PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	Pas ndarjes
	30.09.2016
	INSIG JETE
I. Prime të fituara neto (1+2+3+4)	61,155,790
1. Prime të shkruara bruto	67,106,388
2. Prime të ceduara në risigurim (-)	-4,387,680
3. Ndryshimi në provigjonin e primeve të pafituara bruto (+/-)	-1,837,600
4. Ndryshimi në provigjonin e primeve të pafituara, pjesa e risiguresve (+/-)	274,682
II. Të ardhura të tjera teknike neto nga veprimtaria e sigurimeve	
III. Shpenzime neto për dëme të paguara (1+2+3+4)	9,199,161
1. Dëme të paguara bruto	25,317,713
2. Dëme të paguara nga risiguresit (-)	-20,613,112
3. Ndryshimi në provigjonin e dëmeve, bruto (+/-)	-17,310,858
4. Ndryshimi në provigjonin e dëmeve, pjesa e risiguresve (+/-)	21,805,418
IV. Ndryshimi në provigjonet e tjera teknike (+/-)	0
V. Shpenzime neto për bonuse dhe rabate	0
VI. Shpenzime operative neto të veprimtarisë (1+2+3+4+5+6)	27,279,627
1. Shpenzime të marrjes në sigurim	9,438,520
2. Ndryshimi në shpenzime të shtyra të marrjes në sigurim (+/-)	1,676,532
3. Shpenzime administrative (3.1+3.2+3.3+3.4+3.5)	16,880,064
3.1. Shpenzime për personelin (3.1.1+3.1.2+3.1.3)	7,036,814
3.1.1 Paga	6,061,142
3.1.2 Trajtime e shpërblime të tjera	35,806
3.1.3 Sigurime shoqërore dhe shpenzime të ngjashme	939,866
3.2 Furnizime e shërbime nga të tretë	3,565,169
3.3 Tatime e taksa të tjera të ngjashme	2,839,876
3.4 Amortizimi i aktiveve që përdoren në veprimtarinë e sigurimit	703,353
3.5 Shpenzime të tjera administrative	2,734,851
4. Shpenzime të tjera operative	
5. Komisione të risigurimit (-)	-715,489
VII. Shpenzime të tjera neto për sigurimet (1+2)	0
1. Shpenzime për parandalimin e dëmeve	0

2. Shpenzime të tjera neto të sigurimeve	0
VIII Të ardhura të llogaritura nga investimet transferuar nga llogaria jo-teknike (+)	0
IX Rezultati teknik (I+II-III+IV-V-VI-VII+VIII)	24,677,002
X Rritja në vlerën reale (fair value) nëpërmjet llogarisë Fitim/Humbje	0
XI Investime neto (1-2+3)	2,743,156
1. Të ardhurat nga investimet (1.1+1.2+1.3+1.4+1.5+1.6)	2,743,156
1.1 Aksione	0
1.2 Letra borxhi	2,675,181
1.3 Kredi të dhëna kundrejt hipotekave	0
1.4 Pasuri e paluajtshme	0
1.5 Të ardhura nga interesat	67,975
1.6 Të ardhura të tjera nga investimet	0
2. Shpenzime për investime (2.1+2.2)	0
2.1 Amortizimi i aktiveve që nuk përdoren direkt në aktivitetin e sigurimit	0
2.2 Interesa dhe shpenzime të tjera të investimeve	0
3. Fitim / Humbje nga shitja e investimeve (1.1+1.2+1.3+1.4+1.5)	0
1.1 Aksione	0
1.2 Letra borxhi	0
1.3 Kredi të dhëna kundrejt hipotekave	0
1.4 Pasuri e paluajtshme	0
1.5 Të tjera	0
XII. Të ardhura të llogaritura nga investimet të transferuara në llogarinë teknike (-)	0
XIII Të ardhura të tjera	502,102
XIV. Fitime / humbje të tjera nga investimet (+/-)	-565,322
XV. Të ardhura të jashtëzakonshme	0
XVI. Shpenzime të jashtëzakonshme	0
XVII. Fitime / Humbje para tatimit (IX+X+XI-XII+XIII+XIV+XV-XVI)	27,356,938
XVIII. Tatimi mbi fitimin	
XIX. Fitime / Humbje neto për periudhën (XVII-XVIII)	27,356,938

- ✓ Kapitali Aksioner i shoqerise "INSIG JETE" sha eshte 370.000.000 LEKE
(Treqindeshtatedhjetemiljion)
- ✓ Me vlere nominale 600,000 leke/aksion,
- ✓ Numri i aksioneve 616.6667 cope
- ✓ Aksioner i vetem eshte EUROSIG sh.a.

Theksojme se :

1.Veprimet e sistemimit perfundimtare te ketij procesi do te vazhdojne pas miratimit te ndarjes nga QKB-ja.

2.Vazhdimi i vijueshmerise se Pasqyrave Financiare individuale te INSIG sha dhe ndarja e tyre perfundimtare ne 2(dy) sha te krijuara deri ne finalizimin e procesit te ndarjes.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 202, Datë 27.12.2016

PËR

MIRATIMIN E NDARJES SË VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË “INSIG” SH.A.,
NË SHOQËRINË E SIGURIMIT TË JO-JETËS “INSIG” SH.A. DHE
SHOQËRINË E SIGURIMIT TË JETËS “INSIG JETË” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbiqëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe të nenit 261, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve, Bordi i Autoritetit të Mbiqëqyrjes Financiare,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndarjes së veprimtarisë së shoqërisë “Insig” sh.a., në shoqërinë e sigurimit “Insig” sh.a., e cila ushtron veprimtari për klasat e sigurimit të Jo-Jetës dhe në shoqërinë e sigurimit “Insig Jetë” sh.a., e cila ushtron veprimtari sigurimi për klasat e sigurimit të Jetës.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI



DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Enkeleda SHEHI

Departamenti Ligjor

Nr. 36 Prot.

Tiranë, më 09/01/2017

AUTORIZIM

Autorizoj Znj. Dorela Koxherri, punonjëse të shoqërisë INSIG SHA të depozitojë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit/Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, dokumentat e nevojshme për përshtatjen/ndajen e shoqërisë INSIG SHA, ne dy shoqëri pritëse të themeluara rishtazi, **INSIG SHA** (kompani sigurimi jo-jete) dhe **INSIG JETË SHA**.

E autorizuar, autorizohet të kryejë çdo veprim procedurial si edhe të depozitojë çdo dokument të nevojshëm deri në perfundimin e kesaj ndarje.

AUTORIZUES

SHOQËRIA INSITITUTI I SIGURIMEVE (INSIG) SH.A

Përfaqësuar ligjërisht nga Drejtori i Përgjithshëm

Z. Erald Hysa



Date 23/12/2016

VENDIM
"EUROSIG" SHA
Nr. 16, dt. 23/12/2016

PËR

**PËRSHTATJEN E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INSIG" SHA,
NE DY SHOQËRI PRITËSE TË THEMELUARA RISHTAZI,
INSIG SHA DHE INSIG JETË SHA**

Sot në Tiranë, më 23/12/2016, në orën 12:00, në selinë e shoqërisë INSIG SHA, me adresë Njesia Bashkiake nr.7, Rruga e Kavajës, nr.116, u paraqit përfaqësuesi ligjor i "Eurosig" sha, z. Xhevdet Kopani, bazuar në Ligjin nr. 52 datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", si edhe në ligjin Nr. 9901/2008 "Mbi tregtarët dhe shoqëritë tregtare", shoqëria "Eurosig" sha zotëruese 100% e aksioneve;

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndarjes së shoqërisë INSIG SHA, në dy shoqëri pritëse të themeluara rishtazi, **INSIG SHA** (kompani sigurimi jo-jetë) dhe **INSIG JETË SHA**.
2. Miratimin e projekt marrëveshjes për ndarjen e shoqërisë "INSIG" SHA, në dy shoqëri pritëse të themeluara rishtazi **INSIG SHA** (kompani sigurimi jo-jete) dhe **INSIG JETË SHA**, si edhe miratimin e Projekt Raportit të Ndarjes
3. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë "INSIG" SHA, vetë ose nëpërmjet të tretëve të autorizuar prej tij për ndjekjen e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit/Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të ketij vendimi dhe miratimit të dhene nga ana e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare sipas vendimit të bordit me nr. 202 date 27/12/2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

AKSIONARËT:

"EUROSIG" SHA
100%

XHEVDET KOPANI
ADMINISTRATORI



**MARREVEESHJE NDARJE
E SHOQERISE INSIG SHA.**

NE

INSIG SHA.

DHE

INSIG JETE SHA

MEQENESE:

- Shoqeria shqiptare e sigurimit Insig sha., ka patur per shkak te ligjit 2 licensa per ushtrimin e veprimtarise siguruese ne sigurimin e Jetes dhe Sigurimin e Jo-Jetes.
- Ne date 01.06.2016 eshte miratuar privatizimi I Insig sha., dhe per kete shkak, ne funksion te ligjit 52/2014 duhet te behet ndarja e shoqerise Insig sha., ne dy shoqeri pritese te themeluara rishtazi Insig Jo Jeta sha., dhe Insig Jeta sha.
- Ne date jane miratuar ne AMF statutet e shoqerive pritese te themeluara rishtazi Insig Sha.,(kompanie sigurimi jo-jete) dhe Insig Jete Sha.
- Ne perputhje me parashikimet e Nenit 216-225 dhe 227 te Ligjit 9901/2008 "Mbi tregtaret dhe shoqerite tregtare" ("Ligji Tregtar"), administratoret e shoqerive pritese te themeluara rishtazi sipas emerimit te tyre nga asambleja e aksionareve te shoqerise, se bashku kane hartuar nje raport te hollesishcm mbi ndarjen e propozuar.

*Atehere, ne perputhje me parashikimet e neneve 216 dhe vijues te Ligjit Tregtar administratoret e parashikuar te Insig Jo-Jete sha., dhe Insig Jeta sha., kane hartuar kete marreveshje e cila do t'i paraqitet per miratim asamblese se aksionareve te shoqerive (me poshte ' **Marreveshja e Ndarjes**').*

1. NDARJA

1.1 Shoqeria Qe Do Te Ndahet

- a. Insig Sh.a. eshte nje shoqeri shqiptare sigurimi. e regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ("**QKR**") me NIPT (NUIS) J62006012D, me seli ne Rr. Kavajes, 116, Tirane, Shqiperi.
- b. Insig Sh.a. operon si nje shoqeri sigurimi ne perputhje me Vendimin e Keshillit Mbikqyrjes se Sigurimeve nr. 4 date 08.06.2000.



Qendër

1.2 Shoqerite Pritese

Insig sha., sipas statutit te miratuar nge Bordi i AMF me vendimin nr. 127 date 24.08.2016, (me poshte referuar si shoqeria Pritese Insig sha.)

dhe

Insig Jete sha., sipas statutit te miratuar nga Bordi i AMF me vendimin nr. 126 date 24.08.2016 (me poshte referuar si Insig Jete sha.

1.3 Gjendja Financiare E Shoqerise Qe Do Te Ndahet

Ne perputhje me parashikimet e Nenit 216 te Ligjit Tregtar, Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raportet Vjetore te ecurise te Insig sha., per vitet financiare 2013, 2014 dhe 2015 i bashkengjiten kesaj Marreveshjeje Ndarje si Shtojca 4.

1.4 Emertimi Dhe Vazhdimesia E Personalitetit Juridik Te Shoqerive pritese te themeluara rishtazi

Ne daten e Hyrjes ne Fuqi te Ndarjes, si perkufizohet me poshte, Insig sha., do te ndahet ne dy shoqerite Pritese Insig sha., dhe shoqerine Pritese Insig Jete sha.

Nderkohe vete kompania qe ndahet do te kaloje ne crregjistrim pa likujdim sipas parashikimeve te nenit 227/c te Ligjit Tregtar.

Ndarja e Shoqerive qe do te prodhoje pasojat e percaktuara ne nenin 227 te Ligjit Tregtar, dhe rrjedhimisht, duke filluar nga dhe pas dates se Hyrjes ne Fuqi, Shoqerite Pritese do te zoterojne te gjitha pasurite, te drejtat, privilegjet dhe kompetencat dhe do t'i nenshtrohet te njejtave detyrimeve dhe pergjegjesive si Shoqeria qe Ndahet. Te gjitha policat dhe detyrimet e Shoqerise qe Ndahet do te merren persiper nga Shoqeria Pritese brenda kufijve te licenses se tyre dhe me te njejtat kushte sikur keto polica te zbatoheshin akoma nga Shoqeria qe ndahet.

1.5 Data E Hyrjes Ne Fuqi Te Ndarjes

- a. Ne perputhje me parashikimet ligjore te zbatueshme. Ndarja midis Shoqerive sipas kesaj Marreveshjeje Ndarje do te hyje ne fuqi me plotesimin e te gjithe hapave te meposhtem:



- i. Depozitimën e kesaj Marreveshjeje Ndarje dhe të gjithë dokumenteve shoqeruese pranë QKR-se në përputhje me Nenin 216 e vijues të Ligjit Tregtar.
 - ii. Miratimin e kesaj Marreveshjeje Ndarje nga Asambleja e Aksionareve të Shoqërisë që do të ndahet.
 - iii. Marrjen e miratimit për Ndarjen nga ana e Autoritetit të Mbrojtjes Financiare në përputhje me Ligjin 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".
 - iv. Regjistrimin e Ndarjes pranë QKR-se në përputhje me Nenin 220,227 të Ligjit Tregtar.
- b. Nga sa më sipër, data e Hyrjes në Fuqi e Ndarjes do të konsiderohet data e regjistrimit në QKR në përputhje me parashikimet e Nenit 220,227 të Ligjit Tregtar.
- c. Duke filluar nga dhe pas Dates së Hyrjes në Fuqi, në përputhje me parashikimet e Nenit 220,227 të Ligjit Tregtar:
- i. Të gjitha asetet dhe detyrimet e Shoqërisë që ndahet do të transferohen Shoqërive pritese të themeluara rishtazi sipas it të eksperteve, dhe ky transferim do të hyjë në fuqi kundrejt Shoqërisë që ndahet ashtu edhe kundrejt të gjitha paleve të treta.
 - ii. Aksionaret e Shoqërisë që do të ndahet do të bëhen aksionare të Shoqërive pritese të themeluara rishtazi sipas pjesëmarrjes së përcaktuar më poshtë.
 - iii. Shoqëria që ndahet do të konsiderohet si e prishur dhe do të rregjistrohet pa likuidim nga QKR.

1.6 Të Dhenat Tregtare të Shoqërive pritese të themeluara rishtazi

- a. Statutet e Shoqërive pritese të themeluara rishtazi janë statutet e miratuara sipas vendimeve të Bordit të AMF nr. 126 dhe nr. 127 datë 24.08.2016.
- b. Statute të Shoqërive pritese të themeluara rishtazi do të hyjë në fuqi në datën e Hyrjes në Fuqi.
- c. Administratoret e Përgjithshëm të shoqërive pritese të themeluara rishtazi do të jenë si më poshtë:

Shoqëria Pritese Insig sha. - Z. Erald Hysa, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, me datë 10.11.1980, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 025484041,

Shoqëria Pritese Insig Jete sha. – Znj. Elvana Mino, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë me datë 16.07.1967, mbajtëse e ID me nr. 024473069
- d. Anetaret e Këshillit Mbrojtës të Shoqërive pritese të themeluara rishtazi të miratuara sipas vendimit të AMF nr. 155 dhe nr. 156 datë 29.09.2016, do të jenë personat e mëposhtem:



[Handwritten signature]

[Handwritten signature]

1- Zoti Vasil Pilo - Kryetar

2- Zoti Rexhep Mejdani - Anetar

3- Zoti Thanas Xhillari - Anetar

- e. Do te themelohet nje Komitet i Brendshem Kontrolli i Shoqerive pritese te themeluara rishtazi anetaret e te cilit do te emerohen nga Keshilli Mbikqyres ne mbledhjen e pare pas emerimit.

2 Pasoja Te Tjera Te Ndarjes

2.1 Pasojat E Ndarjes Mbi Aksionet E Shoqerise Qe Ndahet

- a. Qe nga Data e Hyrjes ne Fuqi si pasoje e realizimit te Ndarjes dhe pa qene nevoja per veprime te tjera, aksionet e Shoqerive qe Ndahet do pushojne se ekzistuari pa kunderpagese.
- b. Qe nga Data e Hyrjes ne Fuqi si pasoje e realizimit te Ndarjes dhe pa qene nevoja per veprime te tjera, aksionet e Shoqerise qe do te Ndahet do te kembehen automatikisht me aksione te Shoqerive pritese te themeluara rishtazi ne njejten perqindje:
- c. Qe nga Data e Hyrjes ne Fuqi, kapitali aksionar i Shoqerive pritese te themeluara rishtazi do te te jete:

Shoqeria Pritese Insig sha.

Aksionari	Nr. i aksioneve te zoteruara	% ne kapital	Vlera e aksioneve te zoteruara ne lek
Eurosig sha.	1.083,83	100	650.000.000

Shoqeria Pritese Insig Jete sha.

Aksionari	Nr. i aksioneve te zoteruara	% ne kapital	Vlera e aksioneve te zoteruara ne lek
Eurosig sha.	616,66	100	370.000.000,00



- d. Aksionari i Shoqerise qe ndahet pranon transferimin e aseteve te Shoqerive pritese te themeluara rishtazi tek Shoqeria ne kembim te aksioneve te Shoqeritese te percaktuar me lart.
- e. Te drejttat lidhur me cilesine e aksionarit te Shoqerise Perthithese dhe aksionet e Shoqerise Perthithese do te jene ato qe jane percaktuar ne Statute e Shoqerive pritese te themeluara rishtazi te miratuara nga ana e AMF dhe qe bashkengjiten kesaj Marreveshjeje Ndarje.
- f. Aksionaret e Shoqerise qe Ndahet do te kene te drejta pjesemarrjeje ne fitimet e pashperndara te Shoqerise qe Ndahet per periudhat perpara Dates se Hyrjes ne Fuqi. Aksionaret e Shoqerive pritese te themeluara rishtazi do te kene te drejta pjesemarrjeje ne fitimet e pashperndara (nese ka) te Shoqerise qe Ndahet per periudhat perpara Dates se Hyrjes ne Fuqi ne perputhje me pjesemarrjen e tyre ne kapital perpara Dates se Hyrjes ne Fuqi.

2.2 Pasojat E Ndarjes Mbi Punonjesit E Shoqerise Qe Do Te Ndahet

Nuk parashikohet qe te kete shkurtime te asnje punonjesi per shkak te ndarjes keshtu qe ndarja nuk do te kete efekt mbi punonjesit. Kontratat e punes do te rilidhen me te njejttat kushte nga shoqerite Pritese.

Duke qene se brenda Shoqerise do te Ndahet ka patur nje department qe merrej kryesisht dhe vetem me produktet e jetes, eshte parashikuar qe ky department do te kaloje I gjithi ne kompanine Pritese Insig Jete sha. Po ashtu nje pjese e stafit mbeshtetes do te kaloj prane shoqerise Insig Jete sha., qe konsiston ne specialist nga Dep. I Finances, Dep. IT, Dep. Riskut dhe aktuaristikes, Dep. Juridik, Dep. Auditit etj.

2.3 Pasojat E Ndarjes Mbi Kreditoret E Shoqerive Qe Ndahen

- a. Si me siper duke filluar nga Data e Hyrjes ne Fuqi, te gjitha detyrimet e Shoqerise qe ndahet do t'i kalojne Shoqerive pritese te themeluara rishtazi. Per shkak te ligjit, detyrimet qe lidhet me demet e jetes do ti kalojne shoqerise Pritese Insig Jete sha., ndersa detyrimet qe lidhen me demet e jo-jetes do ti kalojne shoqerise Pritese Insig sha.
- b. Pa cenuar sa me siper, Shoqeria qe do te Ndahet dhe perfaqesuesit e saj marrin persiper dhe garantojne se ata do t'i leshojne cdo kreditori eventual qe paraqet nje pretendim kundrejt Shoqerise qe do te Ndahet brenda afateve te percaktuara nga Neni 221 i Ligjit Tregtar (cdo dhe te gjitha garancite e parashikuara ne kete nen).



2.4 Privilegje Te Caktuara Per Administratoret, Keshillin Mbikqyres Ose Ekspertet Kontabel

Administratoret dhe Anetaret e Keshillit Mbikqyres si edhe ekspertet kontabel te Shoqerive qe do te Bashkohen nuk do te perftojne privilegje te vecanta si rrjedhoje e Ndarjes.

3. Deklarata dhe Garanci

Shoqeria qe ndahet deklaron dhe garanton se:

- a. Kompetencat dhe zbatuesmeria. Perfaqesuesit e Shoqerise qe ndahet kane kompetencat dhe autoritetin e duhur per te nenshkruar kete Marreveshje Ndarje. Po ashtu Shoqerite Pritese do themelohen dhe ekzistojne ne perputhje me legjislacionin e Republikes se Shqiperise.
- b. Jo-cenueshmeria. Nenshkrimi dhe leshimi i cdo dokumenti dhe zbatimi i cdo detyrimi sipas kesaj Marreveshje Ndarje nuk do te rezultojne ne shkeljen e ndonje prej (i) parashikimeve te Statuteve te Shoqerive pritese te themeluara rishtazi ose (ii) urdhri apo vendimi te nje gjykata apo autoriteti i cili ka fuqi detyruese per Shoqerine qe Ndahen.
- c. Autorizime dhe Lejime. Kjo Marreveshje Ndarje dhe transaksionet qe parashikohen ne te do te hyjne ne luqi pas miratimit nga Asamblese se Aksionareve te Shoqerise qe ndahet, miratimit nga AMF dhe regjistrimit te Ndarjes prane QKR se bashku me dokumentacionin e kerkuar.

4. Te Ndryshme

- a. Njoftimi i klienteve te shoqerise qe ndahet: Kjo marreveshje do te publikohet ne faqen web te shoqerise. Secili prej klienteve do te njoftohet me sms dhe/ose email per ndarjen. Asnje prej klienteve nuk do te kete nevojte te ndryshoje kopjet e kontratave qe ka ne fuqi me kompanine qe do te ndahet. Shoqerite Pritese do te konsiderojne te vlefshme secilen prej ketyre kontratave dhe do te ekzekutojne gjithte detyrimet qe rrjedhin prej tyre sipas kushteve kontraktore.
- b. Garanci te tiera. Shoqeria qe do te ndahet do te kryeje ato akte dhe do te leshoje ato dokumente qe do te jene te nevojshme per te plotesuar dhe per te bere te vlefshme parashikimet e kesaj Marreveshjeje Ndarje.
- c. Lista e Shtojcave. Me poshte jane Shtojcat qe i bashkengjiten dhe qe jane pjese perberese e Marreveshjes se Ndarjes:

Shtojca 1 - "Raporti i Detajuar i Ndarjes"



Shtojca 2 - "Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raportet Vjetore te Pasurise se Insig per vitet
financiare 2013, 2014 dhe 2015"

Shtojca 3 - "Statutet e Shoqerive pritese te themeluara rishtazi"

Shtojca 4 - "Raporti i Eksperteve mbi Ndarjen"

- d. Kopjet. Kjo Marreveshje Ndarje do te nenshkruhet ne 6 kopje dhe secila prej tyre do te konsiderohet nje kopje origjinale dhe te gjitha se bashku do te perbejne nje instrument te vetem.
- e. Giuhet. Kjo Marreveshje Ndarje nenshkruhet ne gjuhen ne gjuhen Shqipe.

Tirane me 23.12.2016

Shoqeria ne proces ndarje

Insig sha.

Erald Hysa

Drejtor I Pergjithshem

Miratuar pa verejtje

Administratoret e Shoqerive pritese te themeluara rishtazi

Insig sha.

Erald Hysa

ERALD H Y S A
Erald Hysa



Insig Jete sha.

Elvana Mino

Elvana Mino
EM

Date 23/12/2016

STATUTI
I
SHOQËRISË SË SIGURIMEVE "INSIG" SH.A
PER USHTRIMIN E VEPRIMTARISE NE KLASAT E SIGURIMIT TË JO - JETËS

KAPITULLI I
AKSIONERËT E SHOQËRISË

Neni 1
Aksionerët

Shoqëria "INSIG" sh.a zotërohet 100% nga shoqëria e sigurimeve "EUROSIG" SHA, si shoqëri e krijuar në formën e shoqërisë aksionere, e regjistruar me vendimin nr.31945 rregjistri, datë 16 Korrik, 2004, te Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, e cila vepron në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", (i ndryshuar me Ligjin Nr.129/2014), të Ligjit Nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit" dhe akteve të tjera normative të detyrueshme për zbatim.

KAPITULLI II
EMËRTIMI, FORMA LIGJORE, OBJEKTI, KOHËZGJATJA DHE SELIA E
SHOQËRISË.

Neni 2
Emërtimi

- 2.1 Emri i shoqërisë është "INSIG sh.a".
- 2.2 Shoqëria ka vulat e veta. Vulat e shoqërisë me format dhe përmasat e tyre janë:
- a) Vula e vogël, me diametra 2.5 cm e rrumbullakët dhe me tekstin mbi vule si vijon:
Republika e Shqipërisë Instituti i Sigurimeve Insig Tirane, Sekretaria
 - b) Vula e madhe, me diametra 2.9 cm e rrumbullakët dhe me tekstin mbi vule si vijon:
Republika e Shqipërisë Instituti i Sigurimeve Insig Tirane,
 - c) Vula katërkëndëshe me dimensione 4 x 1.2 cm me tekstin mbi vule si vijon : *INSIG Drejtoria, NIPT J62006012D.*

Neni 3

Forma ligjore

- 3.1 Shoqëria e Sigurimeve "INSIG" sh.a, është shoqëri e krijuar në formën e shoqërisë aksionere, e cila vepron në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", (i ndryshuar me Ligjin Nr.129/2014), Ligjit Nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit" dhe akteve të tjera normative të detyrueshme për zbatim.
- 3.2 Shoqëria është themeluar në bazë të Ligjit nr.7506, datë 31/07/1991 "Për Institutin e Sigurimeve", dhe rregjistruar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë Nr.21463, datë 08.06.1999

Neni 4

Objekti i veprimtarisë tregtare të shoqërisë

- 1.1 Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit dhe risigurimit, nëpërmjet përgatitjes, ofrimit, nënshkrimit dhe zbatimit të kontratave të sigurimit "Jo-Jetë", sipas termave dhe klasave të përcaktuara në Ligjin Nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", akteve të tjera normative dhe për të cilat është e licënsuar nga Autoriteti i Mbiqëqyrjes Financiare.
- 1.2 Shoqëria është e licënsuar për të ushtruar veprimtari sigurimi dhe operacione të tjera të lidhura drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë me veprimtarinë e sigurimit, në përputhje me klasat për të cilat është e licënsuar dhe sipas termave të ligjit specifik.
- 1.3 Shoqëria mund të hapë degë, filiale, apo zyra përfaqësie si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera që ekzistojnë ose mund të krijohen në të ardhmen, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 5

Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë e pacaktuar, duke filluar nga momenti i rregjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar, datë 31/07/1999.
- 5.2 Asambleja e Përgjithëshme mund të zgjasë ose shkurtojë veprimtarinë e shoqërisë në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 6

Selia

- 6.1 Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: Njesia Bashkiake nr.7, Rruga e Kavajes, Nr.116, Tiranë, Shqipëri.
Adresa e faqes së internetit të Shoqërisë është : www.insig.com.al
- 6.2 Asambleja e Përgjithëshme e Shoqërisë ka tagrin të ndryshojë adresën e selisë së shoqërisë.

Neni 7

Kapitali i shoqërisë

- 7.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 650.000.000,00 (gjashtëqind e pesëdhjetë milionë),
ndarë në 1.083 aksione me vlere nominale 600.000,00 Lekë (gjashtë qind mijë) secili, tërësisht i nënshkruar dhe shlyer nga aksionarët.

- 7.2 Pjesëmarrja e aksionerëve në kapitalin themeltarë të shoqërisë është si më poshtë :

Nr.	Emri Mbiemri	Përqindja	Nr i Aksioneve	Vlera në lekë
1.	"EUROSIG" SH.A	100%	1.083.33	650.000.000,00

- 7.3 Aksionerët kanë të drejtën e fitimit/dividentit mbi bazën e përqindjes së aksioneve që ata zotërojnë.
- 7.4 Pronësia mbi aksionet jep të drejtën e votës dhe të përfaqësimit në mbledhjet e Asamblesë së Aksionarëve sipas kushteve të përcaktuara në ligj dhe në këtë Statut.

Neni 8

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 8.1 Asambleja e Aksionarëve, mund të zmadhojë ose zvogëlojë kapitalin e shoqërisë me vendim, në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar dhe Ligjit Nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".

- 8.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që zmadhimi i kapitalit të kryhet me emetim të aksioneve të reja, të cilat mund t'u ofrohen për nënshkrim vetëm aksionarëve ekzistues, në përpjesëtim me aksionet e zotëruara prej tyre përpara rritjes së kapitalit apo duke rritur vlerën nominale të secilit aksion. Me përjashtim të rastit kur rritja e vlerës nominale të secilit aksion vendoset të realizohet me përfshirjen e aktiveve të shoqërisë, sipas nenit 177 të Ligjit për Tregtarët, zmadhimi i kufizuar i kapitalit, në rastin e sipërpërmendur, mund të kryhet vetëm me miratimin unanim të të gjithë aksionarëve.
- 8.3 Aksionarët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrimin e aksioneve që do të emetohen pas zmadhimit të kapitalit dhe regjistrimit të këtij zmadhimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Kjo e drejtë mund të ushtrohet në përpjesëtim me numrin e aksioneve të zotëruara nga secili aksionar përpara zmadhimit të kapitalit.
- 8.4 Zvogëlimi i kapitalit do të ketë ndikim mbi aksionarët proporcionalisht me numrin e aksioneve që ata zotërojnë. Kapitali nuk mund të zvogëlohet nën vlerën minimale të kërkuar nga Ligji.

Neni 9 Rregjistri i aksioneve

- 9.1 Aksionet e shoqërisë dhe pronësia mbi to, rregjistrohen në Rregjistrin e Aksioneve, i cili është një dokument që mbahet nga Administratorët e shoqërisë dhe që pasqyron të gjitha veprimet që kryhen me aksionet e shoqërisë si dhe të dhënat e zotëruesëve të aksioneve të shoqërisë si :
- Emri dhe mbiemri i aksionerit.
 - Emri i rregjistruar i aksionerit nëse është person juridik
 - Vlera nominale e aksionit
 - Adresa e banimit, ose zyra qendrore e aksionerit
 - Data e kryerjes së regjistrimit
- 9.2 Të drejtat që lidhen me aksionet nuk mund të ushtrohen nga mbajtësit e tyre pa u rregjistruar në Rregjistrin e Aksioneve.

Neni 10
Transferimi i aksioneve

- 10.1 Aksionet janë lirisht të transferueshme midis aksionerëve, bashkëshortëve si dhe në rrugë trashëgimie sipas dispozitave përkatëse.
- 10.2 Nëse ndonjë nga aksionerët vendos të transferojë një pjesë apo të gjitha aksionet që i përkasin atij, tek të tretët, të cilët nuk janë bashkëshorti apo trashëgimtarët e drejtëpërdrejtë sipas përcaktimeve ligjore, ai detyrohet të respektojë të drejtën e parablerjes, duke ia ofruar më parë aksionet, akisonarit/(ëve) të tjerë të shoqërisë. Oferta përpilohet përpara noterit dhe i njoftohet aksionarëve të tjerë nëpërmjet shërbimit postar të porositur (rekomande) dhe duhet të përmbajë numrin e aksioneve që do të transferohen, çmimin e kërkuar për to dhe periudhën kohore brenda së cilës oferta është e vlefshme, në mënyrë që aksionarët e tjerë të ushtrojnë të drejtën e blerjes apo të refuzojnë ofertën.
- 10.3 Secili aksioner e gëzon të drejtën e parablerjes për të blerë aksionin përpjestimisht me pjesmarrjen e tij në kapitalin themeltar.
- 10.4 Nëse një ose disa prej aksionerëve refuzojnë të drejtën e parablerjes, aksionerët e tjerë gezojnë të drejtën për të blerë aksionin përpjestimisht me pjesmarrjen e tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 10.5 Nëse vetëm njëri prej aksionerëve ushtron të drejtën e parablerjes, ai gëzon të drejtën e blerjes së aksionit pamvarësisht pjesmarrjes së tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 10.6 E drejta e parablerjes do të ushtrohet brenda një periudhe 1 (një) mujore, duke filluar nga data në të cilën oferta i është njoftuar Asamblesë së Përgjithëshme dhe/ose secilit prej aksionerëve. Nëse aksionerët nuk e ushtrojnë të drejtën e parablerjes brenda aftatit kohorë, shitësi i aksioneve ka të drejtë të transferojë aksionet tek të tretët.

Neni 11
E drejta e votës

Çdo aksion i zakonshëm i jep zotëruesit të tij të drejta vote në raport me pjesën e kapitalit që përfaqëson aksioni.

KAPITULLI III
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SHOQËRISË

Neni 12
Organet e shoqërisë

- 12.1 Organizimi i shoqërisë "INSIG" sh.a, funksionon sipas përcaktimit të Nenit 19 të Ligjit Nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", dhe konkretisht sipas sistemit me dy nivele.
- 12.2 Organet e shoqërisë janë:
- i. Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve.
 - ii. Këshilli Mbikëqyrës
 - iii. Administratori
- 12.3 Kompetencat dhe përgjesësitë e organeve të shoqërisë, përveç sa parashikon ligji nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, janë edhe ato të përcaktuara në nenin 19, pika 4 dhe nenin 22 të Ligjit nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" si dhe ato të përcaktuara shprehimisht në këtë Statut.

Neni 13
Asambleja e Përgjithëshme

Asambleja e Përgjithëshme është mbledhja e përgjithëshme ku të gjithë aksionerët e shoqërisë kanë të drejtë të thirren për t'u mbledhur në një takim formal dhe të marrin vendime në lidhje me çështjet e rendit të ditës, të njoftuar sipas procedurës së përcaktuar në ligj dhe Statut.

Neni 14
Thirrja e Asamblesë së Përgjithëshme

- 14.1 Asambleja e Përgjithëshme thirret në rastet e përcaktuara në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar apo në raste të veçanta të parashikuara në këtë Statut.
- 14.2 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithëshme si rregull thirret nga Administratorët e Shoqërisë, por në raste të caktuara, sipas parashikimeve të ligjit "Për tregtarët

dhe shoqëritë tregtare", mund të thirret edhe nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, ose nga aksionerët që zotërojnë të paktën 5% të kapitalit të rregjistruar të shoqërisë.

- 14.3 Njoftimi i mbledhjes së Asamblesë u dërgohet çdo aksionari, të paktën 21 (njëzetë e një) ditë përpara mbledhjes, duke përcaktuar në të datën, orën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes. Njoftimi u dërgohet aksionarëve me shkrim sipas formave të njohura ligjore duke përfshirë edhe faksin apo postën elektronike.
- 14.4 Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës së Asamblesë si dhe të gjithë elementët e përcaktuar në Nenin 137, të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", të ndryshuar .
- 14.5 Vendimet e Asamblesë së Përgjithëshme të mbledhur në kundërshtim me sa më sipër, duhet të shfuqizohen nga vetë Asambleja ose Gjykata kompetente. Përjashtim bëhet në rastin kur të gjithë aksionerët janë të pranishëm ose të përfaqësuar rregullisht në Asamblesën e Përgjithëshme dhe bien dakort që kjo Asamble të mbledhet pa rrespektuar procedurën e sipërcituar.
- 14.6 Në rastet kur njoftimet për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithëshme, kryhen nëpërmjet postës elektronike, ato duhet të dërgohen në adresat e deklaruara nga aksionerët të cilat rregjistrohen në Rregjistrin e Aksioneve, si dhe në çdo rast duhet të merren masat që të provohet se këto njoftime janë kryer rregullisht dhe sipas afateve ligjore.
- 14.7 Mbledhjet e Asamblesë së Aksionarëve mbahen në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër që mund të përcaktohet rast pas rasti nga Këshilli Mbikëqyrës ose Adminsitratori.

14.8 Administratorët e shoqërisë marrin masa që mbledhjet e Asamblesë të pasqyrohen në një proces verbal, i cili duhet të përmbajë ndër të tjera.

- **datën, orën dhe vendin e mbledhjes;**
- aksionerët e pranishëm dhe numrin e aksioneve që ata përfaqësojnë;
- rendin e ditës;
- çeshtjet kryesore të diskutimeve;
- format dhe rezultatet e votimeve;
- vendimet që u morën;

14.9 Administratorët duhet të kujdesën që :

- vendimet e marra në këto mbledhje të zbardhen dhe nënshkruhen rregullisht
- listat e pjesmarrësëve të bashkëngjiten në dokumentacionin e mbledhjes
- të fiksohen me korrektësi format e votimit, nëse do të ushtrohen nëpërmjet pjesmarrjes së drejtëpërdrejtë apo komunikimeve të njohura elektronike apo telefonike në kohë reale.

14.10 Asambleja e Përgjithëshme merr vendime të vlefshme në rastet kur:

- mbledhjet e saj janë thirrur në mënyrë të rregullt;
- aksionerët që marrin pjesë në mbledhje ose përfaqësuesit e tyre, përfaqësojnë kapitalin e nevojshëm të shoqërisë të kërkuar në formën e kuorumeve të mbledhjeve për marrjen e vendimeve të caktuara;

Neni 15

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithëshme Vendimarrja

15.1 Asambleja e Përgjithëshme ushtron kompetencat e mëposhtme dhe vendos në mënyrë ekskluzive për:

- a. përcaktimin e politikave tregtare;
- b. ndryshimet në Statut;
- c. emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës;
- d. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve/bordit të drejtorëve ;
- e. emërimin e shoqërisë audituese, e cila duhet të jetë person juridik i licensuar për të kryer veprimtari audituese në Republikën e Shqipërisë;
- f. emërimin dhe shkarkimin e likuiduesëve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- g. miratimin e skemës së shpërblimeve për anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, administratorët, ekspertët kontabël, likuiduesëve dhe antarëve të Komitetit të Auditimit;
- h. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së kompanisë;
- i. shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- j. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit;
- k. pjestimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
- l. miratimin e pasqyrave finaciare vjetore dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë;
- m. përfaqësimet e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;

- n. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - o. miratimin e rregullave procedurale ë mbledhjeve të saj;
 - p. çeshtje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo ky statut;
- 15.2 Secili aksioner mund të përfaqësohet në mbledhje nga një aksioner tjetër apo një person i tretë; Aksionerët dhe/ose anëtarët e Këshillit Mbikqyrës nuk mund të veprojnë në mbledhje si përfaqësues të aksionerëve të shoqërisë.
- 15.3 Për formën e pjesmarrjes në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithëshme, kuorumin e pjesmarrjes si dhe kuorumin e vendimmarrjes, aksionerët e shoqërisë do të referohen dispozitave përkatëse të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", të ndryshuar .

Neni 16 Këshilli Mbikqyrës

- 16.1 Këshilli Mbikqyrës ushtron funksione mbikqyrje dhe ka këto të drejta dhe përgjegjësi lidhur me:
- a. zbatimin e legjislacionit në fuqi nga shoqëria e sigurimit;
 - b. miraton dhe duhet të garantojë një mbikqyrje të matur për zbatimin e politikave, strategjive dhe sistemeve të administrimit të rrezikut;
 - c. krijimin e sistemit të kontrollit dhe auditimit të brendshëm për të gjitha fushat e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, si dhe funksionimin e tyre në përputhje me dispozitat e ligjit nr.52/2014;
 - d. mbikqyrjen e administrimit të rriskut, ndaj të cilit shoqëria e sigurimit ekspozohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj;
 - e. garantimin e vërtetësisë dhe saktësisë së të dhënave të raporteve financiare dhe statistikore të shoqërisë së sigurimit, si dhe raporteve të tjera të kërkuara nga Autoriteti apo Asambleja e Përgjithshme. Këto dokumente duhet të miratohen e nënshkruhen nga të gjithë antarët e këshillit mbikqyrës, për t'ju paraqitur Asamblesë, së bashku me një raport të këshillit për miratim dhe një përshkrim për mbikqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
 - f. raportimin dhe informimin e Autoritetit sipas dispozitave të ligjit nr.52/2014 "*Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit*";
 - g. të përgatisë me kërkesë së Asamblesë së Përgjithshme, marrjen e masave që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
 - h. të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithëshme sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë.

- i. të japë direktiva për Administratorin për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - j. të kontrollojë e mbikqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;
 - k. të sigurojë se auditimi i librave dhe i rregjistrimeve kontabël të kryhet të paktën njëherë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur dhe raporti i auditimit drejtuar asamblesë së përgjithshme t'u vihet në dispozicion të gjithë antarëve të këshillit dhe Adminsitratorin;
 - l. të përcaktojë shpërblimin e administratorëve;
 - m. të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5% të kapitalit të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve, apo instrumentave të tjera të borxhit;
 - n. të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave për themelimin e shoqërive tregtare ose grupeve të reja, sipas edhe termave të ligjit nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit";
 - o. të kryejë veprime të tjera të përcaktuara në ligj dhe statut;
- 16.2 Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga (tre) anëtarë të cilët emërohen për një afat 3 vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Anëtarët e Këshillit emërohen nga mbledhja e përgjithshme e aksionerëve, vetëm nëse aksionerët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, vendosin me tre të katërtat e aksionerëve që marrin pjesë në votim, sipas neneve 144, pika 1 dhe 145, pika 1, të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar .
- 16.3 Në emërimin e anëtarëve të këshillit merren parasysh kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi të parashikuara në nenin 17 të ligjit nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", kriteret e parashikuara nenin 20 të ligjit të sipërcituar dhe rregullores përkatëse të AMF nr.137, datë 21.12.2015, të ndryshuar, si dhe papajtueshmëritë e nenit 13 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar. Gjithashtu anëtarët e këshillit mbikqyrës duhet të shmangin interesin privat i cili krijon konflikt me interesin e "INSIG JO-JETË" sh.a.
- 16.4 Anëtarët e këshillit duhet të jenë të ndryshëm nga administratorët e shoqërisë.
- 16.5 Mandati i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës është 3 (tre) vjet me të drejtë rizgjedhjeje.
- 16.6 Anetaret e Keshillit Mbikqyres te shoqerise INSIG SHA jane 3 (tre), dhe emërohen për një afat 3 vjeçar me të drejtë rizgjedhje,



1. Vasil Pilo, Kryetar, i datelindjes 11/11/1946, lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Tirane, identifikuar nepermjet pasaportes nr.personal E61111012B.
2. Rexhep Meidani, Anëtar, i datelindjes 17/08/1944, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, identifikaur nepermjet pasaportes nr.personal E408170017T
3. Thanas Xhillari, Anëtar, i datelindes 31/07/1953, lindur ne Permet dhe banues ne Tirane, identifikuar nepermjet pasaportes nr.personal F30731052D,

Neni 17

Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës dhe Vendimarrja

- 17.1 Këshilli Mbikqyrës mblidhet jo më rrallë se një herë në tre muaj dhe merr në shqyrtim raportet që paraqet administratori.Mbledhja thirret nga kryetari dhe në mungesë të tij nga zëvendësi ose antarët e tjerë të Këshillit.
- 17.2 Kryetari dhe në mungesë të tij zëvendësi thërrasin mbledhjen e Këshillit brenda 15 ditësh kur një e treta e anëtarëve të këshillit i paraqesin një kërkesë të arsyeshme për këtë.
- 17.3 Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës mbahen në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër të caktuar nga Kryetari ose Zëvendës Kryetari. Si rregull njoftimi për mbledhjen duhet t'u dërgohet anëtarëve tre ditë përpara, me letër e-mail, nëpërmjet njoftimit në ëeb-site e shoqërisë, ose me formë tjetër të shkruar komunikimi.
- 17.4 Çdo thirrje duhet të përmbajë çeshtjet kryesore të rendit të ditës si dhe materialet që do të diskutohen.
- 17.5 Vendimet e Këshillit konsiderohen të vlefshme nëse në procesin e vendimarrjes janë të pranishëm më shumë se një e dyta e anëtarëve. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Statut, vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe kur për një çeshtje ka barazim votash, vota e Kryetarit mbizotëron.

- 17.6 Vendimet e Këshillit Mbikqyrës mund të merren sipas përcaktimeve të Statutit apo rregulloreve të këshillit, duke shprehur votën me shkresë, me telefon, apo mjete të tjera të komunikimit elektronik, me përjashtim të rasteve kur një anëtar i këshillit ka kundërshtim për këtë mënyrë vendimmarrjeje.
- 17.7 Vendimet e Këshillit Mbikqyrës evidentohen me anë të procesverbaleve të mbajtura në një liber të posaçëm (protokoll), i numërtuar dhe i vulosur, që mbahet në selinë qendrore të shoqërisë, në të cilën tregohen, veç të tjerash, anëtarët e pranishëm të përfaqësuar dhe të munguar si dhe çdo person tjetër që ka asistuar në mbledhjen e Këshillit tërësisht ose pjesërisht.

Neni 18 Administratori

- 18.1 Administratori ushtron funksione të administrimit, i cilët kanë të drejtë dhe detyrohen:
- a. të zbatojnë legjislacionin në fuqi nga shoqëria e sigurimit "INSIG" sh.a;
 - b. të administrojnë rrezikun ndaj të cilit shoqëria e sigurimit ekspozohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj;
 - c. të mbajnë kontabilitetin, përgatitjen e raporteve financiare dhe statistikore të shoqërisë së sigurimit, si dhe raporteve të tjera të kërkuara nga Autoriteti, në përputhje me rregullat dhe metodat e përcaktuara;
 - d. të raportojnë dhe informojnë Autoritetin, sipas dispozitave të ligjit specifik apo akteve të tjera normative;
 - e. të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
 - f. të përgatisin dhe nënshkruajnë bilacin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin Këshillit Mbikqyrës për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim në asamblenë e përgjithshme;
 - g. të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë "INSIG" sh.a;
 - h. të kryejnë rregjistrimet dhe publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë sipas parashikimeve ligjore;
 - i. të raportojnë përpara këshillit për zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë.
 - j. të kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në këtë statut;

- 18.2 Detyrat që i cakton ligji Këshillit nuk mund t'u delegohen administratorit;
- 18.3 Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4, 5 të nenit 136 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, administratorët duhet të informojnë menjëherë Kryetarin e Këshillit, i cili duhet të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme.
- 18.4 Mandati i administratorit/ëve të shoqërisë është dy vite, me të drejtë rizgjedhjeje.
- 18.5 Administrator i "INSIG" SHA është z. Erald Hysa i datelindjes 10/11/1980, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, identifikuar nepermjet leternjoftimit nr.personal I01110045Q

Neni 19

Komiteti i Auditimit – Auditimi i Brendshëm

- 19.1. Komiteti i Auditimit përbëhet nga jo më pak se tre anëtar dhe ndër të tjera ka këto detyra:
- a. monitoron proceset e raportimit financiar dhe vlerëson integritetin e pasqyrave financiare të shoqërisë së sigurimit;
 - b. monitoron mjaftueshmërinë dhe efektshmërinë e sistemit të kontrolleve të brendshme të shoqërisë së sigurimit;
 - c. monitoron përshtatshmërinë dhe mjaftueshmërinë e proceseve të projektuara për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullatore;
 - d. propozon drejtuesin e njësisë së auditimit të brendshëm dhe monitoron veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm;
 - e. propozon audituesin e jashtëm dhe shqyrton e monitoron pavarësinë e shoqërisë audituese;
 - f. komiteti i auditimit mbledhet jo më pak se katër herë në vit në mbledhje të zakonshme, si dhe në mbledhje të jashtëzakonshme sa herë thirret nga këshilli mbikëqyrës. Vendimet merren me shumicë votash të të gjithë anëtarëve të pranishëm. Abstenimi nuk lejohet. Komiteti i auditimit, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, mund të ndihmohet nga ekspertë të jashtëm të zgjedhur prej tij.
 - g. Komiteti i auditimit i raporton këshillit mbikëqyrës dhe e ndihmon këtë të fundit gjatë procesit vendimmarrës dhe mbikëqyrës të shoqërisë .

- h. Auditi i Brendshëm, i cili krijohet si një njësi që funksionon në mënyrë të pavarur dhe objektive për të dhënë opinion të specializuar, si dhe për të përmirësuar veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit, raporton gjetjet përpara Këshillit Mbikqyrës, si dhe ndjek në bashkëpunim me drejtuesit e lartë të kompanisë zbatueshmërinë e tyre.
- i. Njësia e auditimit të brendshëm si pjesë përbërëse e sistemit të kontrollit të brendshëm, ka për detyrë të ushtrojë një metodë të integruar dhe të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e proceseve të qeverisjes, administrimit të rrezikut dhe kontrolleve të shoqërisë;
- j. Njësia e auditimit të brendshëm kryen auditimin e brendshëm të veprimtarisë së shoqërisë, në përputhje me parimet profesionale dhe standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, kodin ndërkombëtar të etikës profesionale për audituesit e brendshëm dhe praktikatat për ta.

Neni 20 Shoqëria Audituese

- 20.1 Asambleja e Përgjithshme emëron shoqërinë audituese të shoqërisë së sigurimit, shoqëri e cila është person juridik i licencuar për të ushtruar veprimtari audituese në Republikën e Shqipërisë.
- 20.2 Shoqëria audituese përzgjidhet sipas rregullave dhe kriterëve të miratuara nga Autoriteti.
- 20.3 "INSIG" sh.a, depoziton në Autoritet një kopje të raportit të auditimit dhe letrën për drejtimin, brenda 15 ditëve kalendarike nga data e marrjes së tyre, por jo më vonë se data 30 prill e vitit pasardhës. Nëse shoqëria përgatit llogari të konsoliduara, raporti i mësipërm depozitohet jo më vonë se data 31 maj e vitit pasardhës.

Neni 21 Të drejtat dhe detyrat

- 21.1 Shoqëria audituese e dërgon raportin e auditimit në asamblenë e përgjithshme dhe komitetin e auditimit të shoqërisë.

- 21.2 Shoqëria audituese jep opinionin e saj nëse llogaritë vjetore të "INSIG" sh.a, të konsoliduara dhe të pakonsoliduara janë në përputhje me standardet dhe rregullat profesionale në fuqi.
- 21.3 Shoqëria audituese raporton menjëherë në Autoritet çdo fakt që lidhet me "INSIG" sh.a, për të cilin shoqëria audituese është vënë në dijeni gjatë kryerjes së detyrave të saj për:
- shkelje të ligjeve, akteve nënligjore në fuqi, akteve të Autoritetit ose akteve administrative, që kanë të bëjnë me kushtet, në bazë të të cilave i është dhënë licenca për të ushtruar veprimtari sigurimi;
 - mashttrim ose përvetësim, vjedhje, pastrim parash apo financim të terrorizmit;
 - shkelje të rregullave të brendshme të shoqërisë së sigurimit;
 - ndryshim të rëndësishëm të rezultatit financiar të paraqitur në llogaritë vjetore të paaudituar;
 - fakte dhe rrethana të tjera shtesë, të cilat mund të kenë ndikim mbi veprimtarinë e mëtejshme të shoqërisë së sigurimit;
 - çdo transaksion të shoqërisë së sigurimit me palë të lidhura që përbën rrezik për likuiditetin dhe për rregullat e administrimit të rrezikut.
- 21.4 Raporti i auditimit, që përmban opinionin për pasqyrat financiare, shoqërohet nga raporti i aktuarit të shoqërisë audituese, i cili jep opinion për mjaftueshmërinë e provigjoneve teknike të "INSIG" sha, sipas këtij ligji dhe akteve të Autoritetit, duke u bazuar në teknikat e duhura aktuariale.
- 21.5 Raportimi, informimi dhe dhënia e çdo fakti, sipas pikave 21.3 dhe 21.4 të këtij neni, nga ana e shoqërisë audituese nuk përbën shkelje të kufizimeve për dhënie të informacionit, të përcaktuara në kontratë ose në legjislacionin në fuqi dhe personat janë të çliruar nga çdo lloj përgjegjësie.
- 21.6 Shoqëria audituese është e detyruar t'i japë Autoritetit shpjegime shtesë për auditimin e kryer dhe raportin e auditimit, si dhe çdo informacion tjetër që Autoriteti e gjykon të nevojshëm në funksion të ushtrimit të mbikëqyrjes.
- 21.7 Ajo ka detyrim të informojë menjëherë Autoritetin nëse gjatë kryerjes së detyrave shoqëria audituese konstaton se "INSIG" sha, ka shkelur rregullat e administrimit të rrezikut dhe si pasojë cenohen intereset e të siguruarve, si dhe rrezikohen likuiditeti apo vijueshmëria e veprimtarisë së saj.

- 21.8 "INSIG" sh.a, publikon raportin vjetor, i cili përmban pasqyrat financiare të audituara dhe opinionin e audituesit, dhe e vendos në faqen zyrtare të internetit jo më vonë se 6 muaj nga përfundimi i vitit kalendarik.
- 21.9 Shoqëria audituese auditon dhe vlerëson pajtueshmërinë e pasqyrave financiare të "INSIG" sh.a, në përputhje me SNRF-të dhe legjislacionin në fuqi.

KAPITULLI IV

Neni 22

Viti financiar

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me datë 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik.

Neni 23

Pasqyrat financiare dhe kontabiliteti

- 23.1 Pasqyrat financiare vjetore, përfshirë bilancin dhe deklaratat do të përgatiten sipas legjislacionit shqiptarë dhe përsa kohë është e mundur, atëherë kur ligji shqiptarë lejon zgjedhjen e standarteve të ndryshme të kontabilitetit, në IFRS.
- 23.2 Librat kontabël do të mbahen në gjuhën shqipe dhe monedhën shqiptare në përputhje të plotë me ligjet dhe rregullat në fuqi të legjislacionit shqiptar.
- 23.3 Caktimin e Shoqërisë "Grant-Thorton Albania" sh.p.k si Ekspert Kontabel të Autorizuar për auditimin e pasqyrave Financiare të vitit 2017, me administrator z.Kleidi Kodra, me Nipt K91923007M.

Neni 24

Shpërndarja e Dividentit

- 24.1 Shoqëria do të deklarojë dhe shpërndajë tek Aksionerët e saj si dividend, të gjithë fitimin e disponueshëm, pasi janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore dhe të rezervave të njohura nga legjislacioni në fuqi.
- 24.2 Asambleja e Përgjithshme përpara se të vendosë për ndarjen e dividentit, duhet të vlerësojë interesin më të mirë të Shoqërisë, duke marrë në konsideratë gjendjen financiare të saj.



Neni 25
Rezultati financiar

- 25.1 Rezultati financiar i shoqërisë përcaktohet në mbyllje të çdo viti, si diferencë midis të ardhurave dhe shpenzimeve, pasi të zbriten gjithashtu amortizimet dhe shumat e provigjoneve për zhvlerësime dhe për rreziqe dhe shpenzime. Rezervat e sigurimeve të shtuara zbriten nga primet e sigurimit të vitit sipas rregullave përkatëse ligjore dhe kjo realizohet përpara nxjerrjes së rezultatit.
- 25.2 Fitimi neto i shoqërisë përcaktohet pasi të zbritet tatimi mbi fitimin i llogaritur në mënyrë të përqendruar për shoqërinë në tërësi.

Neni 26
Ndarja e fitimit neto

- 26.1 Fitimi neto i shoqërisë përdoret si vijon:
- Për rezervën e nevojshme për të plotësuar minimumin e kapitalit (Fondit të Garancisë) sipas përcaktimeve të ligjit nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit";
 - Për rezerva të tjera të nevojshme;
 - Për dividendin;
- 26.2 Fitimet e shoqërisë nuk mund të caktohen për shpërblime apo përfitime të tjera të personelit, për sponsorizime apo dhurime dhe as për ndonjë qëllim tjetër që ka natyrë shpenzimi dhe hyn në koston e shoqërisë;

Neni 27
Dividentët

- 27.1 Fitimi i shpërndashëm si dividend përbëhet nga fitimi neto i vitit financiar paraardhës, i pakësuar me humbjet e mbartura si dhe pasi janë zbritur shpenzimet që shoqëria duhet të kalojë në rezervë ligjore, të paktën 5% të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 10% me kapitalin e rregjistruar të shoqërisë nëse gjen zbatim për veprimtarinë e ushtruar apo rezerva të tjera të detyrueshme për t'u krijuar bazuar në ligjin nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".
- 27.2 Fitimi i shpërndashëm ndahet midis të gjithë aksionerëve në përpjestim me numrin e aksioneve që zotëron secili prej tyre.

27.3 Shoqëria nuk mund të ndajë dividend nëse kapitali ka rënë nën minimumin e kërkuar me ligj apo kur një gjë e tillë kërkohet nga Autoritetet përkatëse.

Neni 28

Humbja dhe mbartja e tyre

Pas miratimit të gjendjes financiare vjetore nga Asambleja e Përgjithshme, humbja e rezultuar në një vit financiar mbartet në vitet pauses për t'u mbuluar nga fitimet e ardhshme deri në shuarjen e humbjes. Mbulimi i humbjes bëhet në mënyrë përpjestimore nga aksionerët sipas aksioneve që ata zotërojnë.

KAPITULLI V

Neni 29

DEGËT E SHOQËRISË

Shoqëria e Sigurimeve "INSIG" sh.a, e kryen aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj, nëpërmjet filialeve, degëve, pikave të shitjes, zyrave të përfaqësimit ose agjencive, të cilat krijohen në bazë rrethi apo rajoni, me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë . Degët brenda territorit të Republikës së Shqipërisë veprojnë nën mbikëqyrjen e Adminsitratorit.

Degët jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë funksionojnë sipas rregullave të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 30

Drejtimi i Degëve të "INSIG" sh.a, raportimet

Drejtimi dhe organizimi i degës ushtrohet nga drejtori/ përgjegjësi, i cili përgjigjet për të gjithë veprimtarinë e degës në përputhje me legjislacionin në fuqi që vepron në fushën e sigurimeve, urdhërave dhe udhëzimeve të drejtorit dhe dispozitave të këtij Statuti.

Degët krijohen me propozim të të Drejtorit ekzekutiv dhe me miratim të Këshillit Mbikëqyrës të kompanisë.

Marrja në punë dhe largimi nga puna i personelit të Degës (përfshirë edhe përgjegjësin/drejtorin e degës) bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i "INSIG" sh.a.

**KAPITULLI VI
LIKUJDIMI**

Për administrimin e përkohshëm si dhe likujdimin e shoqërisë veprojnë dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar dhe ato të ligjit nr.52/2014 "Për veprimatrinë e sigurimit dhe risigurimit", konkretisht Kreu IX i këtij ligji.

**KAPITULLI VII
DETYRIME PËR SEKRETIN E TË TJERA**

Neni 31

Detyrimi për ruajtjen e sekretit

Antarët e Këshillit Mbikqyrës, Adminsitratori, Eksperti Kontabël i miratuar, të gjithë punonjësit e kompanisë dhe agjentët kanë detyrimin ligjor të ruajnë fshehtësinë e çdo informacioni të marrë gjatë ushtrimit të detyrës në "INSIG" sh.a dhe të mos e përdorin atë për përfitime personale apo tek të tretët, si gjatë kohës kur janë të punësuar në kompani, ashtu edhe pas largimit të tyre.

"INSIG" sh.a, ka të drejtë të ngrejë padi civile dhe penale, sipas legjislacionit në fuqi, ndaj të gjithë atyre personave që për shkak të nxjerrjes së informacionit dëmtojnë interes e kompanisë.

Këshilli Mbikqyrës përcakton rregulla dhe procedura më të hollësishme lidhur me ruajtjen e sekretit nga personat e sipërcituar si dhe për komunikimin e informacioneve autoriteteve apo organeve të cilat kjo e drejtë u është njohur me ligj.

Gjithashtu shoqëria "INSIG" sh.a është e detyruar të ruajë sipas legjislacionit përkatës dhe Kodit të Punës konfidencialitetin e të dhënave, fakteve dhe rrethanave që kanë të bëjnë jo vetëm me të siguarit, por edhe punëmarrësit, të dhëna me të cilat njihen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Neni 32

**Detyrimi për të vënë në dispozicion të aksionerëve dokumentat
dhe informacionin**

Shoqëria mban dhe vë në dispozicion të aksionerëve, në kushtet dhe afatet e parashikuara në ligj, raportet, dokumentat dhe llogaritë vjetore që shqyrton asambleja. Me përjashtim të ndonjë dokumenti të përcaktuar nga Asambleja, dokumentat që duhet t'u vihen në dispozicion aksionerëve u dërgohen së bashku me njoftim-thirrjen për mbledhje.

Neni 33

Detyrimi për të raportuar në Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare

Raportimi në AMF bëhet konform të gjitha akteve normative për këtë qëllim. Dokumentat e kërkuara dërgohen vetëm me nënshkrimin e administratorit/antarëve të bordit të drejtorëve, ose nga persona të autorizuar nga Administratori, apo persona të tjerë që ua atribuon ligji të bëjnë një gjë të tillë.

Administratori është i detyruar, që ekspertëve kontrollues që paraqiten në shoqëri të pajisur me dokumenta sipas akteve ligjore, t'u vërë në dispozicion për të kontrolluar të gjithë dokumentacionin e kërkuar prej tyre.

Neni 34

Të ndryshme

Për çdo klauzolë të paparashikuar në këtë Statut, Aksionerët, Antarët e Këshillit Mbikqyrës, Administratorët, do t'i referohen dispozitave përkatëse të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar dhe ligjit nr.52/2014 "Për veprimatrinë e sigurimit dhe risigurimit", apo çdo ligji tjetër në fuqi që rregullon marrëdhënien juridike përkatëse. Ky statut hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga Aksionerët e "INSIG" sh.a dhe pas miratimit paraprak nga AMF.

AKSIONERËT
"EUROSIG" SHA
100%
ADMINISTRATORI
Mirëditë Lepuri
XHEVDET KOPANI



ANEKSI NR.1

VULAT E SHOQERISE INSIG SHA JO-JETE



INSIG DREJTORIA
NIPT J 62006012 D

A handwritten signature in black ink, appearing to be "L. L. L.", located at the bottom right of the page.

STATUTI
I
SHOQËRISË SË SIGURIMEVE "INSIG JETË" sh.a
PER USHTRIMIN E VEPRIMTARISE NE KLASAT E SIGURIMIT TË JETËS
KAPITULLI I
AKSIONERËT E SHOQËRISË

Neni 1
Aksionerët

Shoqëria "INSIG JETË" sh.a, zotërohet 100% nga shoqëria e sigurimeve "EUROSIG" SHA, si shoqëri e krijuar në formën e shoqërisë aksionere, e regjistruar me vendimin nr.31945 rregjistri, datë 16 Korrik, 2004, te Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, e cila vepron në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", (i ndryshuar me Ligjin Nr.129/2014), të Ligjit Nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit" dhe akteve të tjera normative të detyrueshme për zbatim.

KAPITULLI II

EMËRTIMI, FORMA LIGJORE, OBJEKTI, KOHËZGJATJA DHE SELIA E SHOQËRISË.

Neni 2
Emërtimi

- 2.1 Emri i shoqërisë është "INSIG JETË" sh.a.
- 2.2 Shoqëria ka vulat e veta. Vulat e shoqërisë me format dhe përmasat e tyre janë:
- a) *Vula e vogël, me diametra 2.5 cm e rrumbullakët dhe me tekstin mbi vulë si vijon: Republika e Shqipërisë Instituti i Sigurimeve Insig Jetë Tiranë, Sekretaria.*
 - b) *Vula e madhe, me diametra 2.9 cm e rrumbullakët dhe me tekstin mbi vulë si vijon: Republika e Shqipërisë Instituti i Sigurimeve Insig Jetë Tiranë.*
 - c) *Vula katërkëndëshe me dimensione 4 x 1.2 cm me tekstin mbi vulë si vijon: INSIG JETË Drejtoria, NIPT J62006012D Jetë.*

- 2.4 Shoqëria do të përdorë emërtimin "INSIG JETË" sh.a në të gjitha aktet dhe dokumentet zyrtare, të shoqëruar nga tregimi i adresës së selisë, numrit të NIPT-it dhe kapitalit të shoqërisë.
- 2.5 Sigla e Shoqërisë "INSIG JETË" sh.a, ka një formë dhe pamje të përcaktuar, siç duket në fletën ankes bashkëngjitur, pjesë përbërëse e këtij Statuti.

Neni 3 Forma ligjore

- 3.1 Shoqëria e Sigurimeve "INSIG JETË" sh.a, është shoqëri e krijuar në formën e shoqërisë aksionere, e cila vepron në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", (i ndryshuar me Ligjin Nr.129/2014), të Ligjit Nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit" dhe akteve të tjera normative të detyrueshme për zbatim.
- 3.2 Shoqëria është themeluar në bazë të Ligjit nr 7506, datë 31/07/1991 "Për Institutin e Sigurimeve" dhe rregjistruar me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë Nr.21463, datë 08.06.1999 .

Neni 4 Objekti i veprimtarisë tregtare të shoqërisë

- 4.1 Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit dhe risigurimit, nëpërmjet përgatitjes, ofrimit, nënshkrimit dhe zbatimit të kontratave të sigurimit "Jetë", sipas termave dhe klasave të përcaktuara në Ligjin Nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", akteve të tjera normative dhe për të cilat është e licënsuar nga Autoriteti i Mbikeqyrjes Financiare.
- 4.2 Shoqëria është e licënsuar për të ushtruar veprimtari sigurimi dhe operacione të tjera të lidhura drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë me veprimtarinë e sigurimit, në përputhje me klasat për të cilat është e licënsuar dhe sipas termave të ligjit specifik.

- 4.3 Shoqëria mund të hapë degë, filiale, apo zyra përfaqësie si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera që ekzistojnë ose mund të krijohen në të ardhmen, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 5
Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë e pacaktuar, duke filluar nga momenti i rregjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar, datë 31/07/1999
- 5.2 Asambleja e Përgjithëshme mund të zgjasë ose shkurtojë veprimtarinë e shoqërisë në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 6
Selia

- 6.1 Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: Rr. Kavajes, Nr.116, Tiranë, Shqipëri.
Adresa e faqes së internetit të Shoqërisë është : www.insig.com.al
- 6.2 Asambleja e Përgjithëshme e Shoqërisë ka tagrin të ndryshojë adresën e selisë së shoqërisë.

Neni 7
Kapitali i shoqërisë

- 7.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 370.000.000,00 (treqind e shtatëdhjetë milionë), i ndarë në 616 aksione me vlere nominale 600.000,00 Lekë (gjashtë qind mije) secili, tërësisht i nënshkruar dhe shlyer nga aksionarët.
- 7.2 Pjesëmarrja e aksionerëve në kapitalin themeltarë të shoqërisë është si më poshtë

Nr.	Emri Mbiemri	Përqindja	Nr i Aksioneve	Vlera në lekë
1.	"EUROSIG" SHA	100%	616,66	370.000.000,00

- 7.3 Aksionerët kanë të drejtën e fitimit/dividentit mbi bazën e përqindjes së aksioneve që ata zotërojnë.

- 7.4 Pronësia mbi aksionet jep të drejtën e votës dhe të përfaqësimit në mbledhjet e Asamblesë së Aksionarëve sipas kushteve të përcaktuara në ligj dhe në këtë Statut.

Neni 8

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 8.1 Asambleja e Aksionarëve, mund të zmadhojë ose zvogëlojë kapitalin e shoqërisë me vendim, në përputhje me dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 9901 datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar dhe Ligjit Nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".
- 8.2 Asambleja e Aksionarëve e mund të vendose që zmadhimi i kapitalit të kryhet me emetim të aksioneve të reja, të cilat mund t'u ofrohen për nënshkrim vetëm aksionarëve ekzistues, në përpjesëtim me aksionet e zotëruara prej tyre përpara rritjes së kapitalit apo duke rritur vlerën nominale të secilit aksion. Me perjashtim të rastit kur rritja e vlerës nominale të secilit aksion vendoset të realizohet me përfshirjen e aktiveve të shoqërisë, sipas nenit 177 të Ligjit për Tregtarët, zmadhimi i kufizuar i kapitalit, në rastin e sipërpërmendur, mund të kryhet vetëm me miratimin unanimit të të gjithë aksionarëve.
- 8.3 Aksionarët kanë të drejtën e përparësisë në nënshkrimin e aksioneve që do të emetohen pas zmadhimit të kapitalit dhe regjistrimit të këtij zmadhimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Kjo e drejtë mund të ushtrohet në përpjesëtim me numrin e aksioneve të zotëruara nga secili aksionar përpara zmadhimit të kapitalit.
- 8.4 Zvogëlimi i kapitalit do të ketë ndikim mbi aksionarët proporcionalisht me numrin e aksioneve që ata zotërojnë. Kapitali nuk mund të zvogëlohet nën vlerën minimale të kërkuar nga Ligji.

Neni 9

Rregjistri i aksioneve

- 9.1 Aksionet e shoqërisë dhe pronësia mbi to, rregjistrohen në Rregjistrin e Aksioneve, i cili është një dokument që mbahet nga Administratorët e shoqërisë dhe që pasqyron të gjitha veprimet që kryhen me aksionet e shoqërisë si dhe të dhënat e zotëruesëve të aksioneve të shoqërisë si :
- Emri dhe mbiemri i aksionerit.
 - Emri i rregjistruar i aksionerit nëse është person juridik

- Vlera nominale e aksionit
 - Adresa e banimit, ose zyra qendrore e aksionerit
 - Data e kryerjes së rregjistrimit
- 9.2 Të drejtat që lidhen me aksionet nuk mund të ushtrohen nga mbajtësit e tyre pa u rregjistruar në Rregjistrin e Aksioneve.

Neni 10 **Transferimi i aksioneve**

- 10.1 Aksionet janë lirisht të transferueshme midis aksionerëve, bashkëshortëve si dhe në rrugë trashëgimie sipas dispozitave përkatëse.
- 10.2 Nëse ndonjë nga aksionerët vendos të transferojë një pjesë apo të gjitha aksionet që i përkasin atij, tek të tretët, të cilët nuk janë bashkëshorti apo trashëgimtarët e drejtëpërdrejtë sipas përcaktimeve ligjore, ai detyrohet të rrespektojë të drejtën e parablerjes, duke ia ofruar më parë aksionet, akisonarit/(ëve) të tjerë të shoqërisë. Oferta përpilohet përpara noterit dhe i njoftohet aksionarëve të tjerë nëpërmjet shërbimit postar të porositur (rekomande) dhe duhet të përmbajë numrin e aksioneve që do të transferohen, çmimin e kërkuar për to dhe periudhën kohore brenda së cilës oferta është e vlefshme, në mënyrë që akionarët e tjerë të ushtrojnë të drejtën e blerjes apo të refuzojnë ofertën.
- 10.3 Secili aksioner e gëzon të drejtën e parablerjes për të blerë aksionin përpjestimisht me pjesmarrjen e tij në kapitalin themeltar.
- 10.4 Nëse një ose disa prej aksionerëve refuzojnë të drejtën e parablerjes, aksionerët e tjerë gezojnë të drejtën për të blerë aksionin përpjestimisht me pjesmarrjen e tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 10.5 Nëse vetëm njëri prej aksionerëve ushtron të drejtën e parablerjes, ai gëzon të drejtën e blerjes së aksionit pamvarësisht pjesmarrjes së tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 10.6 E drejta e parablerjes do të ushtrohet brenda një periudhe 1 (një) mujore, duke filluar nga data në të cilën oferta i është njoftuar Asamblesë së Përgjithëshme dhe/ose secilit prej aksionerëve. Nëse aksionerët nuk e ushtrojnë të drejtën e parablerjes brenda aftatit kohorë, shitësi i aksioneve ka të drejtë të transferojë aksionet tek të tretët.

Neni 11 **E drejta e votës**

Çdo aksion i zakonshëm i jep zotëruesit të tij të drejta vote në raport me pjesën e kapitalit që përfaqëson aksioni.

KAPITULLI III
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I SHOQËRISË

Neni 12

Organet e shoqërisë

- 12.1 Organizimi i shoqërisë "INSIG JETË" sh.a, funksionon sipas përcaktimit të Nenit 19 të Ligjit Nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", dhe konkretisht sipas sistemit me dy nivele.
- 12.2 Organet e shoqërisë janë:
- i. Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve.
 - ii. Këshilli Mbikëqyrës
 - iii. Drejtori i Përgjithshëm / Administratori
- 12.3 Kompetencat dhe përgjesësitë e organeve të shoqërisë, përveç sa parashikon ligji nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, janë edhe ato të përcaktuara në nenin 19, pika 4 dhe nenin 22 të Ligjit nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" si dhe ato të përcaktuara shprehimisht në këtë Statut.

Neni 13

Asambleja e Përgjithëshme

Asambleja e Përgjithëshme është mbledhja e përgjithëshme ku të gjithë aksionerët e shoqërisë kanë të drejtë të thirren për t'u mbledhur në një takim formal dhe të marrin vendime në lidhje me çështjet e rendit të ditës, të njoftuar sipas procedurës së përcaktuar në ligj dhe Statut.

Neni 14

Thirrja e Asamblesë së Përgjithëshme

- 14.1 Asambleja e Përgjithëshme thirret në rastet e përcaktuara në ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar apo në raste të veçanta të parashikuara në këtë Statut.
- 14.2 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithëshme si rregull thirret nga Administratorët e Shoqërisë, por në raste të caktuara, sipas parashikimeve të ligjit "Për tregtarët

- dhe shoqëritë tregtare", mund të thirret edhe nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës, ose nga aksionerët që zotërojnë të paktën 5% të kapitalit të rregjistruar të shoqërisë.
- 14.3 Njoftimi i mbledhjes së Asamblesë u dërgohet çdo aksionari, të paktën 21 (njëzetë e një) ditë përpara mbledhjes, duke përcaktuar në të datën, orën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes. Njoftimi u dërgohet aksionarëve me shkrim sipas formave të njohura ligjore duke përfshirë edhe faksin apo postën elektronike.
- 14.4 Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës së Asamblesë si dhe të gjithë elementët e përcaktuar në Nenin 137, të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", të ndryshuar .
- 14.5 Vendimet e Asamblesë së Përgjithëshme të mbledhur në kundërshtim me sa më sipër, duhet të shfuqizohen nga vetë Asambleja ose Gjykata kompetente. Përjashtim bëhet në rastin kur të gjithë aksionerët janë të pranishëm ose të përfaqësuar rregullisht në Asamblenë e Përgjithëshme dhe bien dakort që kjo Asamble të mbledhet pa rrespektuar procedurën e sipërcituar.
- 14.6 Në rastet kur njoftimet për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithëshme, kryhen nëpërmjet postës elektronike, ato duhet të dërgohen në adresat e deklaruara nga aksionerët të cilat rregjistrohen në Rregjistrin e Aksioneve, si dhe në çdo rast duhet të merren masat që të provohet se këto njoftime janë kryer rregullisht dhe sipas afateve ligjore.
- 14.7 Mbledhjet e Asamblesë së Aksionarëve mbahen në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër që mund të përcaktohet rast pas rasti nga Këshilli Mbikëqyrës ose Adminsitratori.
- 14.8 Administratorët e shoqërisë marrin masa që mbledhjet e Asamblesë të pasqyrohen në një proces verbal, i cili duhet të përmbajë ndër të tjera.
- datën, orën dhe vendin e mbledhjes;
 - aksionerët e pranishëm dhe numrin e aksioneve që ata përfaqësojnë;
 - rendin e ditës;
 - çeshtjet kryesore të diskutimeve;
 - format dhe rrezultatet e votimeve;
 - vendimet që u morën;

14.9 Administratorët duhet të kujdesën që :

- vendimet e marra në këto mbledhje të zbardhen dhe nënshkruhen rregullisht
- listat e pjesmarrësëve të bashkëngjiten në dokumentacionin e mbledhjes
- të fiksohen me korrektësi format e votimit, nëse do të ushtrohen nëpërmjet pjesmarrjes së drejtëpërdrejtë apo komunikimeve të njohura elektronike apo telefonike në kohë reale.

14.10 Asambleja e Përgjithëshme merr vendime të vlefshme në rastet kur:

- mbledhjet e saj janë thirrur në mënyrë të rregullt;
- aksionerët që marrin pjesë në mbledhje ose përfaqësuesit e tyre, përfaqësojnë kapitalin e nevojshëm të shoqërisë të kërkuar në formën e kuorumeve të mbledhjeve për marrjen e vendimeve të caktuara;

Neni 15
Kompetencat e Asamblesë së Përgjithëshme
Vendimmarrja

15.1 Asambleja e Përgjithëshme ushtron kompetencat e mëposhtme dhe vendos në mënyrë ekskluzive për:

- a. përcaktimin e politikave tregtare;
- b. ndryshimet në Statut;
- c. emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës;
- d. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- e. emërimin e shoqërisë audituese, e cila duhet të jetë person juridik i licensuar për të kryer veprimtari audituese në Republikën e Shqipërisë;
- f. emërimin dhe shkarkimin e likuiduesëve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- g. miratimin e skemës së shpërblimeve për anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, administratorët, ekspertët kontabël, likuiduesëve dhe antarëve të Komitetit të Auditimit;
- h. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së kompanisë;
- i. shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- j. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit;
- k. pjestimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
- l. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë;
- m. përfaqësimet e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;



- n. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - o. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
 - p. çeshtje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo ky statut;
- 15.2 Secili aksioner mund të përfaqësohet në mbledhje nga një aksioner tjetër apo një person i tretë; Aksionerët dhe/ose anëtarët e Këshillit Mbikqyrës nuk mund të veprojnë në mbledhje si përfaqësues të aksionerëve të shoqërisë.
- 15.3 Për formën e pjesmarrjes në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithëshme, kuorumin e pjesmarrjes si dhe kuorumin e vendimmarrjes, aksionerët e shoqërisë do të referohen dispozitave përkatëse të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*", të ndryshuar .

Neni 16 Këshilli Mbikqyrës

- 16.1 Këshilli Mbikqyrës ushtron funksione mbikqyrje dhe ka këto të drejta dhe përgjegjësi lidhur me:
- a. zbatimin e legjislacionit në fuqi nga shoqëria e sigurimit;
 - b. miraton dhe duhet të garantojë një mbikqyrje të matur për zbatimin e politikave, strategjive dhe sistemeve të administrimit të rrezikut;
 - c. krijimin e sistemit të kontrollit dhe auditimit të brendshëm për të gjitha fushat e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, si dhe funksionimin e tyre në përputhje me dispozitat e ligjit nr.52/2014;
 - d. mbikqyrjen e administrimit të rrishtit, ndaj të cilit shoqëria e sigurimit ekspozohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj;
 - e. garantimin e vërtetësisë dhe saktësisë së të dhënave të raporteve financiare dhe statistikore të shoqërisë së sigurimit, si dhe raporteve të tjera të kërkuara nga Autoriteti apo Asambleja e Përgjithëshme. Këto dokumente duhet të miratohen e nënshkruhen nga të gjithë antarët e këshillit mbikqyrës, për t'ju paraqitur Asamblesë, së bashku me një raport të këshillit për miratim dhe një përshkrim për mbikqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
 - f. raportimin dhe informimin e Autoritetit sipas dispozitave të ligjit nr.52/2014 "*Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit*";
 - g. të përgatisë me kërkesë së Asamblesë së Përgjithëshme, marrjen e masave që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;

- h. të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithëshme sa herë vlerësohet e nevojëshme për interesat e shoqërisë.
 - i. të japë direktiva për Administratorin për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - j. të kontrollojë e mbikqyrë zbatimin e politikavë tregtare të shoqërisë nga administratorët;
 - k. të siguroje se auditimi i librave dhe i rregjistrimeve kontabël të kryhet të paktën njëherë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur dhe raporti i auditimit drejtuar asamblesë së përgjithshme t'u vihet në dispozicion të gjithë antarëve të këshillit dhe Adminsitatorin;
 - l. të përcaktojë shpërblimin e administratorëve;
 - m. të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5% të kapitalit të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emetimit të obligacioneve, apo instrumentave të tjera të borxhit;
 - n. të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave për themelimin e shoqërive tregtare ose grupeve të reja, sipas edhe termave të ligjit nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit";
 - o. të kryejë veprime të tjera të përcaktuara në ligj dhe statut;
- 16.2 Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga (tre) anëtarë të cilët emërohen për një afat 3 vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Anëtarët e Këshillit emërohen nga mbledhja e përgjithshme e aksionerëve, vetëm nëse aksionerët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, vendosin me tre të katërtat e aksionerëve që marrin pjesë në votim, sipas neneve 144, pika 1 dhe 145, pika 1, të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar .
- 16.3 Në emërimin e anëtarëve të këshillit merren parasysh kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi të parashikuara në nenin 17 të ligjit nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", kriteret e parashikuara nenin 20 të ligjit të sipërcituar dhe rregullores përkatëse të AMF nr.137, datë 21.12.2015, të ndryshuar, si dhe papajtueshmëritë e nenit 13 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar. Gjithashtu anëtarët e këshillit mbikqyrës duhet të shmangin interesin privat i cili krijon konflikt me interesin e "INSIG JETË " sh.a.
- 16.4 Anëtarët e këshillit duhet të jenë të ndryshëm nga administratorët e shoqërisë.

- 16.5. Mandati i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës është 3 (tre) vjet me të drejtë rizgjedhjeje.
- 16.6 Anetaret e Keshillit Mbikqyres te shoqerise INSIG SHA JETE jane 3 (tre), dhe emërohen për një afat 3 vjeçar me të drejtë rizgjedhje,
1. Vasil Pilo, **Kryetar**, i datelindjes 11/11/1946, lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Tirane, identifikuar nepermjet pasaportes nr.personal E61111012B.
 2. Rexhep Meidani, **Anëtar**, i datelindjes 17/08/1944, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, identifikaur nepermjet pasaportes nr.personal E408170017T
 3. Thanas Xhillari, **Anëtar**, i datelindes 31/07/1953, lindur ne Permet dhe banues ne Tirane, identifikuar nepermjet pasaportes nr.personal F30731052D,

Neni 17

Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës dhe Vendimmarrja

- 17.1 Këshilli Mbikqyrës mblidhet jo më rrallë se një herë në tre muaj dhe merr në shqyrtim raportet që paraqet administrator.Mbledhja thirret nga kryetari dhe në mungesë të tij nga zëvendësi ose antarët e tjerë të Këshillit.
- 17.2 Kryetari dhe në mungesë të tij zëvendësi thërrasin mbledhjen e Këshillit brenda 15 ditësh kur një e treta e anëtarëve të këshillit i paraqesin një kërkesë të arsyeshme për këtë.
- 17.3 Mbledhjet e Këshillit Mbikqyrës mbahen në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër të caktuar nga Kryetari ose Zëvendës Kryetari. Si rregull njoftimi për mbledhjen duhet t'u dërgohet anëtarëve tre ditë përpara, me letër e-mail, nëpërmjet njoftimit në ëeb-site e shoqërisë, ose me formë tjetër të shkruar komunikimi.
- 17.4 Çdo thirrje duhet të përmbajë çeshtjet kryesore të rendit të ditës si dhe materialet që do të diskutohen.
- 17.5 Vendimet e Këshillit konsiderohen të vlefshme nëse në procesin e vendimmarrjes janë të pranishëm më shumë se një e dyta e anëtarëve. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Statut, vendimet merren me shumicën e votive të

anëtarëve të pranishëm dhe kur për një çështje ka barazim votash, vota e Kryetarit mbizotëron.

- 17.6 Vendimet e Këshillit Mbikqyrës mund të merren sipas përcaktimeve të Statutit apo rregulloreve të këshillit, duke shprehur votën me shkresë, me telefon, apo mjete të tjera të komunikimit elektronik, me përjashtim të rasteve kur një anëtar i këshillit ka kundërshtim për këtë mënyrë vendimmarrjeje.
- 17.7 Vendimet e Këshillit Mbikqyrës evidentohen me anë të procesverbaleve të mbajtura në një liber të posaçëm (protokoll), i numërtuar dhe i vulosur, që mbahet në selinë qendrore të shoqërisë, në të cilën tregohen, veç të tjerash, anëtarët e pranishëm të përfaqësuar dhe të munguar si dhe çdo person tjetër që ka asistuar në mbledhjen e Këshillit tërësisht ose pjesërisht.

Neni 18 Administratori

- 18.1 Administratori ushtron funksione të administrimit, të cilët kanë të drejtë dhe detyrohen:
- a. të zbatojnë legjislacionin në fuqi nga shoqëria e sigurimit "INSIG JETË" sh.a ;
 - b. të administrojnë rrezikun ndaj të cilit shoqëria e sigurimit ekspozohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj;
 - c. të mbajnë kontabilitetin, përgatitjen e raporteve financiare dhe statistikore të shoqërisë së sigurimit, si dhe raporteve të tjera të kërkuara nga Autoriteti, në përputhje me rregullat dhe metodat e përcaktuara;
 - d. të raportojnë dhe informojnë Autoritetin, sipas dispozitave të ligjit specifik apo akteve të tjera normative;
 - e. të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
 - f. të përgatisin dhe nënshkruajnë bilacin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin Këshillit Mbikqyrës për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim në asamblenë e përgjithshme;
 - g. të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë "INSIG JETË" sh.a;
 - h. të kryejnë rregjistrimet dhe publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë sipas parashikimeve ligjore;
 - i. të raportojnë përpara këshillit për zbatimin e politikave tregtare dhe realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë.
 - j. të kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në këtë statut;

- 18.2 Detyrat që i cakton ligji Këshillit nuk mund t`u delegohen Administratorit;
- 18.3 Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4, 5 të nenit 136 të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, administratorët duhet të informojnë menjëherë Kryetarin e Këshillit, i cili duhet të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme.
- 18.4 Mandati i administartorit të shoqërisë është dy vite, me të drejtë rizgjedhjeje.
- 18.5 Administratori i Shoqerise "INSIG JETE" sha caktohet znj.Elvana Mino, e datelindjes 16/07/1967, lindur ne Tirane dhe banuese ne Tirane, identifikuar nepermjet leternjoftimit nr.personal G75716044A.

Neni 19

Komiteti i Auditimit – Auditi i Brendshëm

- 19.1. Komiteti i Auditimit përbëhet nga jo më pak se tre anëtar dhe ndër të tjera ka këto detyra:
- monitoron proceset e raportimit financiar dhe vlerëson integritetin e pasqyrave financiare të shoqërisë së sigurimit;
 - monitoron mjaftueshmërinë dhe efektshmërinë e sistemit të kontrolleve të brendshme të shoqërisë së sigurimit;
 - monitoron përshtatshmërinë dhe mjaftueshmërinë e proceseve të projektuara për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullatore;
 - propozon drejtuesin e njësisë së auditimit të brendshëm dhe monitoron veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm;
 - propozon audituesin e jashtëm dhe shqyrton e monitoron pavarësinë e shoqërisë audituese;
 - komiteti i auditimit mbledhet jo më pak se katër herë në vit në mbledhje të zakonshme, si dhe në mbledhje të jashtëzakonshme sa herë thirret nga këshilli mbikëqyrës. Vendimet merren me shumicë votash të të gjithë anëtarëve të pranishëm. Abstenimi nuk lejohet. Komiteti i auditimit, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, mund të ndihmohet nga ekspertë të jashtëm të zgjedhur prej tij.
 - Komiteti i auditimit i raporton këshillit mbikëqyrës dhe e ndihmon këtë të fundit gjatë procesit vendimmarrës dhe mbikëqyrës të shoqërisë .
 - Auditi i Brendshëm, i cili krijohet si një njësi që funksionon në mënyrë të pavarur dhe objektive për të dhënë opinion të specializuar, si dhe për të përmirësuar veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit, raporton gjetjet përpara Këshillit Mbikqyrës, si dhe ndjek në bashkëpunim me drejtuesit e lartë të kompanisë zbatueshmërinë e tyre.

- i. Njësia e auditimit të brendshëm si pjesë përbërëse e sistemit të kontrollit të brendshëm, ka për detyrë të ushtrojë një metodë të integruar dhe të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e proceseve të qeverisjes, administrimit të rrezikut dhe kontrolleve të shoqërisë;
- j. Njësia e auditimit të brendshëm kryen auditimin e brendshëm të veprimtarisë së shoqërisë, në përputhje me parimet profesionale dhe standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm, kodin ndërkombëtar të etikës profesionale për audituesit e brendshëm dhe praktikat për ta.

Neni 20

Shoqëria Audituese

- 20.1 Asambleja e Përgjithshme emëron shoqërinë audituese të shoqërisë së sigurimit, shoqëri e cila është person juridik i licencuar për të ushtruar veprimtari audituese në Republikën e Shqipërisë.
- 20.2 Shoqëria audituese përgjidhet sipas rregullave dhe kriterëve të miratuara nga Autoriteti.
- 20.3 "INSIG JETË" sh.a, depoziton në Autoritet një kopje të raportit të auditimit dhe letrën për drejtimin, brenda 15 ditëve kalendarike nga data e marrjes së tyre, por jo më vonë se data 30 prill e vitit pasardhës. Nëse shoqëria përgatit llogari të konsoliduara, raporti i mësipërm depozitohet jo më vonë se data 31 maj e vitit pasardhës.

Neni 21

Të drejtat dhe detyrat

- 21.1 Shoqëria audituese e dërgon raportin e auditimit në asamblenë e përgjithshme dhe komitetin e auditimit të shoqërisë.
- 21.2 Shoqëria audituese jep opinionin e saj nëse llogaritë vjetore të "INSIG JETË" sh.a, të konsoliduara dhe të pakonsoliduara janë në përputhje me standardet dhe rregullat profesionale në fuqi.
- 21.3 Shoqëria audituese raporton menjëherë në Autoritet çdo fakt që lidhet me "INSIG JETË" sh.a, për të cilin shoqëria audituese është vënë në dijeni gjatë kryerjes së detyrave të saj për:
 - a. shkelje të ligjeve, akteve nënligjore në fuqi, akteve të Autoritetit ose akteve administrative, që kanë të bëjnë me kushtet, në bazë të të cilave i është dhënë licenca për të ushtruar veprimtari sigurimi;
 - b. mashtrim ose përvetësim, vjedhje, pastrim parash apo financim të terrorizmit;

- c. shkelje të rregullave të brendshme të shoqërisë së sigurimit;
 - d. ndryshim të rëndësishëm të rezultatit financiar të paraqitur në llogaritë vjetore të paaudituar;
 - e. fakte dhe rrethana të tjera shtesë, të cilat mund të kenë ndikim mbi veprimtarinë e mëtejshme të shoqërisë së sigurimit;
 - f. çdo transaksion të shoqërisë së sigurimit me palë të lidhura që përbën rrezik për likuiditetin dhe për rregullat e administrimit të rrezikut.
- 21.4 Raporti i auditimit, që përmban opinionin për pasqyrat financiare, shoqërohet nga raporti i aktuarit të shoqërisë audituese, i cili jep opinion për mjaftueshmërinë e provigjoneve teknike të "INSIG JETË" sh.a, sipas këtij ligji dhe akteve të Autoritetit, duke u bazuar në teknikat e duhura aktuariale.
- 21.5 Raportimi, informimi dhe dhënia e çdo fakti, sipas pikave 21. 3 dhe 21. 4, të këtij neni, nga ana e shoqërisë audituese nuk përbën shkelje të kufizimeve për dhënie të informacionit, të përcaktuara në kontratë ose në legjislacionin në fuqi dhe personat janë të çliruar nga çdo lloj përgjegjësie.
- 21.6 Shoqëria audituese është e detyruar t'i japë Autoritetit shpjegime shtesë për auditimin e kryer dhe raportin e auditimit, si dhe çdo informacion tjetër që Autoriteti e gjykon të nevojshëm në funksion të ushtrimit të mbikëqyrjes.
- 21.7 Ajo ka detyrim të informojë menjëherë Autoritetin nëse gjatë kryerjes së detyrave shoqëria audituese konstaton se "INSIG JETË" sh.a ka shkelur rregullat e administrimit të rrezikut dhe si pasojë cenohen interes e të siguruarve, si dhe rrezikohen likuiditeti apo vijueshmëria e veprimtarisë së saj.
- 21.8 "INSIG JETË" sh.a publikon raportin vjetor, i cili përmban pasqyrat financiare të audituara dhe opinionin e audituesit, dhe e vendos në faqen zyrtare të internetit jo më vonë se 6 muaj nga përfundimi i vitit kalendarik.
- 21.9 Shoqëria audituese auditon dhe vlerëson pajtueshmërinë e pasqyrave financiare të "INSIG JETË" sh.a në përputhje me SNRF-të dhe legjislacionin në fuqi.

KAPITULLI IV

Neni 22

Viti financiar

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me datë 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik.

Neni 23

Pasqyrat financiare dhe kontabiliteti

- 23.1 Pasqyrat financiare vjetore, përfshirë bilancin dhe deklaratat do të përgatiten sipas legjislacionit shqiptarë dhe përsa kohë është e mundur, atëherë kur ligji shqiptarë lejon zgjedhjen e standarteve të ndryshme të kontabilitetit, në IFRS.
- 23.2 Librat kontabël do të mbahen në gjuhen shqipe dhe monedhën shqiptare në përputhje të plotë me ligjet dhe rregullat në fuqi të legjislacionit shqiptar.
- 23.3 Caktimin e Shoqërisë "Grant-Thorton Albania" sh.p.k si Ekspert Kontabel të Autorizuar për auditimin e pasqyrave Financiare të vitit 2017, me administrator z.Kleidi Kodra, me Nipt K91923007M.

Neni 24 Shpërndarja e Dividentit

- 24.1 Shoqëria do të deklarojë dhe shpërndajë tek Aksionerët e saj si dividend, të gjithë fitimin e disponueshëm, pasi ajnë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore dhe të rezervave të njohura nga legjislacioni në fuqi.
- 24.2 Asambleja e Përgjithshme përpara se të vendosë për ndarjen e dividendit, duhet të vlerësojë interesin më të mirë të Shoqërisë, duke marrë në konsideratë gjendjen financiare të saj.

Neni 25 Rezultati financiar

- 25.1 Rezultati financiar i shoqërisë përcaktohet në mbyllje të çdo viti, si diferencë midis të ardhurave dhe shpenzimeve, pasi të zbriten gjithashtu amortizimet dhe shumat e provigjoneve për zhvlerësime dhe për rreziqe dhe shpenzime. Rezervat e sigurimeve të shtuara zbriten nga primet e sigurimit të vitit sipas rregullave përkatëse ligjore dhe kjo realizohet përpara nxjerrjes së rezultatit.
- 25.2 Fitimi neto i shoqërisë përcaktohet pasi të zbritet tatimi mbi fitimin i llogaritur në mënyrë të përqendruar për shoqërinë në tërësi.

Neni 26 Ndarja e fitimit neto

- 26.1 Fitimi neto i shoqërisë përdoret si vijon:
- Për rezervën e nevojshme për të plotësuar minimumin e kapitalit (Fondit të Garancisë) sipas përcaktimeve të ligjit nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit";
 - Për rezerva të tjera të nevojshme;
 - Për dividendin;

- 26.2 Fitimet e shoqërisë nuk mund të caktohen për shpërblime apo përfitime të tjera të personelit, për sponsorizime apo dhurime dhe as për ndonjë qëllim tjetër që ka natyrë shpenzimi dhe hyn në koston e shoqërisë;

Neni 27
Dividentët

- 27.1 Fitimi i shpërndashëm si dividend përbëhet nga fitimi neto i vitit financiar paraardhës, i pakësuar me humbjet e mbartura si dhe pasi janë zbritur shpenzimet që shoqëria duhet të kalojë në rezervë ligjore, të paktën 5% të kësaj vlere, derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 10% me kapitalin e rregjistruar të shoqërisë nëse gjen zbatim për veprimtarinë e ushtruar apo rezerva të tjera të detyrueshme për t'u krijuar bazuar në ligjin nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".
- 27.2 Fitimi i shpërndashëm ndahet midis të gjithë aksionerëve në përpjestim me numrin e aksioneve që zotëron secili prej tyre.
- 27.3 Shoqëria nuk mund të ndajë dividend nëse kapitali ka rënë nën minimumin e kërkuar me ligj apo kur një gjë e tillë kërkohet nga Autoritetet përkatëse.

Neni 28
Humbja dhe mbartja e tyre

Pas miratimit të gjendjes financiare vjetore nga Asambleja e Përgjithshme, humbja e rezultuar në një vit financiar mbartet në vitet pauses për t'u mbuluar nga fitimet e ardhshme deri në shuarjen e humbjes. Mbulimi i humbjes bëhet në mënyrë përpjestimore nga aksionerët sipas aksioneve që ata zotërojnë.

Neni 29
KAPITULLI V
DEGËT E SHOQËRISË

Shoqëria e Sigurimeve "INSIG JETË" sh.a, e kryen aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj, nëpërmjet filialeve, degëve, pikave të shitjes, zyrave të përfaqësimit ose agjencive, të cilat krijohen në bazë rrethi apo rajoni, me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Shoqërisë . Degët brenda territorit të Republikës së Shqipërisë veprojnë nën mbikëqyrjen e Adminsitratorit.

Degët jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë funksionojnë sipas rregullave të miratuara nga Këshilli Mbikqyrës.

Neni 30

Drejtimi i Degëve të "INSIG JETË" sh.a , raportimet

Drejtimi dhe organizimi i degës ushtrohet nga drejtori/ përgjegjësi, i cili përgjigjet për të gjithë veprimtarinë e degës në përputhje me legjislacionin në fuqi që vepron në fushën e sigurimeve, urdhërave dhe udhëzimeve të drejtorit dhe dispozitave të këtij Statuti.

Degët krijohen me propozim të të Drejtorit ekzekutiv dhe me miratim të Këshillit Mbikqyrës të kompanisë.

Marrja në punë dhe largimi nga puna i personelit të Degës (përfshirë edhe përgjegjësin/drejtorin e degës) bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm i "INSIG JETË" sh.a.

KAPITULLI VI

LIKUJDIMI

Për administrimin e përkohshëm si dhe likujdimin e shoqërisë veprojnë dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar dhe ato të ligjit nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", konkretisht Kreu IX i këtij ligji.

KAPITULLI VII

DETYRIME PËR SEKRETIN E TË TJERA

Neni 31

Detyrimi për ruajtjen e sekretit

Antarët e Këshillit Mbikqyrës, Adminsitratori, Eksperti Kontabël i miratuar, të gjithë punonjësit e kompanisë dhe agjentët kanë detyrimin ligjor të ruajnë fshehtësinë e çdo informacioni të marrë gjatë ushtrimit të detyrës në "INSIG JETË" sh.a dhe të mos e përdorin atë për përfitime personale apo tek të tretët, si gjatë kohës kur janë të punësuar në kompani, ashtu edhe pas largimit të tyre.

"INSIG JETË" sh.a, ka të drejtë të ngrejë padi civile dhe penale, sipas legjislacionit në fuqi, ndaj të gjithë atyre personave që për shkak të nxjerrjes së informacionit dëmtojnë interes e kompanisë.

Këshilli Mbikqyrës përcakton rregulla dhe procedura më të hollësishme lidhur me ruajtjen e sekretit nga personat e sipërcituar si dhe për komunikimin e informacioneve autoriteteve apo organeve të cilat kjo e drejtë u është njohur me ligj.

Gjithashtu shoqëria "INSIG JETË" sh.a është e detyruar të ruajë sipas legjislacionit përkatës dhe Kodit të Punës konfidencialitetin e të dhënave, fakteve dhe rrethanave që

kanë të bëjnë jo vetem me të siguruarit, por edhe punëmarrësit, të dhëna me të cilat njihen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Neni 32

Detyrimi për të vënë në dispozicion të aksionerëve dokumentat dhe informacionin

Shoqëria mban dhe vë në dispozicion të aksionerëve, në kushtet dhe afatet e parashikuara në ligj, raportet, dokumentat dhe llogaritë vjetore që shqyrton asambleja. Me përjashtim të ndonjë dokumenti të përcaktuar nga Asambleja, dokumentat që duhet t'u vihen në dispozicion aksionerëve u dërgohen së bashku me njoftim-thirrjen për mbledhje.

Neni 33

Detyrimi për të raportuar në Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare

Raportimi në AMF bëhet konform të gjitha akteve normative për këtë qëllim. Dokumentat e kërkuara dërgohen vetem me nënshkrimin e administratorit, ose nga persona të autorizuar nga Administratori, apo persona të tjerë që ua atribuon ligji të bëjnë një gjë të tillë.

Administratori është i detyruar, që ekspertëve kontrollues që paraqiten në shoqëri të pajisur me dokumenta sipas akteve ligjore, t'u vërë në dispozicion për të kontrolluar të gjithë dokumentacionin e kërkuar prej tyre.

Neni 34


Të ndryshme

Për çdo klauzolë të parashikuar në këtë Statut, Aksionerët, Antarët e Këshillit Mbikqyrës, Administratorët, do t'i referohen dispozitave përkatëse të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar dhe ligjit nr.52/2014 "Për veprimatrinë e sigurimit dhe risigurimit", apo çdo ligji tjetër në fuqi që rregullon marrëdhënien juridike përkatëse. Ky statut hy në fuqi me nënshkrimin e tij nga Aksionerët e "INSIG JETË" sh.a dhe pas miratimit paraprak nga AMF.

AKSIONERËT

"EUROSIG" SHA

100%
ADMINISTRATORI
XHEVDET KOPANI



ANEKSI NR.1

VULAT E SHOQERISE INSIG SHA JETE



A handwritten signature in black ink, appearing to be "C. Mustafa".

Nr. extra prot

Date 23 / 12 / 2016

VENDIM

"EUROSIG" SHA

Nr. 12, datë. 23 / 12 / 2016

PËR

EMËRIMIN E EKSPERTIT KONTABËL TË AUTORIZUAR, PËR AUDITIMIN
E PASQYRAVE FINANCIARE TË "INSIG JETE" SHA PËR VITIN 2017

Sot në Tiranë, më 23 / 12 / 2016, ora 12:00, në selinë e shoqërisë "Insig", sha, me adrese Njesia Bashkiake nr.7, Rruga e Kavajes, nr.116, u paraqit perfaqesuesi Ligjor, i "Eurosig" sha, z.Xhevdet Kopani, i cili në zbatim të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e Sigurimit dhe Risigurimit", Rregullores për Ekspertët Kontabël të Autorizuar të shoqërive të sigurimit, për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2017, me unanimitet "Eurosig" sha aksioner 100% i "Insig" sha,

V E N D O S I:

1. Emërimin e shoqërisë "Grant Thornton Albania", shpk, Ekspertë Kontabël të Autorizuar, me administrator Z.Kledi Kodra, për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2017.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

AKSIONARËT:
"EUROSIG" SHA
100%


XHEVDËT KOPANI
ADMINISTRATORI



Nr. 24 prot

Datë 23/12/2016

VENDIM
"EUROSIG" SHA
Nr.13, dt. 23/12/2016
PËR
EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT MBIKËQYRËS
TË SHOQËRISË "INSIG" SH.A SHOQËRI SIGURIMI JETE DHE "INSIG" SH.A
SHOQËRI SIGURIMI JO-JETE

Sot në Tiranë, me datë 23/12/2016, në orën 12:00, në selinë e shoqërisë "Insig", sha, me adresë Njesia Bashkiake nr.7, Rruga e Kavajes, nr.116, u paraqit perfaqesuesi Ligjor, i "Eurosig" sha, z.Xhevdet Kopani, i cili në zbatim të neneve 17, 20, 25 pika 1 të ligjit 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", neni 135 pika c të ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nenit 3 të Rregullores "Për procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit/Mbikqyrës, Administratorit/Anëtarit të Bordit të Drejtorëve të shoqërisë së sigurimit" ndryshuar me Vendim Bordi nr.39 datë 31.03.2016, nenit 4 pika 6 të Rregullores "Për mbajtjen, mënyren, afatet e raportimit dhe njoftimit periodik në AMF nga shoqëritë e sigurimit", shkresës nr.1614 prot të datës 08/06/2016 me lëndë "Kërkesë për dorëheqje", në përfundim "Eurosig" sha zoteruese 100% e aksioneve,

VENDOSI:

1. Emerimin e Anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës me mandat 3 vjeçar duke filluar nga data 23/12/2016, si vijon:
 - a) Z.Vasil Pilo Kryetar
 - b) Z.Rexhep Mejdani Anëtar
 - c) Z.Thanas Xhillari Anëtar
2. Përbërja e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës sipas pikes 2 të këtij vendimi është e njëjte për "Insig" sha shoqëri sigurimi Jete dhe "Insig" sha shoqëri sigurimi Jo-Jete.
3. Ngarkohet Administratori i shoqërisë "Eurosig", sha përndjekjen e procedurave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

AKSIONARËT:
"EUROSIG" SHA
100%

XHEVDET KOPANI
Xhevdet Kopani
ADMINISTRATORI



Nr. 5 / prot

Date 23 / 12 / 2016

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHMEE AKSIONARËVE

VENDIM
Nr.5, dt. 23 / 12 / 2016

PËR EMËRIMIN E ADMINISTRATORIT TË "INSIG" SH.A SHOQËRI SIGURIMI JETE DHE ADMINISTRATORIT TË "INSIG" SH.A SHOQËRI SIGURIMI JO-JETE

Sot në Tiranë, me date 23 / 12 / 2016, në orën 12:00, në selinë e shoqërisë "Insig", sha, me adresë Njesia Bashkiake nr.7, Rruga e Kavajes, nr.116, u paraqit perfaqesuesi Ligjor, i "Eurosig" sha, z.Xhevdet Kopani, në zbatim të neneve 17, 20, 25 pika 1 te ligjit 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", neni 135 pika c të ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", neni 3 të Rregullores "Për procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit/Mbikëqyrës, Administratorit/Anëtarit të Bordit të Drejtorëve të shoqërisë së sigurimit" ndryshuar me Vendim Bordi nr.39 datë 31.03.2016, neni 4 pika 6 të "Rregullores për mbajtjen, mënyrën, afatet e raportimit dhe njoftimit periodik në AMF nga shoqëritë e sigurimit", në përfundim me unanimitet të plotë,

VENDOSI:

1. Emërimin e z. Erald Hysa, Administrator të "Insig" sh.a, shoqëri sigurimi Jo-Jete duke filluar nga data 23 / 12 / 2016.
2. Emërimin e znj. Elvana Mino Administrator i shoqërisë "Insig Jete" sh.a duke filluar nga data 23 / 12 / 2016

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

AKSIONARËT:
"EUROSIG" SHA
100%

XHEVDET KOPANI
ADMINISTRATORI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 202, Datë 27.12.2016

PËR

MIRATIMIN E NDARJES SË VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË “INSIG” SH.A.,
NË SHOQËRINË E SIGURIMIT TË JO-JETËS “INSIG” SH.A. DHE
SHOQËRINË E SIGURIMIT TË JETËS “INSIG JETË” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe të nenit 261, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndarjes së veprimtarisë së shoqërisë “Insig” sh.a., në shoqërinë e sigurimit “Insig” sh.a., e cila ushtron veprimtari për klasat e sigurimit të Jo-Jetës dhe në shoqërinë e sigurimit “Insig Jetë” sh.a., e cila ushtron veprimtari sigurimi për klasat e sigurimit të Jetës.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI



DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Enkeleda SHEHI

Departamenti Ligjor

Nr. 36 Prot.

Tiranë, më 09/01/2017

AUTORIZIM

Autorizoj Znj. Dorela Koxherri, punonjëse të shoqërisë INSIG SHA të depozitojë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit/Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, dokumentat e nevojshme për përshtatjen/ndajen e shoqërisë INSIG SHA, ne dy shoqëri pritëse të themeluara rishtazi, **INSIG SHA** (kompani sigurimi jo-jete) dhe **INSIG JETË SHA**.

E autorizuar, autorizohet të kryejë çdo veprim procedurial si edhe të depozitojë çdo dokument të nevojshëm deri në perfundimin e kesaj ndarje.

AUTORIZUES

SHOQËRIA INSITITUTI I SIGURIMEVE (INSIG) SH.A

Përfaqësuar ligjërisht nga Drejtori i Përgjithshëm

Z. Erald Hysa



Date 23/12/2016

VENDIM
"EUROSIG" SHA
Nr. 16, dt. 23/12/2016

PËR

**PËRSHTATJEN E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË SË SIGURIMIT "INSIG" SHA,
NE DY SHOQËRI PRITËSE TË THEMELUARA RISHTAZI,
INSIG SHA DHE INSIG JETË SHA**

Sot në Tiranë, më 23/12/2016, në orën 12:00, në selinë e shoqërisë INSIG SHA, me adresë Njesia Bashkiake nr.7, Rruga e Kavajës, nr.116, u paraqit përfaqësuesi ligjor i "Eurosig" sha, z. Xhevdet Kopani, bazuar në Ligjin nr. 52 datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", si edhe në ligjin Nr. 9901/2008 "Mbi tregtarët dhe shoqëritë tregtare", shoqëria "Eurosig" sha zotëruese 100% e aksioneve;

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndarjes së shoqërisë INSIG SHA, në dy shoqëri pritëse të themeluara rishtazi, **INSIG SHA** (kompani sigurimi jo-jetë) dhe **INSIG JETË SHA**.
2. Miratimin e projekt marrëveshjes për ndarjen e shoqërisë "INSIG" SHA, në dy shoqëri pritëse të themeluara rishtazi **INSIG SHA** (kompani sigurimi jo-jete) dhe **INSIG JETË SHA**, si edhe miratimin e Projekt Raportit të Ndarjes
3. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë "INSIG" SHA, vetë ose nëpërmjet të tretëve të autorizuar prej tij për ndjekjen e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit/Qendrës Kombëtare të Regjistrimit te ketij vendimi dhe miratimit te dhene nga ana e Autoritetit te Mbikqyrjes Financiare sipas vendimit te bordit me nr. 202 date 27/12/2016.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

AKSIONARËT:

"EUROSIG" SHA
100%

XHEVDET KOPANI
ADMINISTRATORI



NR 37 AROT

09.01.2014

**MARREVESHJE NDARJE
E SHOQERISE INSIG SHA.
NE
INSIG SHA.
DHE
INSIG JETE SHA**

MEQENESE:

- Shoqeria shqiptare e sigurimit Insig sha., ka patur per shkak te ligjit 2 licensa per ushtrimin e veprimtarise siguruese ne sigurimin e Jetes dhe Sigurimin e Jo-Jetes.
- Ne date 01.06.2016 eshte miratuar privatizimi I Insig sha., dhe per kete shkak, ne funksion te ligjit 52/2014 duhet te behet ndarja e shoqerise Insig sha., ne dy shoqeri pritesa te themeluara rishtazi Insig Jo Jeta sha., dhe Insig Jeta sha.
- Ne date jane miratuar ne AMF statutet e shoqerive pritesa te themeluara rishtazi Insig Sha.,(kompanie sigurimi jo-jete) dhe Insig Jete Sha.
- Ne perputhje me parashikimet e Nenit 216-225 dhe 227 te Ligjit 9901/2008 "Mbi tregtaret dhe shoqerite tregtare" ("Ligji Tregtar"), administratoret e shoqerive pritesa te themeluara rishtazi sipas emerimit te tyre nga asambleja e aksionareve te shoqerise, se bashku kane hartuar nje raport te hollesishcm mbi ndarjen e propozuar.

Atehere, ne perputhje me parashikimet e neneve 216 dhe vijues te Ligjit Tregtar administratoret e parashikuar te Insig Jo-Jete sha., dhe Insig Jeta sha., kane hartuar kete marreveshje e cila do t'i paraqitet per miratim asamblese se aksionareve te shoqerive (me poshte ' **Marreveshja e Ndarjes** ").

1. NDARJA

1.1 Shoqeria Qe Do Te Ndahet

- a. Insig Sh.a. eshte nje shoqeri shqiptare sigurimi. e regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ("**QKR**") me NIPT (NUIS) J62006012D, me seli ne Rr. Kavajes, 116, Tirane, Shqiperi.
- b. Insig Sh.a. operon si nje shoqeri sigurimi ne perputhje me Vendimin e Keshillit Mbikqyrjes se Sigurimeve nr. 4 date 08.06.2000.



1.2 Shoqerite Pritese

Insig sha., sipas statutit te miratuar nge Bordi i AMF me vendimin nr. 127 date 24.08.2016, (me poshte referuar si shoqeria Pritese Insig sha.)

dhe

Insig Jete sha., sipas statutit te miratuar nga Bordi i AMF me vendimin nr. 126 date 24.08.2016 (me poshte referuar si Insig Jete sha.

1.3 Gjendja Financiare E Shoqerise Qe Do Te Ndahet

Ne perputhje me parashikimet e Nenit 216 te Ligjit Tregtar, Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raportet Vjetore te ecurise te Insig sha., per vitet financiare 2013, 2014 dhe 2015 i bashkengjiten kesaj Marreveshjeje Ndarje si Shtojca 4.

1.4 Emertimi Dhe Vazhdimesia E Personalitetit Juridik Te Shoqerive pritese te themeluara rishtazi

Ne daten e Hyrjes ne Fuqi te Ndarjes, si perkufizohet me poshte, Insig sha., do te ndahet ne dy shoqerite Pritese Insig sha., dhe shoqerine Pritese Insig Jete sha.

Nderkohe vete kompania qe ndahet do te kaloje ne crregjistrim pa likujdim sipas parashikimeve te nenit 227/c te Ligjit Tregtar.

Ndarja e Shoqerive qe do te prodhoje pasojat e percaktuara ne nenin 227 te Ligjit Tregtar, dhe rrjedhimisht, duke filluar nga dhe pas dates se Hyrjes ne Fuqi, Shoqerite Pritese do te zoterojne te gjitha pasurite, te drejtat, privilegjet dhe kompetencat dhe do t'i nenshtrohet te njejtave detyrimeve dhe pergjegjesive si Shoqeria qe Ndahet. Te gjitha policat dhe detyrimet e Shoqerise qe Ndahet do te merren persiper nga Shoqeria Pritese brenda kufijve te licenses se tyre dhe me te njejtat kushte sikur keto polica te zbatoheshin akoma nga Shoqeria qe ndahet.

1.5 Data E Hyrjes Ne Fuqi Te Ndarjes

- a. Ne perputhje me parashikimet ligjore te zbatueshme. Ndarja midis Shoqerive sipas kesaj Marreveshjeje Ndarje do te hyje ne fuqi me plotesimin e te gjithe hapave te meposhtem:



- i. Depozitim e kesaj Marrevshjeje Ndarje dhe te gjithë dokumenteve shoqeruese prane QKR-se ne perputhje me Nenin 216 e vijues te Ligjit Tregtar.
 - ii. Miratimin e kesaj Marrevshjeje Ndarje nga Asambleja e Aksionareve te Shoqerise qe do te ndahet.
 - iii. Marrjen e miratimit per Ndarjen nga ana e Autoritetit te Mbikeqyrjes Financiare ne perputhje me Ligjin 52/2014 "Per veprimtarine e sigurimit dhe risigurimit".
 - iv. Regjistrimin e Ndarjes prane QKR-se ne perputhje me Nenin 220,227 te Ligjit Tregtar.
- b. Nga sa me siper, data e Hyrjes ne Fuqi e Ndarjes do te konsiderohet data e regjistrimit ne QKR ne perputhje me parashikimet e Nenit 220,227 te Ligjit Tregtar.
- c. Duke filluar nga dhe pas Dates se Hyrjes ne Fuqi, ne perputhje me parashikimet e Nenit 220,227 te Ligjit Tregtar:
- i. Te gjitha asetet dhe detyrimet e Shoqerise qe ndahet do ti transferohen Shoqerive pritese te themeluara rishtazi sipas it te eksperteve, dhe ky transferim do te hyje ne fuqi si kundrejt Shoqerise qe ndahet ashtu edhe kundrejt te gjitha paleve te treta.
 - ii. Aksionaret e Shoqerise qe do te Ndahet do te behen aksionare te Shoqerive pritese te themeluara rishtazi sipas pjesemarrjes se percaktuar me poshte.
 - iii. Shoqeria qe Ndahet do te konsiderohet si e prishur dhe do te crregjistrohet pa likujdim nga QKR.

1.6 Te Dhenat Tregtare Te Shoqerive pritese te themeluara rishtazi

- a. Statutet e Shoqerive pritese te themeluara rishtazi jane statutet e miratuara sipas vendimeve te Bordit te AMF nr. 126 dhe nr. 127 date 24.08.2016.
- b. Statute e Shoqerive pritese te themeluara rishtazi do te hyje ne fuqi ne Daten e Hyrjes ne Fuqi.
- c. Administratoret e Pergjithshem te shoqerive pritese te themeluara rishtazi do te jene si me poshte:
Shoqeria Pritese Insig sha. - Z. Erald Hysa, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, me datë 10.11.1980, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 025484041,
Shoqeria Pritese Insig Jete sha. – Znj. Elvana Mino, shtetase shqiptare, lindur ne Tirane me date 16.07.1967, mbajtese e ID me nr. 024473069
- d. Anetaret e Keshillit Mbikeqyres te Shoqerive pritese te themeluara rishtazi te miratuara sipas vendimit te AMF nr. 155 dhe nr. 156 date 29.09.2016, do te jene personat e meposhtem:



1- Zoti Vasil Pilo - Kryetar

2- Zoti Rexhep Mejdani - Anetar

3- Zoti Thanas Xhillari - Anetar

- e. Do te themelohet nje Komitet i Brendshem Kontrolli i Shoqerive pritese te themeluara rishtazi anetaret e te cilit do te emerohen nga Keshilli Mbikqyres ne mbledhjen e pare pas emerimit.

2 Pasoja Te Tjera Te Ndarjes

2.1 Pasojat E Ndarjes Mbi Aksionet E Shoqerise Qe Ndahet

- a. Qe nga Data e Hyrjes ne Fuqi si pasoje e realizimit te Ndarjes dhe pa qene nevoja per veprime te tjera, aksionet e Shoqerive qe Ndahet do pushojne se ekzistuari pa kunderpagese.
- b. Qe nga Data e Hyrjes ne Fuqi si pasoje e realizimit te Ndarjes dhe pa qene nevoja per veprime te tjera, aksionet e Shoqerise qe do te Ndahet do te kembehen automatikisht me aksione te Shoqerive pritese te themeluara rishtazi ne njejten perqindje:
- c. Qe nga Data e Hyrjes ne Fuqi, kapitali aksionar i Shoqerive pritese te themeluara rishtazi do te te jete:

Shoqeria Pritese Insig sha.

Aksionari	Nr. i aksioneve te zoteruara	% ne kapital	Vlera e aksioneve te zoteruara ne lek
Eurosig sha.	1.083,83	100	650.000.000

Shoqeria Pritese Insig Jete sha.

Aksionari	Nr. i aksionevc te zoteruara	% ne kapital	Vlera e aksioneve te zoteruara ne lek
Eurosig sha.	616,66	100	370.000.000,00



- d. Aksionari i Shoqerise qe ndahet pranon transferimin e asetete te Shoqerive pritese te themeluara rishtazi tek Shoqeria ne kembim te aksioneve te Shoqeritese te percaktuar me lart.
- e. Te drejtat lidhur me cilesine e aksionarit te Shoqerise Perthithese dhe aksionet e Shoqerise Perthithese do te jene ato qe jane percaktuar ne Statute e Shoqerive pritese te themeluara rishtazi te miratuara nga ana e AMF dhe qe bashkengjiten kesaj Marreveshjeje Ndarje.
- f. Aksionaret e Shoqerise qe Ndahet do te kene te drejta pjesemarrjeje ne fitimet e pashperndara te Shoqerise qe Ndahet per periudhat perpara Dates se Hyrjes ne Fuqi. Aksionaret e Shoqerive pritese te themeluara rishtazi do te kene te drejta pjesemarrjeje ne fitimet e pashperndara (nese ka) te Shoqerise qe Ndahet per periudhat perpara Dates se Hyrjes ne Fuqi ne perputhje me pjesemarrjen e tyre ne kapital perpara Dates se Hyrjes ne Fuqi.

2.2 Pasojat E Ndarjes Mbi Punonjesit E Shoqerise Qe Do Te Ndahet

Nuk parashikohet qe te kete shkurtime te asnje punonjesi per shkak te ndarjes keshtu qe ndarja nuk do te kete efekt mbi punonjesit. Kontratat e punes do te rilidhen me te njejtat kushte nga shoqerite Pritese.

Duke qene se brenda Shoqerise do te Ndahet ka patur nje department qe merrej kryesisht dhe vetem me produktet e jetes, eshte parashikuar qe ky department do te kaloje I gjithi ne kompanine Pritese Insig Jete sha. Po ashtu nje pjese e stafit mbeshtetes do te kaloj prane shoqerise Insig Jete sha., qe konsiston ne specialist nga Dep. I Finances, Dep. IT, Dep. Riskut dhe aktuaristikes, Dep. Juridik, Dep. Auditit etj.

2.3 Pasojat E Ndarjes Mbi Kreditoret E Shoqerive Qe Ndahen

- a. Si me siper duke filluar nga Data e Hyrjes ne Fuqi, te gjitha detyrimet e Shoqerise qe ndahet do t'i kalojne Shoqerive pritese te themeluara rishtazi. Per shkak te ligjit, detyrimet qe lidhet me demet e jetes do ti kalojne shoqerise Pritese Insig Jete sha., ndersa detyrimet qe lidhen me demet e jo-jetes do ti kalojne shoqerise Pritese Insig sha.
- b. Pa cenuar sa me siper, Shoqeria qe do te Ndahet dhe perfaqesuesit e saj marrin persiper dhe garantojne se ata do t'i leshojne cdo kreditori eventual qe paraqet nje pretendim kundrejt Shoqerise qe do te Ndahet brenda afateve te percaktuara nga Neni 221 i Ligjit Tregtar (cdo dhe te gjitha garancite e parashikuara ne kete nen).



2.4 Privilegje Te Caktuara Per Administratoret, Keshillin Mbikqyres Ose Ekspertet Kontabel

Administratoret dhe Anetaret e Keshillit Mbikqyres si edhe ekspertet kontabel te Shoqerive qe do te Bashkohen nuk do te perftojne privilegje te vecanta si rrjedhoje e Ndarjes.

3. Deklarata dhe Garanci

Shoqeria qe ndahet deklaron dhe garanton se:

- a. Kompetencat dhe zbatueshmeria. Perfaqesuesit e Shoqerise qe ndahet kane kompetencat dhe autoritetin e duhur per te nenshkuar kete Marreveshje Ndarje. Po ashtu Shoqerite Pritese do themelohen dhe ekzistojne ne perputhje me legjislacionin e Republikes se Shqiperise.
- b. Jo-cenueshmeria. Nenshkrimi dhe leshimi i cdo dokumenti dhe zbatimi i cdo detyrimi sipas kesaj Marreveshje Ndarje nuk do te rezultojne ne shkeljen e ndonje prej (i) parashikimeve te Statuteve te Shoqerive pritese te themeluara rishtazi ose (ii) urdhri apo vendimi te nje gjykata apo autoriteti i cili ka fuqi detyruese per Shoqerine qe Ndahen.
- c. Autorizime dhe Lejime. Kjo Marreveshje Ndarje dhe transaksionet qe parashikohen ne te do te hyjne ne luqi pas miratimit nga Asamblese se Aksionareve te Shoqerise qe ndahet, miratimit nga AMF dhe regjistrimit te Ndarjes prane QKR se bashku me dokumentacionin e kerkuar.

4. Te Ndryshme

- a. Njoftimi i klienteve te shoqerise qe ndahet: Kjo marreveshje do te publikohet ne faqen web te shoqerise. Secili prej klienteve do te njoftohet me sms dhe/ose email per ndarjen. Asnje prej klienteve nuk do te kete nevojte te ndryshoje kopjet e kontratave qe ka ne fuqi me kompanine qe do te ndahet. Shoqerite Pritese do te konsiderojne te vlefshme secilen prej ketyre kontratave dhe do te ekzekutojne gjithte detyrimet qe rrjedhin prej tyre sipas kushteve kontraktore.
- b. Garanci te tiera. Shoqeria qe do te ndahet do te kryeje ato akte dhe do te leshoje ato dokumente qe do te jene te nevojshme per te plotesuar dhe per te bere te vlefshme parashikimet e kesaj Marreveshjeje Ndarje.
- c. Lista e Shtojcave. Me poshte jane Shtojcat qe i bashkengjiten dhe qe jane pjese perberese e Marreveshjes se Ndarjes:

Shtojca 1 - "Raporti i Detajuar i Ndarjes"



Shtojca 2 - "Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raportet Vjetore te Pasurise se Insig per vitet
financiare 2013, 2014 dhe 2015"

Shtojca 3 - "Statutet e Shoqerive pritese te themeluara rishtazi"

Shtojca 4 - "Raporti i Eksperteve mbi Ndarjen"

- d. Kopjet. Kjo Marreveshje Ndarje do te nenshkruhet ne 6 kopje dhe secila prej tyre do te konsiderohet nje kopje origjinale dhe te gjitha se bashku do te perbejne nje instrument te vetem.
- e. Giuhet. Kjo Marreveshje Ndarje nenshkruhet ne gjuhen ne gjuhen Shqipe.

Tirane me 23.12.2016

Shoqeria ne proces ndarje

Insig sha.

Erald Hysa

Drejtor I Pergjithshem

Miratuar pa verejtje

Administratoret e Shoqerive pritese te themeluara rishtazi

Insig sha.

Erald Hysa

ERALD H YSA
Erald Hysa



Insig Jete sha.

Elyana Mino

Elyana Mino
EM

Nr. 5 prot

Date 23 / 12 / 2016

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHMEE AKSIONARËVE

VENDIM

Nr.5, dt. 23 / 12 / 2016

PËR

EMËRIMIN E ADMINISTRATORIT TË "INSIG" SH.A SHOQËRI SIGURIMI JETE DHE ADMINISTRATORIT TË "INSIG" SH.A SHOQËRI SIGURIMI JO-JETE

Sot në Tiranë, me date 23 / 12 / 2016, në orën 12:00, në selinë e shoqërisë "Insig", sha, me adresë Njesia Bashkiake nr.7, Rruga e Kavajes, nr.116, u paraqit perfaqesuesi Ligjor, i "Eurosig" sha, z.Xhevdet Kopani, në zbatim të neneve 17, 20, 25 pika 1 te ligjit 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", neni 135 pika c të ligjit nr.9901 datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nenit 3 të Rregullores "Për procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit/Mbikëqyrës, Administratorit/Anëtarit të Bordit të Drejtorëve të shoqërisë së sigurimit" ndryshuar me Vendim Bordi nr.39 datë 31.03.2016, nenit 4 pika 6 të "Rregullores për mbajtjen, mënyrën, afatet e raportimit dhe njoftimit periodik në AMF nga shoqëritë e sigurimit", në përfundim me unanimitet të plotë,

VENDOSI:

1. Emërimin e z. Erald Hysa, Administrator të "Insig" sh.a, shoqëri sigurimi Jo-Jete duke filluar nga data 23 / 12 / 2016.
2. Emërimin e znj. Elvana Mino Administrator i shoqërisë "Insig Jete" sh.a duke filluar nga data 23 / 12 / 2016

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

AKSIONARËT:
"EUROSIG" SHA
100%
XHEVDET KOPANI
ADMINISTRATORI

